



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e IX-të (nëntë) -e rregullt, mandati VIII-të, e mbajtur më 28 maj 2026.

Mbledhja filloi në orën 10:30 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: *Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Flandra Kadriu; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Haki Rudari; Abedin Zeka; Avni Islami; Qëndresë Hajrizi; Ardi Hasani,* kurse mungoi *Kasib Bashota.*

Nga LDK: *Enis Dervisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Valon Demolli; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi,* kurse munguan *Enis Shabani, Alisa Jetullahu .*

Nga PDK: *Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi,*

Nga GUXO: *Demokrat Hodolli.*

Nga Unioni i Blakçorve: *Gentrit Arifi.*

Nga AAK: *Baki Feta,*

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, z.Fahri Restelica Nënkrjetar i Komunës; U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;
(*Ditjona Statovci-Drejtoria e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Ahmet Ahmeti-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Valbona Ibishi Azemi-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuajb Blakçori-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Behram Latifi-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).*

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), përfaqësues të KFOR; dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, dhe njëkohësisht duke i'u uruar Festën e Bajramit dhe duke i'u dëshiruar fat e mbarësi në familje.

Ju njoftoj se pas verifikimit të listës së nënshkrimeve të asambleistëve, 32 kanë nënshkruar pjesëmarrjen, andaj me këtë rast konstatoj se Kuvendi ka kuorum të mjaftueshëm për punë dhe vendimmarrje. Kjo seancë është thirrur në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës, andaj duke qenë se ftesa dhe materialet për këtë mbledhje janë shpërndarë me kohë, e shpall të hapur mbledhjen e IX të mandatit të VIII të rregullt të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Pra jush gjendet propozim rendi i ditës për këtë mbledhje duke përfshirë dhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa ku janë përfshirë edhe dy pika shtesë të rekomanduara për rend të ditës nga mbledhja e atij Komiteti të mbajtur më 26.05.2026, dhe atë;

1. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit që ka të bëjë me formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, pra do të thotë se 1 anëtare ka dhënë dorëheqje, kështu që ka ardhur propozimi tjetër prandaj qëllimi i këtij propozimi është që të plotësohet me këtë vendim.

2. Propozim Plan i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026.

Prandaj do të thotë që sot i kemi për shqyrtim 7 pika të rendit të ditës që janë; 1-Procesverbalet nga mbledhja e datës 31.03.2026 dhe 23.04.2026; 2-Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, duke u bazuar në Shkresën e Ministrisë së Administratës dhe pushtetit lokal; 3-Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; 4-Informatë nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë; dhe dy propozimet e rekomanduara nga KPF të cilat i lexova paraprakisht dhe pika Të Ndryshme, prandaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, duke u nisur nga e një e drejtë e këshilltarit që ka të drejtë të paraqet propozimin gjatë seancës dhe e drejta e këshilltarit që të informohet për çdo çështje lidhur me zhvillimin dhe mbarëvajtjen e çështjeve të ndryshme, unë propozoj një pikë të rendit të ditës në këtë seancë, dhe atë; Informatë nga Drejtoria e Arsimit lidhur me ndarjen e bursave për vitin akademik 2025 - 2026. Kërkoj nga kolegët që ta përkrahin në mënyrë që ne këshilltarët të jemi të informuar lidhur me shpërndarjen e subvencioneve.

Edhe në kohën kur isha në opozitë kam kërkuar vazhdimisht informata nga ish drejtorët e asaj kohe për arsye se përmes informatave, këshilltarët janë të informuar, informohen dhe në tërësi e ke një transparencë të plotë. Asnjëherë në jetën time nuk fshehë diçka kur është mirë, dhe përmes informatave vetëm dilet më fuqishëm.

z.Ekrem Rrahmani, përshëndeti të pranishmit dhe i'u uroi Festën e Bajramit, theksoi, nëse propozimi paraprak hyn si pikë e rendit të ditës, Informatë nga DKA, kisha propozuar që të na sjellët pak më herët, meqë ka kohë, nëse ajo renditet si pikë e fundit, të na sjellën materiali, listën kujt i është ndarë bursa, në mënyrë që ne të kemi pak kohë dhe material për debat.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, meqenëse në këtë fazë në të cilën po kërkohet informata në fjalë, studentët veç se janë duke i nënshkruar kontratat, dhe pastaj është edhe një afat ankesave, mirëpo nëse e vlerësoni mundemi edhe në fund të mbledhjes ta paraqesim, mirëpo më e arsyeshme në mënyrë që materiali të jetë i kompletuar do të ishte të lihet në seancën e ardhshme, pra të vijmë me material të kompletuar, me emra, me listë dhe të jetë më e qartë qoftë për ju, për ne dhe për të gjithë.

z.Haki Rudari, theksoi, jam ithtar i zbatimit të Rregullores së punës. Kjo Rregullore është mbi të gjitha, nuk ka këtu nënë dhe njerë, pra kemi një Rregullore dhe ajo e jep që propozimi të hedhet në votim. Nuk bënë të luhet ping pong, kështu që çdo propozim i këshilltarit duhet të vëhet në votim dhe nuk e kam problem nëse nuk kalon kjo pikë, prandaj zbatoje Rregulloren edhe përmes saj vijmë deri te vërteta në fund të këtij procesi. Në këtë drejtim duhet që propozimi të hedhet në votim dhe pastaj të vazhdojmë me tutje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk e pata në diskutim a të hedh apo jo në votim, vetëm e pata për sqarime shtesë.

z.Besim Latifi, theksoi, besoj që kërkesa e shefit të Grupit të LVV-së në cilësinë e këshilltarit proceduralisht është obligim të hudhet në votim. Megjithëse i ceku ato çështje drejtori i DKA-së, ne e përkrahëm këtë pikë, le të hy në rend të ditës me ato informata ashtu siç janë, i diskutojmë, nëse kemi nevojë diçka shtesë atëherë besoj që mund të kërkojmë informatë shtesë më gjerësisht dhe të na përcjellën edhe dokumentacionet në e-mail, kështu që e përkrahim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë si Kryesues i Kuvendit vetëm deshta t'ju them se po ju jap hapësirë drejtorëve komunal që t'i sjellin me kohë materialet për mbledhje, kështu që vërtetë kur po na vijnë ndërkohë por nuk po e kemi materialin e kompletuar, sido kudo, kur paraqitet një propozim i asambleistit do ta hedh në votim. Unë do të propozoja që pikat 1; 2; 3; 4; 5 dhe 6 të mbeten ashtu siç janë. Pika e 7 të hyj: Informatë nga Drejtoria Komunale e Arsimit siç e propozoj kolegu parafolës, natyrisht nëse votohet, dhe pika 8 të jetë Të Ndryshme, andaj e hedh në votim propozimin e shefit të grupit të LVV-së z.Haki Rudari që në kuadër të rendit të ditës të hyjë edhe pikë shtesë Informatë e Drejtorisë së Arsimit rreth ndarjes së Bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026

Pas votimit, kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 30 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë Të Përmbajtura, 1 nuk votoi, mbështetet propozimi i z.Haki Rudarit që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të jetë edhe pika shtesë:

- ***Informatë e Drejtorisë së Arsimit rreth ndarjes së Bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026***

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e thashë edhe dje për pikën që e ka shtuar drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike që ka qenë mirë me na e pru raportin a ka pas kuorum kur e kanë votuar planin e punës apo jo, jo që vë në dyshim por në bazë të fotove në faqe të Komunës që i kam parë aty janë 7-8 anëtarë prezent. Dhe po ashtu me na tregu më gjerësisht sepse nuk ka e dërguar materialin dhe thirrjen atyre anëtarëve që goxha patën bërë shumë me ardhur me hy aty veç për ta zënë një vend kurse tani të mos vijnë në ato mbledhje, pra të na tregohet përse dhe kush ka munguar dhe kush ka qenë në mbledhje e që do të ishte paksa më transparent.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, përshëndeti të pranishmit dhe jua uroi Festën e Bajramit, theksoi, ne e diskutuam këtë çështje edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa. Materiali duke përfshirë edhe listën e të pranishmëve në atë mbledhje është te zyra ligjore si sekretari, unë në mbledhjen e KPF-së veçse e angazhova zyrtarin e kësaj zyreje dhe besoj shpejt e sjellin atë listë edhe e shohim bashkërisht. Ashtu siç e thashë edhe në KPF, kuorumi ka qenë i mjaftueshëm sepse asnjë mbledhje nuk mbahet pa kuorum, e lëre më të merren vendime sikurse ky për Planin e punës, por si do që të jetë kjo është mirë dhe nuk paraqet problem të verifikohet më saktë dhe besoj që tani zyra ligjore do ta sjellë listën e nënshkrimeve të mbledhjes së KKSBB dhe do të mund të shihni.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë pasi që është pike e gjashtë e rendit të ditës kërkoj që të silllet ai material i nënshkrimeve nga mbledhja e KKSBB derisa sa të vijmë te ajo pikë për shqyrtim, tani i hedh në votim të gjitha pikat e rendit të ditës në bazë të rendit të ditës që lexova paraprakisht.

Pra kush është për miratimin e këtij rendi të ditës sipas materialeve të dërguara me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe dy pikat shtesë të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, si dhe pikën shtesë e cila u mbështet paraprakisht.

Pas votimit, kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 32 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialeve të dërguara me thirrjen e mbledhjes, konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së si dhe përfshirë edhe pikën shtesë e cili u mbështet paraprakisht që të hyjë në rend të ditës.

Rendi i miratuar i ditës.

- 1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të mbajtura më: 31 mars 2026 dhe 23 prill 2026*
- 2. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0006427/26 i datës 29.01.2026 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete
- Shkresa e MAPL-së nr.020-92/6 e datë 23.04.2026.*
- 3. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DHSMS*
- 4. Informatë nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ*
- 5. Propozim vendim për ndryshim plotësimin e vendimit nr.prot.01-020/04-0019212/26 datë 31.03.2026 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale; Lokali afarist me sipërfaqe 50m², dhe Lokali afarist me sipërfaqe 55m² të ndërtuara në Njësine kadastrale P-71712062-00459-0 me sipërfaqe 2237m², Zona Kadastrale Podujevë.*
- 6. Propozim plani i punës së KKSBB-së për vitin 2026*
- 7. Informatë e Drejtorisë së Arsimit rreth ndarjes së Bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026*

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të mbajtura më: 31 mars 2026 dhe 23 prill 2026

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi dy Procesverbale nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura me 31 mars 2026 dhe 23 prill 2026, andaj e hap diskutimin nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtyre dy dokumenteve se a ka ndokush të shtoj, plotësoj, ndryshoj apo ndonjë sugjerim, nëse nuk ka të lajmëruar atëherë i hedh në votim sipas materialeve të dërguara.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 32 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 mars 2026, sipas dokumentit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 32 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 23 prill 2026, sipas dokumentit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0006427/26 i datës 29.01.2026 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete - Shkresa e MAPL-së nr.020-92/6 e datë 23.04.2026.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr.protokolli 01-020/04-006427/26 të datës 29.01.2026 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete.

Sigurisht që e keni marrë edhe Shkresën e MAPL-së nr.020/92/6 të datës 23.04.2026 e cila ka konstatuar se vendimi i cekur nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, fjala është për vendimin e miratuar më 29.01.2026, çështje të cilën e kemi trajtuar edhe në mbledhjen e KPF-së, mirëpo materialin veç e keni dhe keni parë se për çfarë arsye është kthyer vendimi, do të thotë ka të bëjë me përbërjen e Komitetit për Komunitete, nuk ka vërejtje sa i përket përbërjes së Komuniteteve jo shumicë të Komunës së Podujevës, por te përfaqësuesit e këshilltarëve të Kuvendit Komunal ka pasur vërejtje dhe kjo është konstatuar që nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, pra është thirrë në nenin 51 paragrafi 51.3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ku thuhet që, nëse nuk parashihet ndryshe me ligj Komiteti reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës, pastaj gjithashtu përmendet dhe Statuti i Komunës, neni 58 pika 3 që përcakton anëtarësinë e Komiteteve të caktuar që duhet të pasqyrojë përpjesëtimin e numrit të ulëseve që mbahen nga subjektet politike në Kuvendin e Komunës, andaj e hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës, urdhëroni kush dëshiron fjalën.

z.Besim Latifi, përshëndeti të pranishmit dhe i'u uroj Festën e Bajramit, theksoi, në seancën e 29 janarit kur po votoj ky Komitet nga kjo foltore pata kërkuar dy gjëra elementare, bazën ligjore të formulës së ndarjes së vendeve dhe një pauzë 15 minuta për konsultim dhe pasi që në mbledhjen me shefa të Grupeve të thirrur nga Kryesuesi i Kuvendit, u sabotua nga shefi i Grupit parlamentar të LVV-së. Ju i nderuar Kryesues, bashkë me pushtetin i refuzuat kërkesat tona procedurale, injoruat opozitën me arrogancë numrash, miratuat një vendim që la Grupin e LDK-së me 13 asambleistë pa përfaqësim në këtë Komitet.

Sot para vetes e kemi përgjigjen dhe vendimin e MAPL-së, përgjigjen ndaj ankesës time dhe vendimin ndaj aktit të Kuvendit të cilin e keni dërguar ju. MAPL ka folur qartë dhe ka rrëzuar vendimin si të paligjshëm ose të kundërligjshëm, duke konstatuar pikërisht atë që kemi thënë ne, ky Komitet pra nuk pasqyron përbërjen politike të Kuvendit. Pra bazuar në ligj nenin 51 të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe nenin 58 pika 3 të Statutit të Komunës së Podujevës. Të dyja këto shkelje janë konstatuar nga MAPL. Pra kjo përgjigje është një goditje e drejtpërdrejtë ndaj tentativës tuaj për të ngulfatur zërin opozitar dhe për të keqpërdorur institucionin e Kuvendit. Ne nuk kërkojmë asgjë më shumë sesa ajo që na takon me ligj dhe me votën qytetare.

Kërkoj që sot ta kthejmë ligjshmërinë, ta themelojmë Komitetin për Komunitete sipas vendimit të MAPL-së i cili qartë precizon se ndarja e vendeve bëhet në proporcion me numrin e ulëseve që kanë partitë politike në këtë Kuvend. Unë kam paraqitur Ankesë në MAPL dhe ajo ankesë ka pasur katër kërkesa, e para që të konstatohet ky vendim ose akt i Kuvendit se është në kundërshtim me ligjin, pastaj e dyta ka qenë pezullimi i këtij akti / vendimi, e treta të urdhërohet rishqyrtimi i aktit e që po ndodhë sot, dhe e katërta që të sigurohet përfaqësimi proporcional.

Të gjitha këto janë miratuar nga MAPL, madje kjo Ministri në përgjigjen e saj ka thënë se mbetet e hapur të ofrojë çfarëdo ndihme të nevojshme ndaj Komunës së Podujevës. Si Kryesues i këtij kuvendi para së gjithash e ke për obligim të garantosh që aktet e këtij Kuvendi të jenë pajtim me ligjin, jo të lejosh shkelje të tilla të cilat na kanë qitë poshtë si Kuvend edhe si qytet.

Pra, ne jemi të gatshëm të japim kontributin tonë, por nuk jemi të gatshëm t'i plotësojmë apetitet ose pa ngopshmërinë tuaj t'i kapur të gjitha instancat e këtij pushteti.

Ndoshta nuk është e tepërt të citoj këtë pjesën ligjore të cilën e ka cekur në arsyetim Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal. Domethënë neni 51 paragrafi 3 i Ligjit për vetëqeverisje lokale që është baza kryesore ligjore, si dhe Statuti i Komunës së Podujevës neni 58 pika 3 që përcakton se anëtarësia e Komiteteve duhet të përfaqësojë përpjesëtimin e numrit të ulëseve që bëhen nga subjektet politike në Kuvend, pra është një matematikë e thjeshtë. N e kemi dërguar bashkë me ankesën tonë edhe formulën se interpretimi është e njëjta logjikë, pra dy Komitetet e përhershme e kanë të njëjtën logjikë, do të thotë në bazë të proporcionit, ndarja e ulëseve në këtë Komitet bëhet 2 vende i ka Lëvizja Vetëvendosje me 15 anëtarë që i ka ose 42% e ulëseve, dhe 2 vende të tjera i takojnë Lidhjes Demokratike me 13 këshilltarë ose 37.1%. pra nëse i llogaritim dy vendet e plota që shkojnë përpjesëtimi 15 me 35 x 4 vende atëherë del 1.71, pastaj kur pjesëtohet 13 që i ka Lidhja Demokratike me 35 del 1.48, do të thotë se dy subjekteve më të mëdha nga dy vende i takojnë, pastaj PDK ka vetëm katër këshilltarë edhe është me 0.4., do të thotë ky është realiteti faktik, ligjor edhe matematikor për këtë Komitet.

Ju kërkoj të zbatoni ligjshmërinë, asgjë tjetër, as më shumë as më pak, aq sa i takojnë me ligj secilit subjekt edhe me votën të cilën ja ka dhënë qytetari.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk e di pse po ikë prej debatit. Është dashur që ju sot të dilni dhe të kërkonit falje që i bëni këto gabime dhe na kthehen të paligjshme vendimet, sepse edhe si Komunë por edhe ne si kuvendar që jemi 35 dalim shumë keq, kjo sepse ligji të kallëzon ty qysh duhet të veprësh kurse ti vepron dhe mundohesh të dërgosh edhe arsyetim atje kinse është në rregull.

Çështja tjetër është që kur ju ka dërguar shkresa nga MAPL, të ka thënë që brenda 30 ditëve me marrë vendimin dhe me përfunduar këtë punë, tani do të thotë se i bie që i ke kaluar 30 ditë, kurse shkresa ka ardhë më 23 prill ndërsa ne tani jemi më 28 maj, pra ti Kryesues nuk e di a nuk ke pasë kohë apo përse nuk e ke thirrë seancën më herët.

Ne të ftojme të mos bësh tjera ndryshime sepse MAPL ka referuar bash ashtu qysh kemi thënë, madje për korrektësi unë e shtypa edhe procesverbalin se çka kam thënë më 29 janar e që sakt i bie ashtu qysh kam thënë unë duke cituar Ligjin për vetëqeverisje lokale neni 53 pika 51.3 dhe që nëse nuk ndodh kështu, ne as nuk kemi propozime dhe e lëshojmë. Tani prapë e ke njëjtë, madje tash që është aktualizuar edhe Gjykata Administrative e kemi edhe ende më lehtë sepse nëse MAPL nuk e kthen ashtu qysh e ka e ka kthyer, kësaj radhe ne vazhdojmë edhe në Gjykatë.

z.Haki Rudari, theksoi, fillimisht i nderuar Besim, unë apo shefi i Grupit të LVV-së siç e theksove, në atë seancë ka qenë për vizitë familjare në Gjermani, kështu që s'kam qenë pjesë në atë seancë. Unë e kam përcjellë seancën në mbrëmje përmes video incizimit dhe atë prej a deri në zh, dhe po, jam ithtar i zbatimit të ligjit. Unë e kam një përqindje që ka ardhë nga zyra ligjore, Është përqindja e subjekteve politike në Kuvendin komunal dhe ajo përqindje s'mund të ndryshon, këshilltarë/e mund të ikin / lëvizin por përqindja nuk mund të lëvizë më për arsye se përqindja e partive politike merret në momentin e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pra a i ikin LVV-së 5 këshilltarë apo i vijnë, shembull, përqindja mbetet e njëjtë, nuk ndryshon.

Unë po ashtu jam ithtar i një konsensus nëse ka mundësi, fundja jemi kolegë dhe nuk ka problem. Vota është e fundit, kam thënë vazhdimisht në fund është vota, kësaj nuk i kemi ikë edhe kur kemi qenë në opozitë, dikur duhet të pajtohemi me votim. Edhe këtu që sot jemi shumicë duhet të pajtohemi në fund me votim. Po jam ithtar i një debati para se me ardh votimi, kështu që nuk ka kurrfarë problemi në këtë drejtim, mund ta bëjmë një bashkëbisedim edhe me Kryesuesin e Kuvendit dhe ne në nivel të shefave të Grupeve. Nuk ka kurrfarë problemi.

Nëse dëshironi mund të marrim pauzë 10 minuta, të konsultohemi rreth një zgjidhje, fundja debati vazhdon. Unë jam ithtar i debatit, nuk ka kurrfarë problemi. Kështu që vendosni.

z.Besim Latifi, theksoi, nëse është pyetur zyra ligjore me datën 29 janar kur është nxjerr ky akt dhe ka dalë kaq në kundërshtim, atëherë për besë është shqetësuese sepse kemi të bëjmë me një interpretim jashtëzakonisht të thjeshtë, dhe është shqetësuese i Nderuar Kryesues nëse zyra ligjore na qet në lajthitje, por unë nuk po besoj që e ka bërë këtë punë zyra ligjore sepse i njohë të gjithë personalisht edhe e di që kanë përgatitje për këtë punë. Unë e kuptoj qysh bëhet presioni nga ana e pushtetit për të interpretuar ligjin ashtu qysh e lyp, mirëpo duke pa dhe gatishmërinë e kolegut z.Haki Rudari edhe unë pajtohem që të ulemi 10 minuta sepse është e thjeshtë.

As nuk mund t'i ndërrojmë numrat, as nuk mund ta ndërrojmë ligjin, as nuk mund i ndërron përqindjet, kështu që të ulemi dhe t'i ballafaqojmë faktet edhe njëherë. Ndoshta do të ishte mirë dhe me siguri po të jetë e rrugës që një takim i tillë të ishte mbajtur ditën kur janë themeluar Komitetet dhe të vijnë interpretimet, por konsideroj se është edhe neglizhencë nga ana juaj, Kryesues sepse në rast se ke pasë paqartësi përsëri për ndarjen e ulëse në këtë Komitet është dashur t'i drejtohesh përsëri si institucion me apel të saktësohet kjo punë.

Përndryshe unë nuk shoh që ka këtu ndonjë zbrazëti ligjore ose procedurale në kuptim të përfaqësimit në këtë Komitet.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e përmendi zotëri Rudari që ne jemi konsultuar me zyrën ligjore, atëherë ka qenë mirë të na tregoni me çfarë metode është bërë përpjesëtimi dhe qysh i kanë dalë numrat me ligj. Sipas ligjit kjo është me metodën D'Hondt që ndahen vendet dhe përpjesëtohen, e lehtë është kjo çështje, e përmendi edhe kolegu zotëri Latifi në foltore që 15 pjesëtuar për 35x4 del 1.71, kurse 13 pjesëtuar për 35x4 del 1.48, por edhe 4 pjesëtuar me 35x4 del 0.45.

E përmendi edhe kolegu zotëri Rudari e po e përmend unë edhe njëherë se në këtë çështje njihet vetëm rezultati i zgjedhjeve, pra nuk ka lidhje kush me kë bashkohet pastaj apo kush ka bërë lëvizje, Ligji e njeh vetëm rezultatin e zgjedhjeve. Ne sot jemi 13, mund të bëhemi 15 ose të mbetemi më pak, por Ligji e njehë rezultatin zgjedhor qysh kanë dalë nga zgjedhjet dhe për atë arsye takojnë 2 me 2 sipas Ligjit, përndryshe j'ua kthen negative sërish Ministria, e pastaj kjo çështje del si lloj hajgare.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, shoh që ka propozime dhe dakordim për një pauzë 10 deri maksimum 15 minuta, atëherë thërras përfaqësuesit e Grupeve për një pauzë 15 minuta, të ulemi dhe të bisedojmë se a po mundemi të dakordohemi për formulën e ndarjes së vendeve në këtë Komitet për Komunitete ashtu siç është rekomanduar edhe nga MAPL.

Kuvendi shkon në pauzë të shkurtër, dhe atë duke filluar nga ora 10:55

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 11:35

Kryesuesi i Kuvendit, fillimisht konstatoi kuorumin ku për momentin në sallë prezent ishin 29 anëtar/e të Kuvendit por që në vazhdim kompletohet pjesëmarrja si në fillim të mbledhjes (32), theksoi, ju njoftoj se pas kësaj pauze u dakordua me përfaqësuesit e Grupeve të Kuvendit Komunal, pra katër partive politike që janë të përfaqësuara, pra u pajtuam për formulën dhe me një ndryshim të vogël që po dëshirojmë ta rritim numrin e përfaqësimit në Komitetin për Komunitet. Do të thotë Komiteti të përbëhet nga 11 anëtar/e, e jo nga 9 siç ishte fillimisht, pra 1 anëtar/e shtohet nga përfaqësimi i Kuvendit dhe 1 nga Komuniteti jo shumicë, prandaj besoj që formulën meqë kemi dakordim të plotë nuk mendoj që ka nevojë ta votojmë.

Te përfaqësuesit e Komuniteteve, më parë kemi qenë për 5 anëtarë/e, tani shtohet edhe 1 bëhen 6 duke pasë parasysh që kemi për obligim edhe përfaqësimin gjinor, pra i gjashti duhet të jetë i

gjinisë femërore, mirëpo unë nuk do të anashkaloj të gjithë ata kandidatë që kanë qenë të nominuar qysh në fillim dhe herën e kaluar dhe do t'i hedhim në votim përsëri, pra ata që nuk janë përzgjedhur herën e kaluar, do të thotë të kemi mundësi edhe njëherë t'i propozojmë.

Pra po kalojmë fillimisht te formula e anëtarëve të Kuvendit Komunal, ne u pajtuam që 3 të jenë nga LVV që do t'i përfaqësoj kjo parti dhe 2 nga LDK. Atëherë ju lus fillimisht zotëri Haki Rudari t'i japni propozimet.

z.Haki Rudari, theksoi, ne për hir të zgjidhjes erdhëm në përfundim në këtë zgjidhje që arritëm për formulën, pra 2 nga LVV, jo tre, pastaj 2 nga LDK, dhe 1 nga partitë të tjera siç janë PDK, Guxo, e të tjerë që në këtë rast përfaqësuesi do të jetë nga Guxo, atëherë më lejoni të paraqes propozimet nga radhët e LVV-së për anëtar/e në Komitetin për Komunitete z.Ardi Hasani dhe znj.Vlora Humolli - Jashanica, pastaj kalojmë me propozimet e LDK që i ka 2.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ne nga Grupi i LDK-së propozojmë znj.Blerta Azemi-Berisha dhe z.Besim Latifi, për anëtar në këtë Komitet.

z.Fatri Zhitija, theksoi, e propozojmë z.Demokrat Hodolli, nga partia Guxo që të jetë anëtar në Komitetin për Komunitete.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuari Kryesues tek komunitetet jo shumicë nuk u sqarua mirë se nga cila gjini duhet të jetë anëtari shtesë, pra të shikohet sakt barazia gjinore dhe ta dim sakt edhe ne që të votojmë pastaj, edhe pse do t'i hedhësh në votim një nga një.

Kryesuesi i Kuvendit, i nderuar Ekrem nëse nuk, gabohem unë edhe në fillim e ceka por ndoshta nuk e ke dëgjuar. Pasi i sqarua me zyrtar për punë të Kuvendit sa i përket votimit për të propozuarit si dhe sa i përket aspektit të barazisë gjinore, theksoi, atëherë i hedh në votim fillimisht këto 5 propozime që u paraqiten nga 3 parafolësit, për anëtar/e në Komitetin për Komunitete nga radhët e Kuvendit të Komunës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 31 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 29 vota Për, 2 vota Kundër, asnjë votë të Përmbajtur, anëtarët e propozuar si më lartë (Ardi Hasani, Vlora Humolli-Jashanica, Blerta Azemi-Berisha, Besim Latifi dhe Demokrat Hodolli) mbështeten që të jenë anëtar në Komitetin për Komunitete nga radhët e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani radha është për përfaqësuesit e Komuniteteve jo shumicë të cilët kanë qenë të nominuar por që nuk kanë marrë votat e mjaftueshme në mbledhjen e mëparshme, pra unë do t'i lexoj të gjithë emrat por të kemi parasysh kuotën gjinore.

z.Valon Demolli, theksoi, fillimisht nëse veç u rritë numri i anëtarëve të këtij Komitetit përse duhet të kem 3 me 2, ndërsa përse nuk u përfshi edhe 1 nga PDK, pra të analizohet pak më thellë dhe të bëhet përfshirja edhe e PDK-së në këtë Komitet.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne PDK jemi pajtuar që mos jemi pjesë e këtij Komiteti, kështu që rreth kësaj nuk po e zgjati më shumë. Po kalojmë te përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, i nderuar Kryesues, a ka mundësi vetëm të na tregosh apo t'i lexosh emrat e përfaqësuesve të Komuniteteve jo shumicë të cilët kanë kaluar me vota herën e kaluar dhe që do të jenë edhe tani, pra të ceket se do të jenë të njëjtit dhe vetëm që po shtohet edhe një, përndryshe unë i kam emrat këtu por për procedurë po kërkoj që t'i lexoni edhe ju në mënyrë që në fund të hyjnë në votim të përgjithshëm.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të gjithë kandidatët që nuk kanë marrë votat herën e parë, do t'i hedhim në votim si, por vetëm një duhet të kaloj, i kam emrat dhe tani do t'i lexoj një nga një dhe ju jepni qëndrimin me votim për secilin, mirëpo edhe njëherë po e përsëris që ta kemi parasysh aspektin ligjor që duhet të jetë e gjinisë femërore në këtë.

Kemi znj.Dorontina Tahiri e cila ka qenë njëra prej të nominimeve si e propozuar, andaj e hedh në votim që kjo të jetë e anëtare e Komitetit.

Sqarim shtesë, ata anëtar/e të Komuniteteve jo shumicë që janë të zgjedhur herën e kaluar, mbeten ashtu siç kanë qenë, kurse tani kemi vetëm që ta shtojmë 1 anëtar/e. Pra njëherë po votojmë për një anëtar nga komuniteti jo shumicë e pastaj i hedhim gjithë përbërjen e Komitetit në votim. Atëherë siç e ceka kemi njërin prej propozimeve që është znj.Dorontina Tahiri nga Komuniteti jo shumicë Ashkali e cila në bazë të dokumentacionit që e shikua kishte ndjekur gjitha procedurat, me nënshkrime, me procesverbal dhe gjitha tjerat, urdhëroni mund të votojmë që anëtare e këtij Komiteti të jetë znj.Dorontina Tahiri,

z.Artrit Mulliqi, theksoi, edhe njëherë e them që është mirë të votohen ata që kanë qenë edhe në vendimin e parë sepse ne tani në qoftë se nuk i votojmë ata edhe njëherë sot nuk është ligjore. Do të thotë ky është një proces prej fillimit. Pra hedhi në votim edhe njëherë ata që kanë qenë herën e parë që t'i votojmë edhe njëherë e pastaj vazhdojmë tutje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë i kam emrat e atyre mirëpo ajo çështje nuk është e diskutueshme sot sepse askush nuk e ka diskutuar. Përndryshe nuk është problem ajo çështje sepse në procedurë të veçantë mund t'i votojmë edhe njëherë ata katër që kanë qenë nga Komunitetet jo shumicë, pra nuk është problem ajo, vetëm të ndjeket procedurën.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, Kryesuesi i kuvendit mendoj se e ka mirë sepse ata anëtarë të Komuniteteve jo shumicë që i kemi votuar në vendimin e parë nuk janë në diskutim sot dhe nuk i ka kontestuar as MAPL andaj mendoj se nuk kemi nevojë të shkojmë emër për emër sërish sepse në fund të procesit mund t'i hedhësh në votim të gjithë përbërjen e Komitetit, dhe votojmë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, mirë atëherë, po pajtohem edhe unë në këtë. Atëherë vazhdojmë me votim për anëtarin/en shtesë nga radhët e Komuniteteve jo shumicë sipas radhës së propozimeve, në radhë është znj.Dorontina Tahiri.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se 28 vota ishin Për, asnjë Kundër dhe asnjë Të Përmbajtur, që e nominuara / propozuara nga radhët e Komuniteteve jo shumicë-Ashkali znj.Dorontina Tahiri të jetë anëtare në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani votojmë për të nominuarën / propozuarën tjetër të radhës znj.Shkurt Sejdiu.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se asnjë votë nuk ishte Për, asnjë Kundër dhe asnjë E Përmbajtur, do të thotë nuk votuan fare, që e nominuara / propozuara nga radhët e Komuniteteve jo shumicë znj.Shkurte Sejdiu, të jetë anëtare në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani votojmë për të nominuarën / propozuarën tjetër të radhës znj.Fikmete Qurkolli.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se vetëm 1 anëtar/e votoj dhe atë Për, të tjerët nuk votuan fare, që e nominuara / propozuara nga radhët e Komuniteteve jo shumicë znj.Fikmete Qurkolli të jetë anëtare në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, kemi edhe një anëtar të nominuar / propozuar tjetër të radhës që është z.Xhevdet Kovaçi.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se vetëm 2 anëtar/e votuan dhe atë Për, të tjerët nuk votuan fare, që i nominuari / propozuar nga radhët e Komuniteteve jo shumicë z.Xhevdet Kovaçi të jetë anëtar në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani votojmë për të nominuarën / propozuarën tjetër të radhës znj.Ramize Ahmeti.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se vetëm 6 anëtar/e votuan dhe atë Për, të tjerët nuk votuan fare, që e nominuara / propozuara nga radhët e Komuniteteve jo shumicë znj.Ramize Ahmeti të jetë anëtare në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani votojmë për të nominuarën / propozuarën tjetër të radhës znj.Fatlume Rexhepi.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se vetëm 4 anëtar/e votuan dhe atë Për, të tjerët nuk votuan fare, që e nominuara / propozuara nga radhët e Komuniteteve jo shumicë znj.Ramize Ahmeti të jetë anëtare në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani votojmë për të nominuarin / propozuarin tjetër të radhës z.Lavdim Bajrami.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstaton se vetëm 8 anëtar/e votuan dhe atë Për, të tjerët nuk votuan fare, që i nominuari / propozuari nga radhët e Komuniteteve jo shumicë z.Lavdim Bajrami të jetë anëtar në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani u votua për të gjithë 8 anëtar/e të Komuniteteve jo shumicë të cilët janë propozuar apo nominuar për të qenë pjesë e Komitetit për Komunitete të cilët nuk kanë marrë votat e nevojshme herën e parë para rreth 2 muajve kur janë votuar për këtë Komitet. Nga ky proces i votimit znj.Dorontina Tahiri konstatohet se ka marrë numrin më të madh të votave dhe hynë në listën e anëtarëve/eve të Komitetit jo shumicë në Komitetin për Komunitete.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga proces i votimit për një anëtar/e të Komuniteteve jo shumicë që të emërohet në kuadër të përbërjes së Komitetit për Komunitete, znj.Dorontina Tahiri ka marrë numrin më të madh të votave dhe njëkohësisht, mbështetet që të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete nga radhët e komunitetit jo shumicë - Ashkali.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani po i lexoj të gjithë emrat e propozuar dhe që kanë marrë votat e mjaftueshme paraprakisht për të qenë anëtar/e të Komitetit për Komunitet: Vlora Humolli-Jashanica, Ardi Hasani, Demokrat Hodolli, Blerta Azemi-Berisha, Besim Latifi, Rrahim Sejdiu, Vloriana Avdiu, Xhafer Ademi, Muhamed Sadiku, Sevdie Mustafa dhe Dorontina Tahiri, andaj e hedh në votim themelimin e Komiteti për Komunitete me përbërjen e mësipërme prej 11 anëtarëve.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 30 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 28 vota Për, 2 vota Kundër, asnjë votë Të Përmbajtur, në procedurë të rishqyrtimit sipas Shkresës së MAPL-së, me vendim themelohet Komiteti për Komunitete në këtë përbërje:

1. **z.Ardi Hasani**, anëtar nga subjekti politik - LVV
2. **znj.Vlora Jashanica**, anëtare nga subjekti politik - LVV
3. **znj.Blerta Azemi - Berisha**, anëtare nga subjekti politik - LDK
4. **z.Besim Latifi**, anëtar nga subjekti politik - LDK
5. **z.Demokrat Hodolli**, anëtar nga subjekti politik - Guxo
6. **z.Rrahim Sejdiu**, anëtar nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Ashkali
7. **znj.Vlorjana Avdiu**, anëtare nga radhët e Komunitetit jo shumicë – Ashkali
8. **z.Xhafer Ademi**, anëtar nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Ashkali
9. **znj.Dorontina Tahiri**, anëtare nga radhët e Komunitetit jo shumicë – Ashkali
10. **z.Muhamet Sadiku**, anëtar nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Rom
11. **znj.Sevdije Mustafa**, anëtare nga radhët e Komunitetit jo shumicë - Egjiptas

Kryesuesi i Kuvendi, përshëndet Kryetarin e Komunës z.Shpejtim Bulliqi i cili bashkëngjitet tani mbledhjes.

3. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me Informatë të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, drejtoreshën e kësaj Drejtorie e kemi këtu prezent, andaj urdhëroni nëse dëshiron fjalën rreth kësaj pike, para se t'jua kalojmë fjalën për diskutim anëtarëve të Kuvendit.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, përshëndeti të pranishmit dhe u'a uroj të gjithëve Festën e Bajramit duke dëshiruar shëndet dhe begati në familjet tona. Në vazhdim paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj Informate, theksoi, sipas Planit të punës, në këtë seancë është e paraparë të jepet informata nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale për mbarëvajtjen e punës së Drejtorisë për katër mujorin e parë të këtij viti, andaj më lejoni që në vijim të bëj këtë prezantim ku para jush keni të bashkangjitur edhe materialet e përmbajtjes së informatës time. Sot, siç e dini në Komunën e Podujevës DSHMS-ja punon punën e saj, e organizuar në sektorin e shëndetësisë, Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF, në sektorin e Mirëqenies Sociale dhe atë të Qendrës për Punë Sociale, pra në vazhdimësi për punën e DSHMS në sektorin e shëndetësisë, por edhe atë të mirëqenies sociale mund ta përmbledhim si në vijim.

QKMF ofron shërbime të mjekësisë familjare 24 orë, çdo ditë pune, të fesave dhe vikendeve, Shërbimi i emergjencës po ashtu ofron 24 orë ku në kuadër të urgjencës tashmë funksionon edhe laborator dhe rëntgeni 24 orë si dhe shërbimin stomatologjik deri në orën 23.

Shërbimet laboratorike ofrohen çdo ditë të punës në kuadër të QKMF-së dhe të urgjencës, po ashtu dhe gjatë festave dhe vikendeve në orarin në QKMF-së, ndërsa pas orës 15 analizat laboratorike kryhen në urgjencën e re. Gjithashtu analiza laboratorike kryhen edhe në QMF-të Orllan, Lluzhan, Gllamnik dhe Kërpimeh.

Kujdesi palativ-shtëpiak është duke ofruar shërbime nga deri në orën 23 çdo ditë të punës, festave dhe vikendeve. Është duke vazhduar program i vizitave shtëpiake për gra shtatzëna dhe fëmijë zero deri në tre vjeç. Vizita këto çdo ditë pune në orarin e caktuar.

Furnizimi me medikamente, materiale shpenzuese, materiale stomatologjike, laboratorike dhe insulina është gjithashtu duke u realizuar falë kontratës aktive të cilën e kemi dhe planifikimit që është bërë, si dhe furnizimit nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë. Gjithashtu vlen të përmendet se janë kryer edhe vizitat sistematike të nxënësve të klasave të I-ra, të V-ta dhe të IX-ta në të gjitha shkollat, vizita këto të realizuara nga ekipa e mjekësisë familjare ku në përbërje të tyre janë edhe ekipa stomatologjike.

Gjithashtu vlen të përmendet që është një infrastrukturë e përmirësuar, një furnizim me aparatura e mjete të punës si në QKM ashtu edhe në urgjencë. Furnizimi me medikamente është duke u bërë në rregull. Mandej kemi trajnim të stafit, përkushtimi në punë janë garanci e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse për gjithë qytetarët, e po ashtu edhe e lehtëson edhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Në vazhdim do të doja të prezantoja para jush edhe disa të dhëna statistikore për shërbime të cilat janë kryer në kuadër të QKMF-së dhe urgjencës për këtë katër mujor të parë të këtij viti.

Numri i vizitave të mjekësisë familjare në qendër dhe në terren e arrijnë numrin 64560 vizita, ku prej tyre 49290 janë realizuar në qendër, ndërsa 15270 në terren. Numri i vizitave në shërbimin e urgjencës është 15073, vizitave specialistike ku hyjnë pediatria, gjinekologjia dhe epidemiologjia janë 2890 ku prej tyre pediatri 1208, gjinekologji 1132 dhe epidemiologji 550. Numri i vizitave

stomatologjike të realizuara në qendër dhe po ashtu edhe në terren është 1415, prej tyre 155 në qendër dhe 360 në terren.

Gjithashtu numri i pacientëve që kanë kryer analiza laboratorike në qendër, por edhe në terren ku i përmendëm paraprakisht se në cilat QMF dhe AMF ky shërbim është 7016, prej tyre 6364 në qendër dhe 652 në terren. Pastaj numri i vizitave të shërbimit paliativ është 3020. Numri i pacientëve që kanë kryer shërbime radiologjike është 3170. Numri i fëmijëve të vaksinuar në qendër dhe në terren është 3363, numri i nxënësve të vaksinuar është 2469, vizita sistematike të fëmijët në Çerdhe publike është 352 dhe vizita sistematike të nxënësve në shkolla është 3119, ndërsa numri i vizitave të grave shtëpiake, grave shtatzëna dhe fëmijëve 0 - 3 vjeç është 229.

Si Drejtori në këtë informatë kam prezantuar dhe projektet e planifikuara për realizim për vitin 2026 ku do të përmend dhe procedurat në të cilat gjenden këto projekte. Furnizimi me barna dhe reagenca është projekt tashmë i iniciuar dhe është në fazën e prokurimit, furnizimi me oksigjen është lidhur veç kontrata në fillim të vitit dhe është duke u bërë furnizimi me oksigjen rregullisht sipas nevojave të QKMF-së dhe të urgjencës.

Furnizim me autoambulanca, ky projekt është në fazën e prokurimit, pastaj furnizimi me uniforma të personelit mjekësor dhe çarçafë për shtretër për nevojat e QKMF-së, projekt në fazën e prokurimit, furnizim me dokumentacion mjekësor është një projekt në prokurim, furnizimi me pajisje mjekësore sërish në fazën e prokurimit. Tek këto pajisje mjekësore do të bëhet furnizimi me mamograf dhe me ortopan për nevojat e QKMF-së, furnizimi me material për laborator, kjo kontratë është nënshkruar dhe është në realizim ku është duke u bërë rregullisht edhe furnizimi me material të laboratorit, mandej furnizim me inventar, ky projekt ndodhet në fazën e prokurimit, hartimi i projekteve është projekt në fazën e prokurimit, furnizim dhe montim me gjeneratorë për nevojat e QKMF-së dhe ky projekt është iniciuar dhe është në fazën e prokurimit. Po ashtu kontrata është në fazën e prokurimit për furnizimi dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit. Jemi në fazë të përgatitjes të specifikave për procedim në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Servisimi i pajisjeve mjekësore është projekt i iniciuar dhe ndodhet në fazën e prokurimit. Furnizim me pajisje për nevoja të QKMF-së, po ashtu jemi në fazën e përgatitjes së specifikave për procedim dhe zhvillim në procedurat e prokurimit si dhe po ashtu edhe furnizimi me material higjienik është iniciuar si projekt deri në fazën e prokurimit.

Gjithashtu vlen të përmendet që kemi këto kontrata aktive, furnizimin me barna, material shpenzues, material laboratorik, filma të rëntgeni dhe material stomatologjik.

Kontrata e furnizimit me material të mirëmbajtjes elektrike, sanitare, vegla pune e të tjerë, kontrata për servisim të automjeteve, kontrata e AQP-së për furnizim me derivate, kontrata për furnizim me oksigjen dhe kontrata për furnizim me pelet.

Dua ta përmend se gjatë kësaj periudhe kemi pranuar edhe donacione të ndryshme të pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF-së. Pra këto ishin disa prej informacioneve për sektorin e shëndetësisë për këtë katër muaj të parë të vitit.

Tek Mirëqenia sociale kemi shpallur thirrjen për përkrahje të OJQ-ve ku është publikuar dhe lista përfundimtare e OJQ-ve përfituese që gjendet e publikuar në faqen e Komunës.

Sa i përket çështjes së strehimit, gjatë periudhës janar-prill 2026 kemi pranuar kërkesa nga palët për strehim dhe renovim të shtëpive, të gjitha familjet janë vizituar në terren për të verifikuar gjendjen e tyre të banimet dhe atë sociale. Ka filluar ndërtimi i shtëpive për dy familje, rasti sociale në bashkëfinancim me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” për të cilën në fillim të këtij viti është nënshkruar edhe Memorandumi për ndërtimin edhe të pesë shtëpive të tjera për familjet me raste sociale, ndërsa një shtëpi është përfunduar dhe i janë dorëzuar edhe çelësat familjes përfituese në bashkëpunim me Organizatën Qatar Charity.

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu janë vizituar edhe familje të cilat jetojnë në Lagjen e dëshmorëve si dhe në Lagjen e re për t'u bërë verifikimi i banueshmërisë së shtëpive e po ashtu edhe familjeve të cilat jetojnë në ato shtëpi.

Qendra rezidenciale është në fazën e inventarizimit, ky projekt është duke u realizuar në bashkëfinancim me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit”.

Lidhur me projektin e banimit të përballueshëm, është në fazat fillestare të ndërtimit të tij, ndërsa te banimi adekuat projekti për ndërtim dhe renovim të shtëpive veç jemi në fazën finale të kompletimit të dokumentacionit, mirëpo para pak ditësh veç është bërë edhe publikimi i listës së parë po themi, të familjeve të cilat kanë arritur t'i realizojnë dhe kompletojnë dokumentacionin, edhe ajo listë gjendet e publikuar në faqen e Komunës.

Në bashkëfinancim me Shoqatën Qatar Charity po ashtu vlen të përmendet se janë vizituar edhe familjet aplikuese me kërkesa për shpuarjen apo hapjen e pusetave për ujë të pijshëm ku janë pranuar nëntë kërkesa dhe veç jemi në përfundim të procesit të përfundimit të këtij projekti.

Gjithashtu vlen të përmendet se familjet gjatë kësaj faze janë ndihmuar dhe me mjete financiare si dhe gjithashtu edhe me pakohë ushqimore.

Sa i përket Qendrës për Punë Sociale në Podujevë, gjegjësisht në shërbimin social trajtohen raste të cilave u ofrohen shërbime sociale të drejtpërdrejta dhe janë përfitues të këtyre shërbimeve.

Qendra për Punë Sociale në Podujevë nga janari i vitit 2026 deri në periudhën e prillit 2026 ka trajtuar rastet si në rastet e dhunës në familje, 36 raste të reja, fëmijë me aftësi të kufizuara 6 raste të reja ndërsa gjithsej nën menaxhimin e shërbimit social janë 136 raste të tilla. Gjithashtu edhe janë trajtuar raste të tjera që hyjnë në domenin e trajtimit të Qendrës për Punë Sociale që gjithsej arrijnë numrin 313.

Nga janari 2026 në shërbimin e asistencës sociale janë paraqitur 3 kërkesa të reja për ndihmë sociale të cilat janë në kategorinë e parë. Po ashtu edhe kemi 5 raste të tjera të cilat janë paraqitur për të ndërprerë asistencën sociale për shkak që tashmë është punësuar ndonjë anëtar i familjes së tyre. Gjithsej nga muaji janar deri prill 2026 kemi 467 shfrytëzues të ndihmës sociale në Komunën e Podujevës. Ndërsa nga projekti sistemi i asistencave sociale pilot projekti i tij ka 224 familje përfituese të asistencës sociale që është në kuadër të Ministrisë, ndërsa 22 prej tyre janë refuzuar.

Këto ishin pak a shumë informata lidhur me punët të cilat janë kryer nga janari deri në muajin prill të këtij viti në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe me këtë rast falënderoj të gjithë si personelin mjekësor po ashtu dhe punëtorë e QPS-së dhe gjithashtu dhe ata komunalë për kontributin që janë duke dhënë në shërbimin e qytetarëve. Unë jam shumë e hapur për bashkëbisedim me ju dhe çka do që keni dhe që e konsideroni që është e vlefshme për tu diskutuar, mirëpres pyetjet e juaja.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, përshëndeti të pranishmit dhe u'a uroj të gjithëve Festën e Bajramit, theksoi, fillimisht e falënderoj drejtoreshën parafole së znj.Lirie Hoti për informatën dhe prezantimin e informatave rreth shërbimeve gjatë këtyre katër muaj, duke parë këtë llojllojshmëri të shërbimeve ka zgjatje të orarit dhe mbi të gjitha shërbimet e ofruar gjatë kësaj periudhe mund të konstatojmë se ka realizim të detyrave dhe të përgjegjësisë të kujdesit parësor shëndetësor siç janë parandalimi i sëmundjeve përmes vaksinimit, edukimit shëndetësor, kontrollit preventiv diagnostifikim dhe trajtim në bazë të sëmundjeve më të shpeshta, promovim i shëndetit dhe mënyrës së shëndetshme të jetesës, zbulim të hershme të sëmundjeve për të parandaluar komplikimet, mandej kemi kujdes të vazhdueshëm të pacientëve dhe përcjellje afatgjate, referim në nivele më të larta si në spitale ose në spitalin specialistik që tash për fat të mirë e kemi edhe në Podujevë kur paraqiten nevojat për referime të tilla.

Gjithashtu kemi edhe ofrim të shërbimeve për familje dhe komunitete. Një rekomandim që do të doja ta bëja rreth kësaj informate është ajo që më bëri përshtypje numri i vogël i vizitave në shërbimin stomatologjik duke marrë parasysh që kemi një numër të madh të stomatologëve, shumicën e njohim edhe personalisht dhe janë stomatologë shumë të mirë dhe të përgatitur profesional, kështu që ndoshta do të ishte e nevojshme një kampanjë vetëdijesuese për qytetarët rreth shërbimeve të ofruara në shërbimin stomatologjik në kuadër të QKMF-së.

z.Besim Latifi, theksoi, sot po të diskutojmë informatën nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për periudhën janar-prill 2026, në letër gjithçka po duket mirë dhe realisht raporti domethënë flet për kapacitete të plota, shërbime cilësore, rezultate inkurajuese, por qytetarët e Podujevës nuk jetojnë në raport, ata jetojnë me probleme reale të përditshme të këtij sistemi shëndetësor, pra realiteti në terren është diçka tjetër nga rezultatet që i keni në letra.

Në raport thuhet se funksionon 24 orë edhe laboratorit edhe rëntgeni, por unë kam pranuar shumë ankesa prej qytetarëve që kjo nuk është e vërtetë, domethënë edhe rëntgeni edhe analizat nuk punojnë 24 orë. Po ashtu analiza CRP që është një analizë bazike dhe shumë e rëndësishme për diagnostifikim mungon tash e disa muaj në gjithë sektorin shëndetësor dhe në emergjencë.

Po besoj që kemi edhe një problem tek biokimisti sepse për këto analiza nuk kemi biokimist, e për këtë shkak edhe rezultatet e këtyre analizave janë jashtëzakonisht kontestuese, madje tek cilido mjek që shkon me këto analiza, do të thotë rezultatet i ke shumë diskutabile sepse punohet vetëm me laborant, jo me biokimist. Unë nuk kam parë që ka edhe planifikim, por edhe në bashkëbisedim me punëtor shëndetësor nuk kam dëgjuar që ka planifikim për biokimistë, është mirë të planifikohet dhe të punësohet një biokimist që rezultatet e analizave të jenë të sakta edhe t'ju kryejnë punë qytetarëve për arsye se mjekët nuk po i marrin si të sakta këto rezultate.

Pastaj i kemi disa probleme me AMF që janë në shumë fshatra, do të thotë janë të mbyllura, në disa fshatra punohen vetëm nga dy ose tre ditë, është problem pa mjekë sidomos në zonat rurale, andaj e kam një pyetje, përse nuk është funksionalizuar ambulanta në Dobërdol, edhe a është e vërtetë se janë të mbyllura ambulantat në Dyz, Pollat, Halabak, Herticë. Mandej kam marrë informata që gjendja në ambulantat në Bajçinë, Majac, Lupç janë jashtëzakonisht e keqe.

Pastaj kam marrë vërejtje edhe te këto vizitat që po bëhen prej kujdesit paliativ, do të, thotë po bëhen pa mbikëqyrje, shkojnë ju vendosen infuzione e të tjera duke përfshirë edhe me antibiotikë, informata pra që i'u vendosen ato dhe ecin kurse pastaj familjarët detyrohen me i heq kanillat vet, e këtu mendoj që duhet me marrë më seriozisht mbikëqyrjen e këtyre dhe funksionimit të këtyre organeve në mënyrë që të kryhen shërbimin ashtu për qysh janë të thirrur dhe për çka paguhen.

edhe një çështje tjetër e cila po diskutohet në vazhdimësi e shoh që ka mungesë të mjekëve, më intereson a ka ndonjë planifikim për specializim të mjekëve të rinj, unë nuk kam gjetur diçka që ka të planifikuar. Po ashtu tek çështja e procedurave që i ceku drejtoresha si planifikim për vitin 2026, tani jemi në mesin e vitit 2026, do të thotë të gjithë e dimë qysh funksionon prokurimi edhe i dimë procedurat qysh shkojnë, andaj këto planifikime mundesh me i pas të realizueshme në vitin 2027 sepse për 2026 duke e parë qysh funksionon prokurimi dhe këto procedura, është e pamundur të realizohen ashtu qysh i ceku drejtoresh në vitin 2026.

z.Enis Dervisholli, theksoi, e kam lexuar me kujdes raportin e vitit 2025, edhe pse ju drejtoresh s'keni qenë përgjegjëse për këtë periudhë sa i përket mirëqenies sociale, për fat të keq pak punë është bërë për fëmijët në raport, përveç subvencionit për organizatat Handikos në shumë 9.000€, Shoqatën e Autizmit 8.000€ dhe Shoqatën OFAP 3.000€, dhe janë vetëm katër raste të fëmijëve me aftësi të kufizuara që janë trajtuar më qendrën përkatëse.

E kam lexuar edhe planin për vitin 2026 dhe për fat të keq gati i njëjti plan ka qenë edhe për vitin 2026, kurrë s'ka ndryshuar, madje për më tepër subvencionet vetëm janë zvogëluar e nderuar

drejtoreshë, Handikos prej 9.000€ në 5.000€, pastaj Shoqata e Autizmit prej 8.000€ në 1.000€ dhe OFAP prej 3.000€ në 1.000€. Po ndalem vetëm te fëmijët me autizëm.

Sipas të dhënave tuaj e nderuar drejtoreshë, 31 fëmijë janë në shkollën “Dr.Ibrahim Rogova”, dhe për secilin fëmijë janë ndarë vetëm 32.25 € që ajo i bie 2.68 € në vit, apo që i bie 0.13 € në ditë, pra 13 cent për një fëmijë me autizëm i janë ndarë në ditë. Tani këtu e kam një letër prej një veterani të luftës, i kam marrë disa shënime prej tij, nuk po dua t’ia përmend emrin sepse po dua t’a ruaj dinjitetin e tij. Shpenzime i ka 168€ në shkollën “Dr.Ibrahim Rugova” trajtim që i bën, 220€ te lokopedi, 40€ për kontrolle për mjek neurologjike, dhe 40€ minimumi për barna që përdor, pa llogaritur harxhimet tjera dhe shpenzimet që ka për një familje me një fëmijë me autozëm, totali i bie 508 € në muaj trajtim për këtë fëmijë, kurse ai person të hyrat i ka 270€ që i merr si invalid i luftës, 150€ i merr pension për djalë, totali i 420€ që i ka ajo familje të hyra, do të thotë se çdo muaj ai person e nis muajin minus 88€ që ka kontrolle dhe trajtim shkollimi për atë fëmijë. Tani ju pyes juve, qysh mundet me ja dalë kjo familje sepse e ka bashkëshorten dhe dy fëmijë të tjerë, qysh mund t’ia dalin pra ato familje me raste të tilla që kanë me autizëm.

Për këtë arsye e nderuar drejtoreshë ju lus të përgatitini një plan konkret për këto kategori, pra Planin për shërbime sociale ashtu siç e kërkon ligji juve e nderuara drejtoresh, dhe atë mundësisht para muajit shtator në mënyrë që të ndahen mjetet, përndryshe e nderuara drejtoreshë kjo çështje do të jetë marre për të gjithë neve këtu që i përfaqësojmë këto familje, prandaj të lus edhe njëherë që ta përgatitësh Planin e cekur deri në muajin shtator në mënyrë që ne të bëjmë më shumë për këto familje sepse janë shumë keq.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, përshëndeti të pranishmit dhe jua uroj Festën e Kurban Bajramit të gjithëve meqë kjo seancë po mbahet një ditë pas ditës së kësaj Feste, në vazhdim theksoi, deshta të ndërlihem paksa me asamblistin paraparak, kur kemi ardhur ne këtu para pesë viteve ata fëmijët me autizëm kanë pas zero buxhet të ndarë nga Komuna e Podujevës, mos e harroni këtë, këta që kanë qenë asambleistë edhe më herët e dinë këtë punë, pra kemi gjetur zero buxhet. Pastaj ne kemi ndarë buxhet për këtë kategori dhe tani e kemi ngritur në 9.000€ ose 10,000€ një vit më herët, do të thotë se për herë të parë në mandatin tonë janë ndarë shuma të mjeteve financiare për t’i ndihmuar fëmijëve me autizëm në mënyrë që atyre prindërve të mund t’jua lehtësojmë barrën e pagesës që e bëjnë për ata dy mësues/e që janë, kurse rreth asaj pse është zvogëluar shuma financiare në këtë vit, arsyeja është shumë e thjeshtë, ajo është një OJQ që ofron shërbime, ne e kemi subvencionuar një OJQ për ato shërbime që t’jua ndihmojmë atyre prindërve, dhe unë besoj shumë që nga muaji shtatori i këtij viti do i punësojmë mësuesit tanë dhe nuk do të kemi nevojë më të financojmë OJQ për ato shërbime, pra do t’i punësojmë mësuesit përkatës dhe ata ose ato pastaj do t’a kryejnë punën. Nëse kërkohet të jepet buxhet nga Komuna, ne atë buxhet jua japim mësuesve tanë dhe mbyllet ky diskutim.

Sa i përket Shoqatës Handikos, urdhëroni mund t’i nxjerrni statistikën sa keni financuar ju deri në momentin e marrjes së mandatit nga ne, si qeverisje lokale, merrni shifrat dhe vetëm shikoni, madje ata që janë asambleistë edhe më parë e dinë, për herë të parë jemi duke dhënë shifra dinjitoze për këto kategori. Pastaj kemi Shoqatat e dalat nga lufta, jua rikujtoj nëse nuk e dini i respektuar asambleistë, se për çdo vit i dërgojmë në shërbime terapeutike 10 ish ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët i financojmë me buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Pastaj për herë të parë në mandatin tonë Shoqatave të dala nga lufta ju është bërë një vend dinjitoz në objektet komunale, nuk e kanë pasë asnjëherë, nuk e di a jeni në dijeni ju për këtë, dhe për herë të parë në mandatin tonë këtyre Shoqatave i’u janë ndarë shuma të caktuara financiare për t’jua mundësuar t’i kryejnë disa shpenzime të tyre, prandaj unë besoj që kemi progres në këtë çështje, jo

regres, por kemi progres, prandaj është mirë të thuhet këto shifra sepse janë faktike, janë në buxhet dhe dihet nga janë shkuar dhe qysh janë shkuar.

Pa dashur t'ia marrë të drejtën drejtoreshës së DSHMS sepse kjo sigurisht që do t'ju përgjigjet në vazhdim në gjitha pyetjet e parashtuara nga ana juaj, mirëpo është mirë që këto gjëra t'i din secili për veten sepse jeni asambleistë dhe është mirë t'i dini, të shfletoni, t'i pyesni kolegët e mëhershëm që kanë qenë në mandatet e kaluara sepse ata i dinë, përndryshe këto gjëra janë edhe publike, por nëse po dëshironi veç të thoni ashtu hajt pak, jemi para zgjedhjeve por nuk është problem, mund të flasim sepse kjo foltore këtu na lejon të flasim, s'na ndal askush, mirëpo duhet të flasim me fakt dhe me shifra, e fakte dhe shifra janë këto që i ceka.

Pastaj sigurisht që jeni në dijeni shumë mirë që për herë të parë po fillojmë këtë vit me shërbime të reja me logopedë, me fizioterapeutë dhe psikolog në QKMF, shërbime këto që asnjëherë nuk kanë qenë, pra për herë të parë në këtë vit do të fillojmë. Jemi në përgatitje të shpalljes së konkurseve për të filluar edhe me këto shërbime që të kryhen në kuadër të QKMF-së.

Mandej nuk kemi pasë asnjëherë, as në shkolla, as në çerdhe, por sot kemi edhe lokoped në Çerdhe, edhe kjo për herë të parë ka ndodh mandatin tonë që të fillohet edhe në Çerdhe me kryerjen e shërbimeve të cekura për ata fëmijë që kanë nevojë për ato shërbime. Prandaj pa të keçe asgjë i nderuar asambleistë sepse mund të mos i kesh këto informata, por besoj që është mirë të tregohen, është mirë t'i shikoni dhe t'i lexoni sepse janë punë të mira që janë bërë.

A ka dobësi, edhe mund të ketë, është mirë që ato dobësi të na i përmendni dhe të na kritikoni, siç ishte çështja e Rëntgenit, mund të ketë edhe ndonjë defekt tjetër, por duhet me pas parasysh se këto janë aparatura, brenda pesë minutave mund të prishet ose dëmtohet, por duhet të rregullohet e që jeni në dijeni që pastaj janë disa procedura për procesin e prokurimit, sepse s'mundesh ndryshe, e ato procedura janë shpallë me kohë, po presim lidhjen e kontratës dhe besoj që çdo problem dhe defekt që mund të ketë besoj që do ta sanojmë me kohë.

z.Enis Dervisholli, theksoi, po ndërlidhem pak me Kryetarin, nëse thuhet që është mirë 1.000€ me dhënë për fëmijë me autizëm, unë e them që është gabim, a është dashtë me fol, mendoj se nuk është dashtë por është dashtë me u marrë në terren, pra është dashtë të kryhet më herët, shumë vite më parë, por llogaritja i nderuar Kryetar që 32 euro në vit i ke dhënë për një fëmijë me autizëm, kurse sot janë të regjistruar 31 fëmijë, 3 fëmijë nuk kanë mundësi t'i dërgojnë shkollën "Dr.Ibrahim Rugova", me shumën prej 168€ s'kanë mundësi që aty t'i paguajnë, pastaj edhe nuk i plotëson kriteret ajo klasë që të mbahen trajtim, 2 fëmijë në të njëjtën klasë me hapësirë 4x3, ajo automatikisht nuk i plotëson kushtet. Ka veteran të luftës që sot është invalid dhe ne t'ia japim 32€ si Komunë, nuk është dashur, por është dashur të rregullohet më herët e jo t'i vije puna një veterani të luftës ta qetë tokën shitje për fëmijën e vet sepse nuk mund t'ia del me mbi 500€ harxhime, kurse ne të krenohemi me dhënien e 1.000€ njëherë.

I nderuar Kryetarë, t'u kisha lut mundësisht të krijosh hapësira, lëri disa tjera dhe krijo mundësi sepse ka më shumë mundësi për të bërë, nuk po e përdori për çështje politike, por unë po e them këtë sepse e ndjejë këtë punë dhe për atë e kam marrë obligim të them këto gjëra sepse kemi mundësi të bëni më shumë për këto familje, për ato nëna që shkojnë gjithë ditën rrinë te shkolla "Dr.Ibrahim Rugova" e neve duhet të gjithëve duhet të na vie turp të mos bëjmë më shumë për ato familje sepse nuk jemi duke bërë kurrigj, 13 cent në ditë të jepen për një fëmijë me autizëm, i nderuar Kryetar nuk është në rregull, ke mundësi njëqindmijë gjëra tjera t'i lësh mangët, ke mundësi 2 kultivatorë më pak t'i ndash, dy sera më pak, 10 mëshqerra më pak, e të bësh më shumë për këto familje sepse janë duke heqë keq, prandaj bëra lutje ty i nderuar Kryetar, drejtoreshës së DSHMS, por edhe ne si Kuvend t'i përkrahim këto familje sepse janë duke heq. Llogaritni me pas

një familjar në shtëpi me autizëm sa është problem të trajtohet e lëre më një fëmijë, prandaj më vjen keq për këtë gjë dhe kërkoj që sa më shumë të ndihmohen ato familje.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i respektuar asambleistë, nuk ke nevojë të na lutesh sepse jeni organ legjislativ-Kuvend i Komunës, dhe unë vendimet e kësaj asambleje duhet t'i respektoj, pavarësisht se jam Kryetar i Komunës, prandaj nuk ke nevojë të më lutesh, vetëm gjejeni dhe propozojeni rrugën ju si asamble, përndryshe buxhetin e kemi miratuar në këtë Kuvend dhe atëherë është dashtë t'a ngritni zërin, atëherë ka qenë koha.

Nuk e di sakt a janë 32 apo 35 cent siç u tha, por e di që kanë qenë zero dhe tani jemi këtu ku jemi, zero kanë qenë, ne kemi filluar prej zeros dhe sot jemi këtu ku jemi. Unë nuk e kam zgjedhur këtë përqindje dhe sërish e them se nuk e di sakt shumën, por e di që atyre prindërve ju kemi lehtësuar punë dhe qëllimi jonë është t'jua mbulojmë të gjitha shpenzimet dhe t'jua lehtësojmë punën. E potencova se është OJQ, por se shumë shpejt do t'i punësojmë mësimdhënësit tanë në kuadër të Komunës të cilët do të punojnë me ata fëmijë, pra do të punësohen me pagë të rregullt dhe do ta kryejnë punën e vet sikurse me të gjithë fëmijët tjerë që janë në kategorinë e cekur, ndërsa sa i përket angazhimit të nënave të tyre që u cekë nga parafolësi, sigurisht që kujdesen për fëmijët e tyre sikurse që kujdesemi të gjithë ne sepse të gjithë kemi fëmijë dhe të gjithë kujdesemi për ta, kurse se ku presin, në oborre të shkollave apo në ndonjë kafe derisa të kryhet mësimi, ne nuk mund t'i mësojmë në ato çështje.

znj.Arnisa Sylejmani, përshëndeti të pranishmit dhe u'a uroj Festën e Bajramit, theksoi, nuk do të ndërlihem shumë tek raporti i Drejtorisë, mirëpo kam disa pyetje sa i përket pjesës së shëndetësisë e që janë momente që i kam përjetuar te pjesa familjare dhe personale.

Dua të di te pjesa e emergjencës së qytetit se në çfarë rastesh përgjigjet emergjenca e qytetit kur kanë nevojë qytetarët e Podujevës, e them këtë sepse në një rast personal emergjenca nuk i është përgjigjur thirrjes që është bërë nga qytetari duke i thënë se është në kuadër të kujdesit paliativ, ndërsa kujdesi paliativ nuk e ka marrë përsipër sepse ka thënë që nuk jemi të thirrur ne për këtë pjesë dhe se nuk kemi mjete as ta dërgojmë në emergjencë.

Është edhe një rast tjetër po te e njëjta pjesë rreth emergjencës, përgjigja që është dhënë nga stafi gjatë thirrjes ka qenë se nuk kemi shofer për ta dërguar emergjencën tek rasti.

Kemi edhe çështjen e Rëntgenit në emergjencë i cili nuk punon. Pastaj mendoj që te pjesa e barnave, ampulla ketenoll ka mungesë, e që mendoj se është një ampullë që është bazike dhe duhet të jetë, përse qytetarët ta blejnë atë sepse njëmend mendoj që është një prej ampullave më bazike sepse është ampullë kundër dhimbjeve.**z.Haki Rudari,** theksoi, në këtë informatë, te sektori i mirëqenies sociale, ndër të tjera po lexoj, kemi vizituar familjet në Lagjen e Dëshmorëve dhe në Lagjen e re, për të verifikuar banueshmërinë e tyre, andaj bash më intereson cila është gjendja reale në Lagjen e Dëshmorëve, a ka shtëpi të pabanuara, nëse po cilat janë masat që janë ndërmarrë, e them këtë për arsye se ka kërkesa për strehim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, disa çështje që deshta t'i ngris veç se u thanë, por po ndërlihem paksa te raporti i punës për këtë periudhë, me theks te shërbimet sociale në këtë raport dhe projektet e planifikuara dhe realizimi për vitin 2026. Këtu kemi rreth 15 pika, 13 pika ishin në projektim e sipër që i bie që disa ende nuk kanë shkuar në zyre të prokurimit, kurse disa u cekën që janë duke u bërë specifikat, ndërsa ne e dimë që nëse bëhet një ankesë kur të shpallet një përfitues, merr goxha kohë të gjatë.

Po ashtu deshta të di edhe sa i përket furnizimit me oksigjen, kush e kontrollon atë oksigjen, ka fjalë që oksigjeni nuk është i pastër ashtu qysh duhet të jetë. Ka të dhëna shembull që e fitojnë tenderin dhe pastaj aty ka edhe biznese industriale e marrin oksigjenin njëjtë, pra shembull, të ketë

saldim aty e merr dhe e dërgon në QKMF, pra nuk e di a matet cilësia e pastërtisë së oksigjenit me të cilin furnizohemi.

Sa i përket analizat nuk dua të hyjë shumë andej, mirëpo në Gllamnik mua më thanë që s'punojnë ose s'ka material të aparatit ose nuk punojnë, por tani u jepen disa shifra të analizave e që mua më duken goxha të çuditshme, shembull janar-prill u tha që janë lajmëruar 8 raste që janë vdekë, nuk e di por mua mu duk... sepse në këta katër muaj vetëm unë kam qen në rreth 20 varrime andaj e them se mu duk e paqartë, ndoshta kemi të bëjmë me ndonjë lëshim apo gabim teknik apo çka ishte ajo. Kryetari i Komunës nuk qenka këtu por përmendi ndihmat që i ka bërë, mirëpo nuk është ajo kurrëgjë sepse i ka marrë tre vetë të Shoqatave të dala nga lufta dhe i ka dërguar te Banja "Nëna Naile", pra 3 janë në vitin e kaluar, jo më shumë. Ka OJQ e cila nuk është e Podujevës fare por është e Pejës dhe që i janë dhënë 15,000.00€ për kurrëgjë hiç dhe nuk ka asnjë rezultat, kurse Shoqatave të dala nga lufta i janë dhënë 1500€ si dhe e ceku që i'u ka bërë vendin duke u'a lëshuar zyrë në objektin e ish Komunës, e që unë mendoj se vendi ka qenë aty dhe kurrfarë vendi s'iu ka bërë sepse kam shkuar 2-3 herë aty e nuk mund të qëndrohej prej erës së keqe aty, andaj nuk e për çfarë vendi foli ai sepse ata e meritojnë një trajtim pak më të mirë. Pastaj Kryetari e ceku "më herët s'jam bërë", po e vërtetë që nuk janë bërë por jeni Kryetar që 5 vite e që nuk ju ke bërë as ti, është dashtë të rritet hapësira dhe ndihma për ata.

Po ashtu kolegu parafolës shtroj temën shumë të mirë, dhe është e vërtetë që ajo kategori (fëmijët me autizëm dhe familjarët e tyre) jam duke heq ne mund të bëjmë më shumë sepse unë shembull e kam parë te vendimet e Kryetarit që ka ndarë mjete financiare dhe se i njohë shumë prej tyre që i janë dhënë shembull 4.000€ duke thënë se goxha rëndë i sëmure, e që unë e kam thirr personalisht e kam pyetur qysh i përfitove, përgjigja ka qenë; më ka thënë Kryetari merri këto e qitja fasadën shtëpisë, do të thotë ai person kurrfarë letër që është i sëmur nuk e ka dhe është më shëndosh se unë, andaj më mirë është t'ju ndahen atyre kategorive që u ceken, përndryshe sektori në fjalë nuk është se ka ndonjë lëvdatë.

z.Arben Xhemajli, theksoi, kam pyetje për drejtoreshën e DSHMS, përse në ambulanten në fshatin Kërpimëh analizat e biokomisë nuk bëhen, aparati është aty dhe para një kohe janë bërë.

z.Valdet Restelica, theksoi, sa i përket çështjes së shëndetësisë mua një gjë që më shqetëson është se më shumë është politizimi ku zakonisht pozitat menaxheriale po caktohen mbi baza partiake, e mandej menaxhimi po bëhet mbi interesa të ngushta politike dhe me propagandë, e jo në shërbim të qytetarëve dhe jo në shërbim të përmirësimit të shërbimeve të tjera, e që kjo çështje pastaj po dërgon në degradim, në përçarje dhe në humbje të profesionalizmit.

Do të ndalem edhe në disa pika. Kryetari nuk prezent tani, mirëpo te Instituti GAP e ka dhënë një premtim që ka qenë digjitalizimi, tani jemi në vitin 2026 dhe ende recetat përshkruhen me dorë, do të thotë se nuk ka sistem manual kompjuterik edhe përkundër që ka qenë premtim në vitin 2021, por që nuk është realizuar.

Po ashtu Kryetari e tha të përmenden me fakte dhe shifra, po faktet janë nganjëherë kokëforta sepse Rëntgeni jo që nuk punon që katër muaj por nuk punon fare, do të thotë prej janarit deri në prill është zyrtarë që Rëngeni nuk punon, e them këtë sepse e ka parë edhe personalisht kam qenë aty kur e kam pas rastin e lëndimit që Rëngeni në urgjencë nuk punon.

Mandej i kemi autoambulancat që janë në gjendje shumë të keqe, ka pas raste kur edhe kanë ngecur në rrugë, do të thotë janë në gjendje të mjerueshme.

Një çështje tjetër që e përmend edhe shefi i Grupit të LDK-së është se nuk ka planifikim për specialistë, ne e dimë që kemi mungesë të resurseve njerëzore, kështu që duhet bërë një planifikim dhe hapa konkret në mënyrë që të përmirësohet gjendja. Pastaj te çështja e analizave kur i përfundojnë qytetarët, nuk është një specialist i biokimisë kimike i cili i lexon ato analiza.

E kam edhe një çështje të keq menaxhimit që ka ndodhur apo qysh ta quaj, kur është fjala te shërbimi i emergjencës, do të thotë është fituar lëndën prej 58.000€ dhe veç nuk kanë dashur ta bëjnë atë pagesë kurse mandej përmbaruesi i ka marrë rreth 8.000€.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, e nderuara drejtoreshë e DSHMS, në raportin tuaj katër mujor shihet që figuron raporti se puna e stomatologut në urgjencë ditëve të diela punon nga ora 7:00 deri në 23:00, mirëpo ju them me bindje të plotë nga informacionet në terren që stomatologu ditëve të diela punon nga ora 7:00 deri në ora 15. Kështu që diçka tjetër kemi në raport, diçka tjetër kemi në terren, andaj ju lus të na jepni përgjigje.

Gjithashtu nëse më lejohet, kërkoj të na tregoni konkretisht për ato donacione që the se i kemi marrë, pse ka nevojë për donacione kurse ju thatë që ashtu qysh e paraqitët Drejtoria e Shëndetit është shumë në rregull, ndërsa ata ankohen edhe për mjete të thjeshta të higjienës.

Po ashtu më intereson shumë ta di, këto raportet edhe vizitat në terren që janë prej mjekëve, cilat janë konstatimet e tyre që i kanë marrë nga klasat I deri në IX-të nga vizitat e tyre nëpër shkollë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, atëherë drejtoresha e DSHMS ka kërkuar fjalën për përgjigje dhe sqarime.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e DSHMS, theksoi, faleminderit edhe njëherë të gjithëve për temat që ngritët dhe sigurisht që bashkërisht do t'i elaborojmë secilën prej tyre.

Po filloj me çështjen e ngritur nga z.Artrit Mulliqi e mandej çka do që mbet bosh, ju lutem të më rikujtoni. Sa i përket vizitave stomatologjike të përshkruara në raport, sigurisht që vlen të përmendët që stomatologjia pra është në të gjitha ordinancat janë mirë të furnizuara me material e gjithashtu edhe me pajisje somatologjike e po ashtu edhe me staf apo me doktorët e stomatologjisë, ndërsa pse shembull, qytetarët vendosin të mos shkojnë dhe të mos marrin shërbimet ajo mbetet në vullnetin e qytetarëve dhe ne nuk mund t'jua imponojmë se ku zgjedhin ata të shkojnë të marrin një shërbim të tillë, në institucionin publik apo privat, mirëpo e rëndësishme është që ne si institucion i kemi ofruar të gjitha mundësitë, pra e kemi bërë furnizimin me material të nevojshëm, me pajisje mjekësore të nevojshme për këtë fushë, gjithashtu edhe me mjek, por propozimi apo rekomandimi i Artritit patjetër që len të merret parasysh që të bëhet një kampanjë vetëdijesuese në mënyrën e informimit se cilat lloje të shërbimeve ofrohen apo që këto ose ato shërbime janë të furnizuara me të gjitha materialet dhe po ashtu edhe me pajisjet e nevojshme, kështu që patjetër ne do ta kemi parasysh këtë çështje.

Lidhur me temat që i ngriti z.Besim Latifi, sa i përket laboratorit në Rëntgen dhe Rëngenit në Urgjencë që punon 24 orë, kjo është e vërtetë mirëpo tani vlen të bëhet një sqarim sepse sa i përket laboratorit në fillim të vitit ka pas, është e vërtetë që ka pas mungesë të materialit të laboratorit dhe disa prej analizave nuk kanë mundur të ofrohen, e në këtë hynë edhe CRP, mirëpo unë e përmenda dhe gjatë informatës time sepse ky nuk është një raportim, por është një informatë, pra e përmenda që është bërë, është lidhur kontrata dhe tani furnizimi është duke u kryer në rregull, kështu që tani ofrohen të gjitha llojet e analizave të parapara, kurse sa i përket aparatit të Rëntgenit te Urgjenca, ai ka një defekt të cilin e kam përmendur edhe është e vërtetë ajo që kolegu z.Valdet Restelica e përmendi që nuk punon prej fillimit të vitit apo dhe prej muajit dhjetor të vitit të kaluar nëse nuk gaboju sepse tani nuk më kujtohet konkret cili muaj ka qenë, mirëpo fatmirësisht është bërë zgjidhja për të, është porositur pjesa e cila është djeg te ky aparat i Rëntgenit e cila është shumë e kushtueshme dhe po presim që brenda këtyre ditëve në afat sa më të shkurtë të sjellët dhe të rregullohet ai aparat e rrjedhimisht edhe të vëhet sërish në funksion për shkak që është prej aparaturave më moderne dhe më të mira. Pra e rëndësishme është që zgjidhjen e kemi bërë, kurse sa i përket pyetjes pse është djegur pajisja, ne nuk kemi mundur ta kontrollojmë dhe ta ndalojmë. Sa i përket analizës CRP, tani aktualisht është ofruar si shërbim, dhe veç e përmenda dhe nuk po e

përsërisë që ka pasur mungesë të materialit, por me lidhjen e kontratës së re është bërë furnizimi dhe aktualisht është duke u dhënë si shërbim.

Sa i përket çështjes së biokimistit, është e vërtetë që ne në QKMF Podujevë nuk kemi realisht biokimist, e kemi shpallur konkursin tre herë për këtë pozitë, por nuk ka pas aplikues, mirëpo çështja tjetër prapë më e rëndësishme është që ne javën e kaluar e kemi dërguar kërkesën në Ministri për mjek specializantë, e ndër të tjera në kërkesën tonë ne kemi kërkuar edhe miratimin edhe për mjek biokimist, do të thotë që t'i dërgojmë për specializim, kështu që në momentin që kjo aprovohet edhe ne jemi të gatshëm t'i dërgojmë. Pra po e them që nuk është diçka që ne e kemi lënë ashtu apo që ne nuk jemi marrë me këtë çështje, por është mungesa e mjekëve për specializim e që veç unë e përmenda që javën e kaluar e kemi dërguar kërkesën për 13 mjekë për specializim dhe uroj që të na aprovohet me krejt profilet që i kemi dërguar, kemi dërguar mjekësi familjare, mjekësi urgjente, biokimist, pediatër, për gjinekologji edhe uroj që të gjitha këto të na aprovohen dhe ne pastaj jemi të gatshëm të kontribuojmë në pjesën tonë të participimit lidhur me planifikimin e projekteve për vitin 2026. Tani unë e përmenda këtë dhe kjo është një informatë e punëve të cilat do të realizohen në tërë vitin 2026 në kuadër të DSHMS-së.

Nuk është e vërtetë ajo që u cek se prej 15 projekteve të planifikuara, 13 nuk kanë nisur, kjo sepse janë vetëm 2 projekte të Drejtorisë që nuk janë filluar, por janë në fazën e finalizimit, madje ndoshta njërin e nisim sot, e tjetrën e nisim nesër, më gjatë nuk shkon.

Kemi edhe një tjetër çështje që është kontratë e përbashkët komunale, ajo e servisimit të aparateve kundër zjarrit. Të tjerat të gjitha janë iniciuar e në disa prej tyre është lidhur edhe kontrata, të tjera janë disa prej tyre dhe në finalizimin e fundit për në fazën e prokurimit, kurse tani përse ne nuk i kemi filluar këto projekte në janar nuk është faji jonë e as i Drejtorisë apo i Drejtorive tjera sepse ne e dimë çështjen e buxhetit qysh ka qenë pa miratuar dhe nuk kemi pasë hapësirë për zotim të mjeteve dhe për t'i përcjellë pastaj si procedura të prokurimit, pra kjo është arsyeja pse këtë vit ka mbetur jo veç në DSHMS, por në të gjitha Drejtorinë paksa me vonesë, mirëpo edhe përkundër kësaj, nuk jemi me vonesë sepse i kemi kontratat tjera aktive.

Sa i përket pyetjes për AMF-të rreth funksionalizimit, ju them se 16 AMF janë aktive me mjek.

Në disa AMF është e vërtetë që mjekët qëndrojnë vetëm tre ditë dhe në disa vetëm dy ditë, dhe kjo është bërë në bazë të planifikimit të QKMF-së në bazë të hapësirave me mjek qysh i kemi, por edhe në bazë të frekuentimit të pacientëve, shembull, realisht ne mendojmë se në qoftë se në një AMF nuk ka shumë frekuentim dhe ndoshta krejt javën janë dy-tre raste, nuk është e arsyeshme të dërgohet rregullisht një mjek pesë ditë të punës rregullisht të qëndroj aty sepse vetëm po krijohen shpenzime qoftë institucionit por edhe për lokalitetet më të afërta siç janë shembull Dobratini me Bajqinën mund të shkojnë tre ditë e njëra dy ditë e kështu me radhë, mirëpo kemi edhe AMF që punojnë vazhdimisht çdo ditë të punës siç janë ato në Dobratin, Bradash, Llapashticë, Gllamnik, Sveçel, Batllav dhe Lupç ku për çdo ditë të punës është prezent mjeku i mjekësisë familjare në orarin e rregullt të punës.

Sa i përket ankesës në Bajqinë, Lupç dhe Majac, në këto AMF u tha se është një gjendje jo e mirë, por unë nuk pajtoj me këto çka ju po e ngrisni për shkak se kam vizituar Bajqinën dhe kam parë se gjendja është mjaft e mirë, mandej me orarin e qershorit do të ketë rregullime në mënyrë që mjeku të jetë sa më shumë prezent në bazë të nevojave të qytetarëve dhe të pacientëve. Përkundër kësaj, unë dua të përmend që sigurisht se ka hapësirë për përmirësim në çdo institucion sikurse edhe në institucionin tonë. Dhe ne në ato përpjekje jemi si dhe për atë arsye po i zhvillojmë këto projekte. Sigurisht që këto mendimet dhe sugjerimet e juaja patjetër që na ndihmojnë dhe neve në zhvillimin tonë, mirëpo në fund të ditës është mirë të përmendet një punë jashtëzakonisht e mirë që është

duke u bërë ndaj qytetarëve sidomos edhe prej shërbimit paliativ ku në çdo kohë po jemi prezent ndaj tyre dhe ndaj kërkesave të tyre.

Sa i përket asaj që e ngriti asambleisti zotëri Dervishollit rreth përkrahjes së OJQ-ve, për këtë veç foli Kryetari i Komunës dhe nuk kam çka të shtoj tutje, mirëpo në qoftë se keni sërish diçka tjetër ne do t'ju përgjigjemi përmes e-mailit. Ftesa ka qenë, është një komision i cili e ka bërë vlerësimin, ne jemi në vazhdimësi duke i përkrah jo vetëm përmes OJQ-ve por edhe me mjete financiare të tjera nga subvencionimi që bëhet përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kështu që çdo kërkesë e tyre merret parasysh, trajtohen edhe mandej përkrahen me aq sa kemi buxhet dhe mundësi. Po ashtu sa i përket fëmijëve me autizëm, Kryetari veç e përmendi që ne jemi në fazën e përpilimit të publikimit të konkursit, fatmirësisht në kuadër të një projekti me Ministrinë e Shëndetësisë është lejuar që Komuna e Podujevës të ketë të drejtë t'i punësoj dy psikologë, dy punëtorë social, dy fizioterapeutë dhe dy logoped, e që në këtë vit është paraparë edhe me buxhet, mirëpo vetëm kemi qenë në pritje të miratimit të Udhëzimit Administrativ i cili është miratuar në muajin maj, mandej tani kemi të drejtë t'i zhvillojmë procedurat e konkursit për këto pozita të lira dhe natyrisht se pastaj do të na lehtësoj jashtëzakonisht shumë punën qoftë neve si Komunë, qoftë familjeve me fëmijë me autizëm për shkak se pikërisht kjo është edhe detyra që do ta kenë punonjësit e profileve që i ceka, pra punëtorët social dhe të tjerët që do të jenë të angazhuar në kuadër të QKMF, pra kjo do të na lehtësoj punën edhe neve si institucion.

Edhe nga zonja Arnisa u ngritë pyetje sa i përket shërbimit të urgjencës së qytetit, sigurisht që ata janë të obliguar dhe i dinë mjaft mirë me rregulloren e tyre se cilat raste duhet t'i trajtojnë, pastaj cilat raste duhet t'i trajtojnë shërbimi paliativ, unë vërtetë çdo ditë nga qytetarët marr lëvdata për punëtorët e shërbimit paliativ për shërbimin që ofrojnë ata sepse po ashtu vërtetë na e ka lehtësuar të gjithëve jetën, kujtdo që na ka rastësisë me ndonjë rast në familje apo në rreth, e kemi parë sa e nevojshme ka qenë ky lloj i shërbimit, dhe sa të mirë e sa aktivë dhe me sa vullnet janë punonjësit e angazhuar në atë shërbim. E njëjta vlen edhe për shërbimin e urgjencës me atë sa unë e kam parë dhe me aq sa mund më raportohet. Lidhur me këtë çështje, unë ju inkurajoj t'i paraqitni ankesat te drejtoresha e QKMF-së, për shkak se vërtetë secila ankesë e juaj dhe gjithë qytetarëve do të analizohet, dhe pas kësaj mund të merren pastaj edhe masat e nevojshme qoftë edhe ato disiplinore nëse është e nevojshme varësisht rastit.

Asnjë projekt dhe asnjë punë e mirë nuk do të mund të bëhej pa pas ndonjë sanksion, e në qoftë se ne veç po themi ka punë të mira, ndoshta mund të jetë aty ndokush që po e devijon nganjëherë punën, prandaj për atë arsye janë masat disiplinore, dhe për atë arsye neve na nevojitet qytetari aktive sepse jo vetëm unë si Drejtoresh apo jo vetëm një Arnisë nganjëherë mund t'i shohin gjitha gjërat, prandaj për atë arsye duhet të na ndihmon kushdo që ballafaqohet direkt dhe nuk ka marrë ndonjë shërbim të mirë, dhe me këtë rast unë këtu publikisht i ftoj gjithë qytetarët që të dërgojnë ankesat në QKMF, dhe besoni se do të merren parasysh dhe në qoftë se ajo është e arsyeshme edhe vërtetohet sigurisht që do të ketë edhe masa disiplinore.

Automjete te shërbimi paliativ ka mjaftueshëm, por ne e kemi të paraparë dhe siç ju tregova janë iniciuar edhe procedurat e prokurimit për blerjen edhe të dy autoambulancave të reja, ndërsa sa i përket shoferëve sërish po e them se ka mjaftueshëm, madje ne i kemi edhe infermierët vozitës e që shembull jo çdo herë kërkohet shoferë të obliguar kur infermieri është vetë vozitës e që mund ta kryej vet këtë, pra konsideroj që kemi kapacitet të mjaftueshëm.

Se a ka ndoshta ndonjëherë neglizhencë të ndonjë individi, mund të ketë mirëpo kulturën e punës nuk mund t'ju mbjellim askujt as unë e as ju, secili e din vetë, madje unë ju them shpeshherë edhe stafit të personelit mjekësor kur ju adresohem edhe nëpër mbledhje, ju lutem të kryeni detyrat e juaja sipas kontratës të cilën e keni marrë, është një profesion shumë i shenjtë dhe në fund të ditës

secili e vendos ndërgjegjen e vet, prandaj t'i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë sipas kontratës, madje disa ditë më parë në një mbledhje unë ju kërkova që në qoftë se jeni lodhur apo po ju duket që s'ju kanë realizuar ndonjë kërkesë e juaja, apo jeni të pakënaqur, bëni një kërkesë për lirim të detyrës dhe keni mjaftueshëm të ri e të reja që po presin për t'u punësuar dhe ka të tillë që duan ta kryejnë punën me vullnet.

Sa i përket Rëntgenit të urgjenca, unë veçse e përmenda sepse edhe në informatë aty nuk është përmendur që e kam pas në plan, por më doli nga mendja, kështu që ajo është çështje ditësh për t'u rregulluar, po sa të vie pajisja e cila është djegë. Mandej te ajo ampulla që u përmendë nga zonja Arnisa, kjo nuk është porositur për shkak se ne kur i porositim barnat atëherë bëhet një far analize e viteve paraprake, shembull çka është shpenzuar, çka ka nevojë të porositet dhe çka jo, për shkak edhe të mos harxhimit të buxhetit pa arsye, atëherë mjekët vetë kanë sugjeruar që këta përshkruajnë një lloj barëre tjetër që shërbejnë për të njëjtin qëllim apo funksion, dhe këta nuk e preferojnë ampullën në fjalë, andaj për atë arsye nuk është bërë porosi e asaj ampulle, përndryshe kërkesat për porosi të barnave na vijnë nga QKMF dhe personat që drejtpërdrejtë punojnë me to.

Lidhur me pikën që ngriti kolegu z.Haki Rudari, sa i përket çështjes të mirëqenia sociale si sektor i gjendjes sociale dhe Lagjes së Dëshmorëve, unë e përmenda që ne në vazhdimësi bëjmë vizita te Lagjja e Dëshmorëve dhe te Lagjja e Re dhe vizita të tilla i kam kërkuar me qëllim sepse vërtetë kemi kërkesa të mëdha për strehim të qytetarëve dhe jo të gjitha po mund t'i mbulojmë shembull me donator të ndërtimit të shtëpive, atëherë kemi dhe këto dy Lagje në menaxhim, prandaj kam kërkuar që të vizitohen dhe të verifikohen pikërisht për arsyen se në qoftë se është ndonjë shtëpi e pabanueshme atëherë të lirohet edhe t'i jepet një familje e cila është në nevojë.

Sa i përket Lagjes së Dëshmorëve, janë 112 familje të cilave ju kanë dhënë shtëpitë për banim, kryesisht janë Familje të Dëshmorëve, mirëpo në bazë të vizitave që ne i kemi realizuar, dy prej atyre shtëpive janë të pabanueshme dhe procedurat të cilat ne jeni duke i ndjekur aktualisht jemi në fazën e bisedimit me familjet që nuk janë duke banuar më, janë Familje të Dëshmorëve dhe është paksa një rezistencë e tyre për t'i liruar shtëpitë për shkak se ata thirren që, me gjithë respektin ndaj tyre sepse patjetër që është një çështje e ndjeshme dhe po flasim për Familje të një kategorie ndjeshme, mirëpo thirrën në ato që një anëtar i familjes së tyre ka dhënë jetën për këtë vend andaj përse po ju kërkohet ta lirojnë shtëpinë, mirëpo unë çdo herë po ju them, përderisa keni bërë zgjidhje për banim, nuk është mirë një familje tjetër të mbetet në rrugë këta t'i mbajnë shembull dy shtëpi. Prapë edhe ajo nuk është një gjë e mirë, mirëpo në fund të ditës do të ndjekim edhe procedurat tjera ligjore derisa të bëhet lirimi i atyre shtëpive. Një shtëpi e kemi dhe tek Lagjja e Re, por atë jemi duke e vërtetuar për shkak se herë pas here kthehet një familje dhe jeton aty, kështu që jemi duke e monitoruar çdo muaj edhe do të konstatojmë gjendjen, mandej në muajin gusht do t'ju vazhdojmë kontratat e pastaj do të vijmë në një konstatim për vazhdimin ose mos vazhdimin e kontratës me ta.

Sa i përket kolegut z.Ekrem Rrahmani i cili ngriti sërish çështjen e inicimit të projekteve, unë sërish po them se këto janë projekte të cilat janë paraparë për krejt vitin, shpjegimet veç i dhashë se ka qenë sfida e miratimit të buxhetit që nuk është lejuar të iniciohen projektet më herët në prokurim, por që në momentin që na është lejuar ne i kemi iniciuar të gjitha projektet, mirëpo tani edhe për shkak të vlerës së projektit ka dallime mes projekteve dhe po ashtu edhe te procedura që zhvillohet por edhe tek afati i kryerjes në prokurim, nuk varen nga ne sepse janë procedura të ndryshme që dallojnë nga projekti në projekt. Prapë po ta them zotëri Rrahmani që 13 prej tyre janë iniciuar dhe vetëm 2 prej tyre sa i përket DFSHMS-së nuk janë iniciuar, përndryshe aty në informatë mund me të jetë shkruar që janë në inicim dhe është shumë e vërtetë, por ndoshta më ke

dëgjuar kur unë e thashë në fillim që janë në prokurim sepse kjo informatë ju është dërguar para rreth 2-3 jave, mirëpo mandej në këto dy-tre javë ne i kemi zhvilluar këto procedura.

Pastaj edhe këto dy të tjerat që kanë mbetur, që janë enkas të DSHMS-së ne po planifikojmë që deri nesër t'i iniciojmë, ndërsa ajo që është e përgjithshme komunale pastaj inicohet kur të jemi gati të gjitha Drejtoritë.

Lidhur me kontrollimin e oksigjenit, që po ashtu e ngriti zotëri Rrahmani, në qoftë se mund të më falësh për këtë çështje që përgjigjen më konkret t'jua kthej përmes e-mailit gjatë javës sepse nuk është që po mund të them tani diçka konkretisht, edhe pse ne e kemi një komision të pranimit teknik, por kështu që më lejoni që të marr unë një informacion nga ana e tyre lidhur me shqetësimin e ngritur nga ana juaj e mandej do t'ju drejtohen përmes e-mailit.

Sa i përket asaj që u tha se mjete financiare kanë shkuar për fasada, aty nuk po lëshohem sepse ato mjete janë lëshuar subvencione për familjet apo për personat aplikues me probleme shëndetësore, pra bazohen në raporte dhe diagnoze të cilët ata i bashkëngjisin, pastaj ne kemi një komision i cili bënë vlerësimin e tyre dhe nuk po besoj që ndonjëri prej nesh do të keqpërdorte në një rast të tillë, apo edhe në asnjë rast tjetër.

Po ashtu kolegu asambleistë zotëri Xhemajli e tha se në fillim se nuk ofrohen shërbimet e analizave në Kërpimëh, është e vërtetë që atje ofrojmë shërbimet e analizave edhe është e vërtetë që aty e kemi një laborant, mirëpo unë jam njoftuar që kohëve të fundit laborantja në Kërpimëh nuk është në gjendje të mirë shëndetësore, dhe për atë arsye herë pas herë ka mungesa të laborantit, por është e rëndësishme që ofrohet si shërbim nga ana jonë, është e pajisur me material dhe me pajisje tjera të nevojshme.

Pastaj nga zonja Gresa u ngrit shqetësimi sa i përket stomatologut në urgjencë, të dielave, unë jam e informuar që kemi stomatologun dhe që ofrohet si shërbim në urgjencë, në qoftë se e keni ndonjë rast që vërtetë nuk është duke u jap si shërbim, ju lutem, qoftë edhe ditëve të diela....

znj.Gresa Qosa-Maqastena, nga vendi i drejtohet drejtoreshës se pyetja ishte shumë konkrete, me informacione të mjekëve që punojnë aty ju them me sigurinë më të plotë që stomatologu ditëve të diela nuk punon prej orës 7:00 deri në ora 23:00, por punon nga ora 7:00 deri në ora 15:00).

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoreshë e DSHMS, vazhdoi, ju lutem deri sa unë ju dëgjova, tani po jap përgjigjet, deri në ora 15:00 është njëri orar kurse mandej është orari tjetër nga ora 15:00 deri në ora 23:00, prandaj ne veçse e kemi bërë një përfshirje që prej orës 7:00 deri në ora 23:00 jepet si shërbim, ama janë me dy orare, do të thotë 07:00-15:00 dhe 15:00-23:00, por në qoftë se aty dikush edhe prej stafit paska thënë që nuk vjen stomatologu, atëherë le t'a ngrisin edhe ata këtë çështje dhe të bëjnë ankesë, pra të na informojnë, përndryshe unë patjetër që do të merrem me këtë çështje sepse e kemi një menaxhment atje shumë të përgjegjshëm si dhe një shef të urgjencës, kështu që patjetër se do të merrem me këtë rast.

Çështja tjetër ishte ajo që u ngrit nga z.Valdet Restelica, sa i përket planifikimit për specializim, konsideroj që u dha përgjigja, pra janë dërguar kërkesat dhe vetëm po presim prej Ministrisë, uroj që të na i përkrahin të gjitha. Pastaj sa i përket sistemit të dixhitalizimit, ai sistem veçse është duke u përdorur, do të thotë sistemi SISH përdoret dhe është në funksionim, tani kjo më duket ka hyrë më vonë si sistemi i SISH, që të mos japë informacione të gabuar, mirëpo është duke u përdorur si i tillë, ndoshta nëpër AMF ka që nuk përdoret në masë të madhe, mirëpo edhe për këtë kemi pas një takim me stafin edhe duke krijuar një vetëdijësim me ta, por edhe një monitorim të tyre që të gjitha rastet të vendosen në SISH.

U mundova të jap përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme secilit në çështjet e ngritura, nëse ndokujt i mbeta borxh, ju lutem më rikujtoni, por gjithsesi ju faleminderit shumë për kontributin e Juaj.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, Drejtoresha parafolëse e DSHMS e tha që te projektet e planifikuara dhe të realizuar, kurse unë e thashë që 13, por në fakt qenkan 15, ndërsa vetëm 1 është kontratë në realizim, të tjerat janë në procedurë të prokurimit. Pra unë bazohem në shkrimin dhe materialin që na është dërguar, t'i drejtoresh ndoshta ke mund që në foltore të thuash ndryshe, mirëpo unë jam përgatitur në bazë të materialit që na është dërguar.

Nuk e thash që nuk bëhen, por e thashë që duhet ditur që puna e prokurimit mundet me pas edhe ankesa dhe mund të zvarritet, nuk thashë që nuk bëhen këtu, por thashë edhe vonë edhe puna e prokurimit është ashtu. Mundet me dalë dikush fitues, ka ankues që mund të shkoj procedurë dhe mund të kaloj i gjithë viti e mos të bëhen. Unë e thashë 13 me 2 sa i përket atyre procedurave dhe kontratave, por qenkan 14 me 1, pra vetëm 1 është në realizim furnizim me oksigjen që ka kontratë të nënshkruar dhe që është në realizim. Edhe te çështja e pastërtisë së oksigjenit unë besoj që te kushtet e kontratës, edhe pse s'e kam shikuar, duhet të jetë e specifikuar dhe që të ketë A-test sepse siç e ceka që ka edhe kompani industriale që marrin oksigjen në të njëjtin vend, tash nuk e di unë ai i ka dalluar ai, mirëpo shembull, edhe oksigjen për saldim në një vend edhe oksigjeni për me i dhënë frymëmarrjen një pacienti në të njëjtin vend, nuk më duket bash sa në rregull. Po ashtu sa i përket çështjes së analizave në Gllamnik, e thash që s'po punon por që nuk mora përgjigje apo ndoshta po por nuk isha për disa qaste në sallë.

Gjithashtu te çështja e kërkesës që e ceke për mjek e nderuar drejtoreshë, unë besoj që e ke parë Ligjin sipas të cilit tani nga viti 2027 do të na cungohet numri i stafit shkaku i zvogëlimit të numrit të popullsisë, pra do të paraqiten probleme sepse Ligji e cek që numri i stafit do të jetë në bazë të numrit të banorëve e që në këtë rast Komuna e Podujevës ka dal të ketë pak mbi 71000 banorë, mandej është çështja se sa AMF duhet të jenë funksionale, sa mjekë duhet të kemi, sa infermier e gjëra tjera. Prandaj unë besoj që duhet konsultuar goxha mirë Ligjin para se të dërgohen kërkesa, në mënyrë që të mos ndodh të marrim njerëz në punë në këtë vit 2026 (që u ceken 16) kurse pastaj në vitin 2027 të na bie t'i heqim për shkak të Ligjit, e që një gjë e tillë ka qenë e planifikuar të zbatohet tani në vitin 2026 por për shkak të shumë procedurave, është shtyrë për në vitin 2027.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e DSHMS, theksoi, deshta vetëm edhe një përgjigje të shkurtër për parafolësin zotëri Rrahmani, përndryshe unë u përgjigja por në atë kohë qenka dal jashtë, Atëherë sa i përket planifikimit, edhe njëherë po e përsëris që kjo informatë tash ndoshta mund me qenë gabim, mirëpo është dërguar para dy-tre jave te Zyra e Kryesuesit dhe gjatë kësaj kohe tashmë unë nuk kam mundur të ndalem dhe të mos inicioj ose të mos punoj asgjë.

Në atë periudhë kur unë e kam dërguar informatën gjendja ka qenë kështu e projekteve sepse nuk kemi qenë duke punuar në to, mirëpo mandej ndoshta atë ditë kur është dërguar informata është dërguar një projekt, pastaj edhe dy javët tjera janë iniciuar projekte të tjera. Unë vetëm po dua të tregoj që përderisa po e përmendet që kjo ka qenë gjendja kur është dërguar informata dhe po i tregoj punët që janë zhvilluar deri sot, atëherë unë e konsideroj që ne jemi në rregull, dhe e rëndësishme është që projektet janë iniciuar dhe janë në fazën e prokurimit, edhe pse nuk janë iniciuar më herët, sërish unë e përsërita dhe po e ripërsëris që nuk ka qenë vetëm problemi i DSHMS-së tek ne Podujevë por i të gjitha Drejtorive dhe në gjithë Kosovën për shkak që nuk është lejuar të zhvillohet asnjë procedurë e prokurimit pa pas zotime të mjeteve buxhetore dhe pa qenë buxheti i miratuar. Në momentin që është miratuar buxheti, ne i kemi përcjellë, pra kemi filluar të punojmë me projektet edhe i kemi iniciuar, besojeni këtë dhe rrini pa merak sepse me të gjitha jemi duke u marrë me shumë seriozitet edhe ka kontrata aktive.

Unë i përmenda që të mos rikthehem sërish, vetëm një kontratë nuk e kemi, te servisimi i pajisjeve mjekësore. Edhe një çështje është e vërtetë që programin nuk e kemi funksional në QKMF për

shkak të një pajisje që sërish nuk po i funksionon, por është paraparë në këtë kontratën e re të servisimit të pajisjeve mjekësore, në momentin që lidhet kontrata, ajo çështje do të rregullohet.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, e nderuar drejtoreshë e DSHMS-së, më vie keq por në Lagjen e Dëshmorëve nuk janë 112 Familje të Dëshmorëve por janë 15 deri 20 Familje të Dëshmorëve, nuk janë 112. Totali i krejt banorëve të shtëpive që janë aty janë 50 deri në 60 që përfshihen edhe invalidë, veteranë dhe Familje Dëshmorësh, pra edhe njëherë e them se nuk janë 112, përndryshe ato janë raste sociale.

Sa i përket asaj që e cekët se keni biseduar me dy Familje të Dëshmorëve lidhur me i lëshimin e shtëpive, është e vërtetë që keni biseduar, ka biseduar edhe drejtoresha para juve për këtë çështje, mirëpo nuk e di sa është e nevojshme të diskutoni këtu në Kuvend për 15 deri 20 shtëpi të Familjeve të Dëshmorëve kur ato ju takojnë atyre. Po besoj që secili prej neve e din që nuk janë 112 Familje të Dëshmorëve e nderuar drejtoreshë, por janë 20.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e DSHMS, theksoi, e falënderoj kolegun dhe do e ftojta paraprakisht që kur ta ngrit një çështje, paraprakisht ta dëgjoj parafolësin se qysh e ka thënë, e jo të bëjë keqinterpretim, si dhe të mos e shndërroj çështjen në fjalë për të marrë poena personale. Kur është në pyetje me Drejtorinë të cilën e përfaqësoj unë, këtë gjë s'ia lejoj as vetes, pra punën grupore që bëjmë bashkërisht nga të gjithë personat të cilët punojnë në DSHMS ta kthejmë në punë apo merita individuale të vetëm një personi.

Sa i përket asaj që thashë unë 112 Familje jetojnë, unë e thash prej tyre janë edhe Familje të Dëshmorëve, do të thotë nuk e ceka që 112 janë veç Familje Dëshmorëve, të jemi të qartë në këtë, kurse sa i përket 15 Familjeve që e tha parafolësi, unë prapë e thashë se kemi shumë respekt për këtë kategori, dhe tani mos ta kthejmë në këtë për me marrë një poen që unë po i mbroj ato Familje sepse edhe ne jemi për t'i mbrojtur, edhe ne jemi ithtar për t'i mbrojtur ato Familje dhe për të mos i'u shkaktuar asnjë dëm qoftë më i vogli, mirëpo në momentin kur ke një familje që ndoshta flenë në rrugë ose që është në rrezik për t'ju rrënuar shtëpia kurse dikush tjetër i mban dy shtëpi, në një jeton sepse në të dyjat përnjëherë s'mund të jetoj. A është më e logjikshme dhe a është më njerëzore, a i bëjmë më nderë atyre që kanë sakrifikuar për këtë vend që t'i dorëzojnë çelësat e shtëpive vetë vullnetarisht e jo të thirret një drejtoreshë apo Kryetari i Komunës.

Sa i përket atyre që kanë dhënë jetën për liri, ata kanë luftuar për lirinë e vendit, jo për me marrë shtëpi, kështu që aman ju lutna të mos e përdhosim emrin e tyre duke u thirrë në atë që është Familje e Dëshmorëve. Edhe unë e vlerësoj që janë Familje e Dëshmorëve dhe e meritojnë trajtimin më të mirë dhe më të njerëzishëm prej të gjithëve duke falënderuar për kontributin që e kanë dhënë, mirëpo nuk është e njerëzishme që dikush me i mbajt dy shtëpi e të jetoj vetëm në njërin kurse dikush tjetër të rrezikohet ndoshta edhe rrënimi i kulmit mbi kokë. Unë nuk jam për ta dëmtuar askënd, as personalisht e as institucionalisht. Sërish po e rithem që Dëshmorët kanë luftuar edhe kanë derdhur gjakun për liri, jo për shtëpia.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, me gjithë respektin, përsëri për ju e nderuara drejtoreshë, sa i përket çështjes që e ceka rreth Familjeve të Dëshmorëve, ato shtëpia janë ndërtuar dhe janë ndarë 15 vite pas lufte, nuk i kanë marrë menjëherë pas luftës, pra duket e paarsyeshme të diskutohet kjo temë dhe të thuhet se po diskutohet për përfitime politike, jam i fundit këtu që dua të përfitoj në aspektin politik në lidhje me këtë çështje, andaj më vie keq, e ke adresuar çështjen te njeriu i gabuar.

z.Ermal Osmani, theksoi, e nderuara drejtoresh e DSHMS, nuk deshta të lidhem në këtë pikë, por sa i përket QMF-së në Gllamnik, as për poena politike, as për asgjë tjetër nuk e ceka, por eja bashkë shkojmë e shikojmë a bëhen analizat aty. Pra më kupto drejtë, nuk po bëjë politikë as asgjë në këtë aspekt.

Pastaj kur drejtoresha i adresoi përgjigjet, e ceke drejtoresha e QKMF-së e që tani e pashë dhe mu kujtua postimi i ish drejtorit të QKMF Bajram Bajgora i cili thotë se me një vendim arbitrar jam shkarkuar më datë 24.04.2026, pra është mirë të na tregosh se kush e ka dhënë atë vendim, arsyetimin e tij, a ka pas ky drejtori performancë të dobët apo qysh e keni shkarkuar, sepse ai me konkurs të rregullt po thotë që është pranuar, andaj me çfarë baze e keni shkarkuar, apo ndoshta vetëm po shkarkoni e po ngarkoni drejtor e drejtoresha ashtu qysh e keni bërë këtë tani, prandaj do të ishte mirë të na jepni një përgjigje edhe për këtë temë.

Sa i përket Gllamnikut, mund të shkojmë dhe të shikojmë qysh tani a po bëhen analizat apo jo, unë i bëjë analizat fare s'ka problem.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e DSHMS, theksoi, faleminderit shumë i nderuar Ermal për pikat që ngrite, sigurisht që unë nuk do të lëshohem në atë që komentoj rreth asaj që u tha “po ngarkoni e po shkarkoni” sepse s'është e nivelit tim, përgjegjësia ime si drejtoresh komunale e DSHMS qëndron mbrapa një vendimi të komisionit disiplinor, që është zbatuar, më tutje nuk kam çfarë të shtoj sepse për shkak se ai vendim është publik, mundet me u publiku sepse i është ndarë të gjitha palëve në procedurë dhe çdo përgjegjësi e imja qëndron mbrapa atij vendimi që ne mendojmë se është ligjor. Nëse ka ndonjë kundërshtim tjetër janë organet përgjegjëse para të cilave unë mund të jap llogari apo përgjegjësi mbi veprimin të cilin e kam marrë apo që e kemi marrë realisht duke zbatuar vendimin e komisionit disiplinor. Është e vërtetë që është emëruar një U.D. një drejtoreshë në QKMF që është doktoresha Venerë të cilën e përshëndes, i uroj suksese në punën e saj por edhe drejtorin paraprak e falënderoj për kontributin të cilin e ka japë, edhe mendoj që bashkërisht duhet të punojmë në shërbim të qytetarëve dhe për punë e mira për qytetarët.

Sa i përket Gllamnikut që sërish u cek për analiza, me patjetër ne mund të shkojmë, unë e di që ofrohen si shërbime dy herë në javë, është laboranti atje, mirëpo prapë mundemi ta shikojmë qoftë edhe bashkërisht se a po ofrohen këto shërbime.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju pyes fillimisht nëse ka shumë diskutime mund ta ndërpresim seancën dhe të marrim një pauzë, andaj ju lus të lajmëroheni kush do të diskutoj ende në këtë pikë. Atëherë janë lajmëruar vetëm 3, po e vazhdojmë edhe këta tre dhe e përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës para se të shkojmë në një pauzë.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, e nderuar drejtoreshë kam edhe një pyetje rreth planifikimit për specialistë, a keni planifikuar edhe ndonjë klauzolë që këta specialistë që rekomandohen prej Podujevës posa të përfundojnë specializimin, shërbimet t'i kryejnë në Podujevë sepse kemi pas raste që janë rekomanduar prej Podujevës, kurse sot i kemi specialist nëpër shumë qytete e qendra të tjera, ndërsa Podujeva ka mbetur keq.

z.Isak Ejupi, theksoi, përshëndetje e veçantë për drejtoreshën e cila e ka sjellë një raport edhe përmbajtësor po edhe që i dha sqarimet e nevojshme për neve gjatë kësaj pike.

Unë kam nevojë për një sqarim shtesë, meqë e potencuat që është në procedurë çështja e konkursit për mjekë, nga e kaluara, po në profile të ndryshme, unë e kam një përvojë jo të mirë, me këto konkurse, do të thotë për ko incidencë unë e kam një kushëri i cili qe tre herë ka aplikuar këtu edhe është refuzuar, ndërkohë që ai ka diplomuar në afat rekord dhe notën mesatare e ka pasur 9.6, kurse është pranuar në vend të tij një mjek që me shumë vështirësi e ka kryer fakultetin e mjekësisë dhe që notën mesatare ka dukshëm më të ulët se ai. Këtë çështje e ngrita për arsye se ky konkurs që tash është në procedurë është në interes publik, të merren mjekët që janë kompetentë, që kanë nivel të kënaqëm profesional, por edhe që nuk është me rëndësi ajo që dikush e përmendi, politizimin. Unë po them sinqerisht që në çështjet e arsimit dhe të mjekësisë, në fakt nuk është mirë në asnjë fushë, mirëpo sidomos këto dy fusha të politizohen në këto konkurse dhe këto procese, sepse dëmet pastaj janë të pariparueshme.

Unë po të kërkoj e nderuara drejtoreshë e DSHMS-së, nuk di që cili komision do t'i bëjë vlerësimet e këtyre aplikantëve, por megjithatë duhet të ketë kritere, në radhë të parë profesionale dhe ato kritere duhet të respektohen në maksimum në mënyrë që ne të marrim mjek kompetent dhe të përgjegjshëm për punën që e marrim.

z.Besim Latifi, theksoi, unë fillimisht e mbështes atë që tha kolegët parafolës z.Isak Ejupi dhe z.Artrit Mulliqi, tek kjo kërkesa për dërgim të specialistëve të rinj, mendoj që ne si Komunë duhet me parë cilat janë mundësitë që për ndihmë ata me i jep shërbimet në Komunën tonë edhe për qytetarët e Podujevës, prandaj nëse veç keni mundësi në bashkëpunim me Ministrinë t'i dërgoni atje. Ajo çka dua të them është se mirë që ekziston opozita dhe ekziston Kuvendi për arsye se po debatohen çështjet dhe po jepen kritika e vërejtjet e që duhet të merren si normale dhe duhet të trajtohen seriozisht sepse janë kërkesa dhe nevoja të qytetarëve të cilët i hasim përditë, secili prej prizmit të vet. Ju si Ekzekutiv edhe ne si Kuvend marrim jashtëzakonisht shumë kërkesa të cilat kërkojnë trajtim në këtë Kuvend dhe të ngritën si çështje si çështje.

Është mirë që drejtoresha e DSHMS-së po i pranon si vërejtjet edhe po i jep përgjigjet dhe po shihet që ka telashe në këtë fushë dhe ka nevojë për përmirësime në shumë shërbime, do të thotë nuk është vetëm bardh por edhe zi, mirëpo ka nevojë për përmirësim të shërbimeve.

Ajo çka po më pengon më së shumti është diskursi i Kryetarit që po i merr krahasimet zero dhe 100, pra me dy vlera, do të thotë bardhë dhe zi, do të thotë duhet ditur që viti 2020 dhe viti 2026 dallojnë me gjithçka, dallojnë për nga buxheti, sot keni një buxhet dyfish thuajse që Komuna e ka buxhetin më të madh, ka progres dhe që secili njeri qoftë edhe në aspektin personal është normale të ketë avancim e lëre më institucionet, mirëpo ideja është çka mund të bëhet më shumë.

Unë e pata një pyetje që nuk mora përgjigje, kishte të bëjë me Dobërdolin përse nuk po funksionalizohet, do të thotë është një fshat që ka një numër të madh të banorëve.

Edhe tek një çështje e analizave që po bëhen pa biokimist., nëse rezultatet i këtyre analizave janë diskutabile edhe nuk jeni biokimist, atëherë sa ja vlen të jepet një shërbim i tillë për qytetarët e Podujevës kur nuk ka siguri në rezultate për shkak se mungon profesionisti i një fushë të caktuar.

Tek një çështje që s'kisha dashtë të diskutoj shumë, mirëpo besoj në një prej seancave të radhës, ka të bëjë me një komision hetimor për rastet e subvencioneve në shëndetësi në vitin 2025, do të thotë vetëm si blic po e ngriti këtë sepse kam parë që kanë përfutur njerëz të cilët lidhje me atë temë nuk kanë, kurse e dimi që ka shumë nevojtarë në Komunën e Podujevës me sëmundje të cilët kanë nevojë për mbështetje financiare dhe për ta orientuar buxhetin, do të thotë dikujt me kancer i janë ndarë 200€, kurse një personi tjetër i ndahen 4.000€, pra kemi të bëjmë me vlerë, prandaj cilat janë kriteret për një vlerë të caktuar për t'u subvencionuar dikush, përndryshe si temë sigurisht që do ta trajtojmë në një seancë tjetër sepse besoj ka nevojë aty të shohim se çka ka ndodhë.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoreshë DSHMS-së, theksoi, patjetër që ne jemi këtu për t'i pranuar secilën kritikë, vërejtje apo sugjerim të juaj për shkak se DSHMS nuk duhet të funksionoj vetëm me një drejtor/sh sepse sot jam unë Liria, nesër vie tjetri/a, mirëpo është mirë të funksionoj bashkërisht sepse vetëm me diskutime në këtë formë mund t'ju bëjmë zgjidhje problemeve. Realisht nuk po jepen shërbime për individ të caktuar, por për krejt qytetarët e Komunës së Podujevës ku edhe ne jemi pjesë e tyre, pra ne bashkërisht po folim për t'i përmirësuar shërbimet dhe cilësinë e shërbimeve në shëndetësi e për çka jo vetëm sot por kjo do të jetë e hapur çdo herë, madje edhe kolegu juaj e din se unë ju kam kthyer edhe përgjigje edhe përmes e-mailit, kështu që në çdo kohë kush do që dëshiron informata unë do t'i jap, jeni të lirë të kontaktoni me e-maile dhe bashkërisht të kontaktojmë për t'ju jap zgjidhje qytetarëve.

Sa i përket asambleistit z.Artrit Mulliqi, atë gjë e kemi menduar edhe ne bashkë me drejtoreshën e QKMF-së dhe me Kryetarin e Komunës kur e kemi dërguar kërkesën në Ministri e që është e

vërtetë që në kontratën që do të lidhet me mjekët që e fitojnë specializimin ka me qenë edhe një klauzolë që t'i detyroj dhe obligoj ata që së pari të kthehen për të jap shërbimet në QKMF sepse është e vërtetë që shpenzimet në si Komunë po i bëjmë ngase ajo nuk është e gjitha e Ministrisë për të participuar por edhe nga ana e Komunes me buxhetin tonë, por që ka ndodh që pastaj ne po mbesim pa ata mjek e që mandej po ndikon edhe keq sa i përket shërbimeve shëndetësore sikurse që është rasti i biokimistit, kjo me patjetër që do të jetë pjesë e kontratës së tyre.

Sa i përket ë çështjes së Dobërdolit, përgjigjen do t'jua jap përmes e-mailit më në detaje në qoftë se e mirëkuptoni këtë. Ndërsa sa i përket analizave unë nuk kisha thënë që duhet me dalë jashtë funksionit ose mos me u ofruar si shërbim për shkak se është jashtëzakonisht i rëndësishëm për qytetarët përderisa ne i kemi laborantët, mirëpo biokimistin unë ju sqaroja që ka qenë një konkurs tre herë, nuk ka aplikuar askush, pra po jemi në procedura të cilat nuk po varen nga ne, do të thotë pjesa që neve na ka takuar e kemi bërë, madje të pamundurën për ta realizuar dhe tani jemi në pritje të konfirmimit.

Po ashtu kolegu asambleist z.Isak Ejupi e ngriti një çështje sa i përket konkurseve, besoni që edhe unë jam ithtare që të gjithë ata njerëz të cilët e meritojnë të hyjnë dhe të punësohen, njerëzit që shkollohen edhe meritojnë. Dua të besoj dhe besoj që të gjithë njerëzit të punësohen sipas meritave. Është një komision i cili i vlerëson, mirëpo në ato fjalët dhe kërkesat e juaja po i'u bashkëngjitem edhe unë dhe po i drejtohem komisionit vlerësues që të bëjnë vlerësimin korrekt edhe të hyjnë njerëzit meritator nëpër pozita të cilat aplikojnë.

Uroj të mos i kem mbetur borxh askujt, atyre që ju thashë për dy-tre përgjigje do t'jua kthej përmes e-mailit ku do t'ju përgjigjem në afatin sa më të shkurtër.

Ju falënderoj shumë të gjithëve që e pasuruan informatën e DSHMS-së.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, edhe unë dua t'ju përgëzoj për kërkesën drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë për specializim të mjekëve apo profileve deficitare, uroj që të mos presim me vite derisa t'i kryejnë ato specializime. Po ashtu të shikoni mundësinë mos rastësisht ka të tillë që kanë diplomuar tash së fundmi, andaj përsëriteni konkursi në mënyrë që të afrohet një zgjidhje.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoreshë DSHMS-së, theksoi, vetëm deshta t'i përgjigjem edhe zonjës Gresa sa i përket donacioneve, ne kemi pasur një pjesë të atyre pajisjeve, mirëpo përderisa të na vie një donacion që ndihmon QKMF-në dhe urgjencën, atëherë ne nuk kemi nevojë që t'i refuzojmë, janë të mirëseardhura kushdo që sjell donacione për urgjencën, për shëndetësinë, por edhe në mirëqenie sociale, çdo herë kanë me qenë të mirëpritura. Meqë po kërkojnë detaje, po unë atëherë do t'jua dërgoj me e-mail një raport se kush kanë qenë donatorët dhe cilat donacione i kemi pranuar nga janari deri më tani. Pra ne i gëzohemi donacioneve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

Atëherë meqë po shohë që është kërkesë e të gjithëve thuajse të shkojmë një pauzë, por ju kisha lutur që të kthehemi në ora 14:00 për të vazhduar me këtë mbledhje.

Kuvendi shkon në pauzë, dhe atë nga ora 13:10

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 14:25.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: *Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Luljeta Muçolli-Azemi; Vlora Jashanica; Haki Rudari; Abedin Zeka; Qëndresë Hajrizi, (nuk ishin prezent: Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Flandra Kadriu; Avni Islami; Ardi Hasani)*

Nga LDK: *Enis Dervisholli; Besim Latifi; Valdet Restelica; Blerta Azemi-Berisha; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Gresa Qosa-Maqastena; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani, (nuk ishin prezent: Enis Shabani; Alisa Jetullahu; Valon Demolli; Isak Ejupi)*

Nga PDK: *Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Rinesa Goxhufi (nuk ishin prezent: Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu) Rinesa Goxhufi,*

Nga GUXO: *Demokrat Hodolli, nuk ishte prezent.*

Nga Unioni i Blakçorve: *Gentrit Arifi.*

Nga AAK: *Baki Feta, nuk ishte prezent.*

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Ditjona Statovci-Drejtoria e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuajb Blakçori-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Behram Latifi-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), dhe disa zyrtar komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, e hapi vazhdimin e mbledhjes duke konstatuar kuorumin ku prezent në sallë për momentin ishin 19 anëtarë/e të Kuvendit, theksoi, vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Informatë nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - DPKGJ

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, përshëndeti të pranishmit dhe jua uroj Festën e Kurban Bajramit, theksoi, si DPKGJ duke përfillë Planin e punës së Kuvendit kemi paraqitur pikë të rendit të ditës Raportin informues mbi ecurinë e punës nga Drejtoria e Pronë Kadastër dhe Gjeodezi gjatë vitit 2025.

Përmbledhja e përgjithshme rreth mbarëvajtjes së ecurisë së punës nga DPKGJ, konkretisht zyra kadastrale komunale në Podujevë ka vazhduar të ofrojë shërbime sa më efikase për qytetarët duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhuruara për pronën e paluajtshme. Gjatë periudhës janar dhjetor 2025 pranë sektorit për pronë, kadastrë dhe gjeodezi në zyrë pritëse janë pranuar gjithsej 10791 kërkesa prej të cilave janë aprovuar 10581. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuara 210 kërkesa janë anuluar ose refuzuar për shkak të mosplotësimit të dokumentacioneve të nevojshme si dhe për shkak të gabimeve teknike gjatë pranimi të tyre. Bazuar në këto të dhëna rezulton se 98.1% e kërkesave të pranuara pranë zyrës pritëse janë të aprovuar dhe kanë marrë përgjigje meritore, ndërsa përqindja e kërkesave të refuzuara apo anuluar për shkak të gabimeve teknike janë gjithsej 1.9%.

Aktivitetet e planifikuara të DPKGJ gjatë viti 2025 ishin: shqyrtimi i kërkesave për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në bazë të akteve të ndryshme juridike; shqyrtimi i kërkesave për ndarjen e pronësisë në bazë të akteve të ndryshme juridike; shqyrtimi i kërkesave për bashkimin e parcelave, ndarjen, përcaktimin, rregullimin, ndërrimin e kulturës, për njësitë kadastrale si dhe legalizimin e objekteve apo ndërtesave; shqyrtimi i kërkesave për regjistrim vetëm regjistrim të hipotekës; shqyrtimi i kërkesave për përmirësimin e regjistrave kadastral; shqyrtimi i kërkesave për regjistrimin e banesave; shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve apo koordinatave; shqyrtimi i kërkesave për dhënien e certifikatave të pronësisë dhe kopjet e planit; shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetë dhe kompanitë e licencuara; shqyrtimi i kërkesave apo ankesave të palëve dhe institucioneve; shqyrtimi i kërkesave mbi uzurpimin e pronës komunale; përgatitja e materialit për shpronësim sipas kërkesave të Kuvendit të Komunës drejtuar Qeverisë; menaxhimi i të hyrave monetare për pronën komunale të dhëna me qira.

Pastaj aktivitetet e implementuara në sektorin për kadastrë dhe gjeodezi janë gjithsej 4438 kërkesa për regjistrim dhe bartje të pronësisë në bazë të akteve të ndryshme juridike; kërkesa mbi bashkimin e parcelave, ndarjen, përcaktimin, rregullimin, ndërrimin e kulturës, për njësitë kadastrale si dhe legalizimin e objekteve; kërkesa për historiat nga personat fizik dhe juridik; shqyrtimi i kërkesave për regjistrimin dhe ç'regjistrimin e hipotekave; përmirësimin e certifikatave të pronësisë dhe aktvendime të ndryshme; kërkesa për shënim dhe lirim të barrës tatimore, ku prej tyre janë aprovuar gjithsej 4320 kërkesa dhe janë refuzuar 17 kërkesa, ndërsa janë anuluar si kërkesa me gabime teknike 104 sosh, apo thënë në përqindje janë aprovuar 97.3% dhe janë refuzuar apo anuluar 2.7% të tyre.

Gjatë periudhës raportuese janë trajtuar gjithsej 6143 kërkesa për lëshimin e certifikatave të pronësisë, kopje të planit, koordinatave për njësinë kadastrale si dhe vërtetimeve të palëve që nuk posedojnë paluajtshmëri. Nga ky numër janë aprovuar gjithsej 6054 kërkesa, ndërsa 89 kërkesa janë anuluar për shkak që të gabimeve teknike gjatë pranimit. Bazuar në këto të dhëna rezulton se në total janë aprovuar gjithsej 98.6% të kërkesave.

Ndërsa te sektori i pronës janë implementuar këto aktivitete: verifikimi në terren për rastet e uzurpimeve të pronës komunale, njoftimin për shfrytëzimin e pronës komunale për përmbushjen e obligimeve kontraktuale; shndërrimi i pronës private në pronë komunale duke ju referuar akteve juridike; shkëputja e kontratave për qiramarrësit e pronës komunale; inicimi i procedurave për shpronësimin e njësive kadastrale me interes të përgjithshëm publik; ftesë për takim informues me shfrytëzues e pronës së Komunës për të siguruar transparencë dhe ndërgjegjësim në lidhje me procesin, rregullimin e pronësisë; përgjigje të ndryshme duke ju referuar kërkesave të qytetarëve.

Përfundim, bazuar në të dhënat e paraqitura për periudhën janar-dhjetor 2025, konstatohet se DPKGJ, përkatësisht zyra kadastrale komunale në Podujevë ka realizuar me sukses shumicën e aktiviteteve dhe obligimeve të planifikuara duke ofruar shërbime sa më efikase dhe profesionale për qytetarët dhe institucionet.

Gjatë kësaj periudhe është evidentuar një numër i lartë i kërkesave të trajtuara me një përqindje shumë të lartë të aprovuar prej 98.1% çka dëshmon angazhimin dhe efikasitetin e zyrtarëve në trajtimin e lëndëve dhe të ofrimit të shërbimeve kadastrale dhe pronësore. Po ashtu janë realizuar aktivitete të rëndësishme në sektorin e pronës dhe atë të kadastrit dhe gjeodezisë përfshirë regjistrimin e pronësisë; legalizimin; trajnimin; trajtimin e hipotekave; menaxhimin e pronës komunale; inicimin e procedurave për shpronësim në interes publik.

Pavarësisht rezultate pozitive, gjatë ushtrimit të aktiviteteve janë paraqitur edhe sfida të ndryshme, konkret kryesisht në aspektin teknik dhe institucional si mungesë e shënimeve grafike dhe problemet e krijuara gjatë rikonstruktimit të zonave kadastrale si dhe vonesat në komunikimin dhe

kthimin e përgjigjeve nga institucione të tjera, brenda afatit ligjor. Megjithatë si Drejtori mbetemi të përkushtuar në avancimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe rritjen e efikasitetit institucional si dhe ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët e Komunës së Podujevës.

z.Haki Rudari, theksoi, me kemi një raport nga Drejtoria përkatëse për periudhën janar-dhjetor 2025 dhe në këtë raport vërehet një numër i madh i punëve dhe aktivitete që është kryer, por ajo çfarë dua të them është që të ngritet edhe më shumë menaxhimi dhe kontrolli mbi pronën publike e që mendoj se është shumë e rëndësishme dhe njëra nga ato që dua ta paraqes e që e tha drejtoresha paraprake e DPKGJ janë edhe sfidat e ndryshme që u ceken tek vonesat në komunikim dhe kthim të përgjigjeve nga institucionet tjera. Sigurisht që keni folur ndoshta me nivelin qendror apo ashtu u mendua, andaj konsideroj që në këtë drejtim duhet punuar më shumë në mënyrë që vërtetë nesër të kemi një shërbim sa më cilësor për qytetarët.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në raportin që e lexoi drejtoresha e DPKGJ nuk pati shumë nevojë sepse gjysmë faqe e ke raportin e nderuar drejtoresh, ka shumë gjëra që nuk janë përmend në këtë raport. Po ashtu Drejtoresha nuk raportoj për pronat publike, as sa janë të hyrat në Komunë, as çfarë kontratash ka, as sa prona janë të uzurpuara. Pastaj unë e kam këtu para vetës e që këta nuk e kanë paraqitur raportin e Zyra Kombëtare të Auditimit e cila ka bërë raport të auditimit të paluajtshmërisë dhe ka gjet 7 çështje shumë me rëndësi të cilat i ka cekë por që më e rëndësishmja është ku në fund ai raport e ka nënshkrimin e Kryetarit që është pajtuar në ato çështjet që ka gjetur Zyra Kombëtare e Auditimit, prandaj nuk e di përse gjithë kjo lëvdatë për këtë pjesë kur shembull, vetëm shkurtimisht po e po lexoj e që pasi është sjellë është dashtë ndoshta drejtoresha e DPKGJ të na e sjellë raportin e auditorit se çfarë ka thënë për prona, pra tek një çështje thuhet “dhënia e pronave me qira nga Komuna pa i plotësuar kriteret për pjesëmarrje në konkurrim” mandej çështja tjetër thuhet “dobësi në përcaktimin e kriterëve të matshme për dhënie me qira” kjo tregon përgjegjësinë qysh është, po ashtu në çështjen e tretë thuhet “mospublikimi i njoftimeve”, “mungesë e evidencave të sakta financiare dhe të plota”, pastaj çështja e pestë “moskryerja e obligimeve financiare sipas kontratës dhe mos ndërprerja e veprimeve të duhura në mbledhjen e tyre” mandej thuhet “mosndërmarrja e masave për shkëputjen e kontratave” e që nuk kanë ndodhur në Komunën tonë, si dhe çështja e shtatë që thuhet është “mos raportimi i Kryetarit në Kuvendin Komunal lidhur me pronat në dhënien e shfrytëzimit”.

Pastaj për gjithë këto pika, për secilën është edhe shkaku se çfarë i është bërë dëm Komunës së Podujevës, andaj mendoj se shkaku i këtyre gjërave që nuk ka ndodhur nuk është sjellë as raportimi me gjithë këto gjetje në Raportin e Auditorit.

Drejtoresha e potencoj që disa njerëz kanë shkuar për ta ndërruar pronën, kurse këto gjëra për neve nuk janë shumë të rëndësishme, mirëpo e rëndësishme për neve është ta dimë qesh qëndron Komuna e Podujevës me prona, të sjellët këtu komplet që ta dimë sa janë të uzurpuara, sa janë të lëshuara me qira, kush po paguan qira, kush nuk po paguan, e jo shembull këtu që ka biznese që kanë aplikuar dhe kanë marrë prona e që njëra prej dokumenteve që kërkohet është certifikata, kurse në raport kjo çështje nuk është përmend, shembull e them që janë tre raste që nuk janë të regjistruara kurse pronat ju janë dhënë. Pra dua të them se nuk është ashtu krejt bardhë qysh e tha drejtoresha në fjalën hyrëse.

z.Besim Latifi, theksoi, drejtoresha e DPKGJ në fund të raportit e pranon se ka ende probleme dhe mungesë të shënimeve grafike me rikonstruktimin e zonave kadastrale, pyetja ime është se qysh është e mundur që kemi kesi lloj problemesh dhe që qytetarët e Podujevës ballafaqohen me këso probleme të evidencës katastrale. Kjo çështje nuk është teknike dhe nuk është e vogël, andaj besoj që duhet të merret seriozisht me të dhe të mos ketë probleme të tilla në të ardhmen.

Po ashtu ishin ankesat për vonesa nga institucionet e tjera, mirëpo qytetarit nuk intereson kush kujt po ja hedh fajin, qytetari pret shërbime brenda afateve ligjore, prandaj kërkojmë të dimë saktësisht cilat janë ato institucione që po i shkaktojnë këto vonesa, pse po ka mungesë të koordinimit ndërinstitucional në këtë nivel. Dështimi më i madh janë vonesat enorme në shqyrtimin e kërkesave për ndarje dhe bashkim të parcelave, e them këtë sepse kam pranuar shumë ankesa në këtë drejtim, janë procedura që zakonisht kryhen brenda afatit 1 muaj maksimum, ndërsa në Komunën e Podujevës vonohen nga 2-3 muaj, për ta bërë një ndarje ose bashkim të një parcele.

Do të ishte mirë të evidentoheshin këto vonesa të cilat po ndodhin në këtë sektor, është mirë të shikohen paksa edhe komunat tjera qysh po funksionojnë, besoj që mund të shohësh në Komunën e Prishtinës ku brenda javës kryhet një ndarje ose bashkim parcele, ndërsa atje në Komunën e Prishtinës janë diku 230000 banorë dhe ka shumë fish më shumë kërkesa në këtë drejtim.

Një tjetër problem serioz është mungesa e transparencës në sektorin e pronës, pra sektori i kadastrit më së paku ka të dhëna dhe shifra konkrete për disa punë që janë kryer, ndërsa te sektori i pronës na sjellën vetëm fjali të përgjithshme, pa asnjë numër.

Unë kërkoj të di qartë sa raste të uzurpimit të pronës komunale janë verifikuar, sa kontrata janë shkëputur, sa të hyra janë inkasuar nga pronat komunale të dhëna me qira, sepse kjo çështje nuk është ashtu qysh e paraqiti Drejtoresha, nuk është serioze, pra është një tentim për të fshehur realitetin përmes fjalëve të përgjithshme.

Po ashtu kërkojmë përgjigje konkrete për uzurpimet e pronës komunale, sa është sipërfaqja e pronës komunale të uzurpuar sot në Komunën tonë, sa prona janë liruar në vitin 2025, kush po i mban të uzurpuara këto prona, pse nuk ka transparencë në këtë çështje, nuk ka një listë të caktuar.

Një element tjetër alarmi në këtë raport janë edhe gabime teknike, pra qytetari aplikon, pret me javë e me muaj, pastaj detyrohet të ri aplikojë për shkak të gabimeve teknike, kjo tregon mungesë profesionalizmi dhe mbingarkesë totale të stafit, mirëpo në të dyja rastet përgjegjësia është e juaja drejtoreshë. Pra kjo informatë e DPKGJ më shumë se sa informatë është raport pune, pra është një pranim publik i dështimit të kësaj Drejtorie, dhe ajo që është shqetësuese, këto probleme nuk po i evidenton opozita, por vetë Drejtoria në raportin e saj zyrtar, pra kjo tregon se gjendjen në këtë sektor lë shumë për të dëshiruar dhe detyra jonë si opozitë është që këto probleme t'i themi publikisht edhe në Kuvend, si dhe të kërkojmë përgjegjësi që këto shërbime të përmirësohen.

znj.Saranda Stublla, U.D. drejtoresh e DPKGJ, i nderuar zotëri Ekrem, ne gjatë vitit të kaluar nëse nuk gabohem në muajin qershor kur edhe ti ke qenë edhe asambleist, besoj e din që e kemi sjellë në Kuvend raportin mbi monitorimin e pronave komunale, e kemi obligim një gjë të tillë dhe do ta sjellim sërish në seancën e ardhshme. Do të tregohet saktë se sa kontrata janë shkëputur, qysh është bërë inkasimi i borxheve dhe krejt gjërat tjera të detajuara do t'i sjellim gjatë seancës së ardhshme. Sa i përket raportit të auditorit që u cek, ka qenë raport për periudhën 2023-2024 që është bërë në vitin 2025 dhe ne i kemi pranuar si të gjetura që i ka specifikuar në 7 shkelje, do të thotë janë ato të gjetura që i ceku parafolësi zotëri Rrahmani, dhe to të gjetura na kanë orientuar që ne brenda 30 ditëve pas publikimit të këtij raporti të bëjmë një plan të veprimit, të cilin jua kemi dërguar auditorëve, pra e kemi përgatitur një Plan të veprimit dhe kemi filluar të bëjmë përmirësime lidhur me ato shkelje të cilat janë gjetur nga ana e auditorëve.

Sa i përket çështjeve të ngritura nga asambleisti zotëri Latifi që shtroj pyetje përse mungon pjesa grafike dhe pse kemi telash me pjesën grafike, ju them që siç e dim, në krejt komunat tjera por edhe në Komunën e Podujevës, kemi atë telashe me këtë pjesë për shkak se nuk i kemi shënimet të cilat janë marrë nga shteti serb, dhe kemi një numër të madh të pjesës grafike që mungojnë, andaj për këtë arsye pastaj edhe dalin probleme dhe duhet të evidentohet secila parcelë që ka mungesë të pjesës grafike në terren e që pastaj duhet t'i bëhen matjet nga ana e qytetarëve për të dit sakt vijën

kadastrale të cilën e kanë si prona e qytetarëve. Ndërsa te bashkimi dhe ndarja e parcelave, po ke të drejtë, por ajo ndodh për shkak të numrit të vogël të gjeodetëve që janë në sektorin e gjeodezisë, pra janë vetëm 2 gjeodetë që kryejnë shërbime, sidomos te koordinatat dhe kopjet e planit që vazhdimisht keni një numër të madh të kërkesave brenda dite që bëjnë qytetarët për t'i marrë dhe tu pajisur me kopje të planit, andaj kjo mund të thuhet se është ndoshta një ngecje në këtë drejtim, edhe pse në këtë vit kemi një përmirësim të dukshëm për shkak se është avancuar sistemi i gjeodezisë dhe të gjitha shërbimet ngarkohen në sistemin online dhe kryhen, do të thotë janë lehtësuar procedurat lidhur me kryerjen e këtyre kërkesave.

Tek pjesa e pronave komunale besoj që në muajin qershor do të sjellim raportin mbi pronat komunale dhe do të jenë te detajuara.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e nderuar drejtoresh unë nuk pata asgjë në raport me ty sepse ti një lloj raporti ose informate e ke sjellë edhe në vitin e kaluar, por ka qenë i ngjashëm me këtë.

Shembull, nëse më 6 gusht 2025 Kryetari është pajtuar me ato gjetje të auditorit, njëra prej gjetjeve pika e shtatë ishte mos raportimi i Kryetarit në Kuvendit e Komunës lidhur me pronat e dhëna në shfrytëzim, do të thotë Kryetari e ka pranuar këtu por ende nga ajo kohë nuk ka raportuar për pronat e dhëna në shfrytëzim, përndryshe ka mundur sepse nëse në korrik ai është përgjigj në atë pyetje dhe është dhënë afati 30 ditor, ka mundur në fund të vitit 2025 të raportoj, apo meqë ishte vit zgjedhor ka mundur në fillim të viti 2026, apo deri tani ka mundur ta sjellë një raport të pronave në mënyrë që ta dimë edhe ne cilat prona janë të dhëna me qira, kush i ka uzurpuar, pastaj duhet të jetë edhe i publikuar në faqe të Komunës, mirëpo nuk e di, ndoshta dhe për shkaqe të votave nuk guxoni t'i sjelleni që të dihen se kush po i shfrytëzon.

E them këtë sepse ka shumë pyetje për shumë prona në Podujevë. Shembull, mua si asamblist më pyesin përse ky ose ai person e ka atë ose këtë pronë, a ka kontratë e gjëra të ngjashme, unë i'u përgjigjem që kam kërkuar disa herë por përgjigja më kthehet ose që është humbur kontrata ose që nuk e din kush edhe për sa e ka në shfrytëzim pronën, e as nuk e din askush, prandaj përse nuk shkëputet ajo kontratën ta zëm, pra ta dimë për çka shfrytëzohet NN prona dhe çka përfiton Komuna e Podujevës nga dhënia e asaj prone në shfrytëzim, kaq po kërkojmë ne, jo më shumë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, konsideroj se diskutime përfunduan e për këtë pikë të rendit të ditës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

5. Propozim vendim për ndryshim plotësimin e vendimit nr.prot.01-020/04-0019212/26 datë 31.03.2026 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale; Lokali afarist me sipërfaqe 50m², dhe Lokali afarist me sipërfaqe 55m² të ndërtuara në Njësinë kadastrale P-71712062-00459-0 me sipërfaqe 2237m², Zona Kadastrale Podujevë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, do të thotë në këtë pikë të rendit të ditës kemi një kërkesë për zëvendësimin e një anëtarit për arsye se ish anëtarja nga sektori jo qeveritar lokal znj.Nazife Gashi në fakt ka afruar dorëheqje nga ky Komision, prandaj ky propozim vendim është që të zëvendësohet me Shqipton Rushiti i cili është i vetmi që ka aplikuar me të gjitha të dhënat e që është edhe propozim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit në fjalë, përkatësisht që në vend të ish anëtares të emërohet. Prandaj e hap diskutimin për këtë çështje edhe pse thuajse e sqarova mjaftueshëm se për çka bëhet fjalë dhe për arsyet e këtij plotësim ndryshimi.

z.Ekrem Brahamani, theksoi, e kam parë kërkesën e dorëheqjes dhe nuk ishte shumë sqaruese përse, mendoj se është të tregohet arsyeja e dorëheqjes së asaj zonje ngase ne nuk e kemi votuar me zor në mbledhjen e kaluar sepse ajo vet ka aplikuar dhe është zgjedh me votat tona këtu në Kuvend, këto vota nuk janë hajgare.

Tani te çështja e këtij Shqipton Rushitit, unë edhe para kësaj here e përmenda me emër, por ajo çka më çuditi ende më shumë ishte kur shkova të dielën për ta shikuar djalin tim duke luajtur Futboll, edhe aty ky ishte refer, madje i thash edhe këtu ke arrit a. Dua të them që nuk ka vend ku nuk është aty ky person, pra kur ja pash flamurin e referit besoni që u çudita, vetëm kur ta shohim edhe në finale të Champions Ligës, si anësor atje. Unë nuk e votoj këtë.

znj.Saranda Stublla, U.D. drejtoresh e DPKGJ, theksoi, i nderuar Ekrem, ne më 19.05 të këtij muaji keni bërë thirrje publike, besoj e keni parë edhe ju në faqe të Komunës që i kemi ftuar përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile të bëjnë aplikimin dhe ky personi në fjalë që e ceke ti ka aplikuar dhe ne vetëm e kemi sjellë këtu në Kuvend. Vetëm ky ka qenë që ka aplikuar, e kemi sjellë si aplikues edhe kemi këtu sot para vetës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë e kemi në shqyrtim plotësim ndryshimin e vendimit bazë, përkatësisht zëvendësimin e Nzife Gashi me Shqipton Rushiti, që të jetë anëtar në atë Komision.

z.Haki Rudari, theksoi, megjithatë nuk jam shumë që t'i rëndojmë njerëzit sepse kur rëndohet shumë dikush pastaj mund të kenë deformitete, por sido që të jetë Ligji e parasheh që në atë komision duhet të jetë dikush prej OJQ dhe për hir të respektit ndaj asaj që ato lokale nesër të jenë më shfrytëzim, ne Grupi i LVV-së e përkrahim, por duhet të ruhem në dialog sepse deformitetet vërtetë janë të rënda.

z.Besim Latifi, theksoi, meqë ky personi në fjalë është domethënë i dallueshëm, do të thotë është aktivist politik i dalluar dhe pastaj edhe nuk e ndal askush themeloj edhe OJQ, besoj që për të dhënë pronë komunale në shfrytëzim duhet të jetë një OJQ, e jo njerëz të përfshirë direkt në politikë. Kështu që për këtë arsye, ne nuk e votojmë këtë person.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, e hedh në votim plotësim ndryshimin e vendimit sipas kësaj pike të rendit të ditës, përkatësisht që z.Shqipdon Rushiti të emërohet anëtar nga sektori jo qeveritar lokal në vend të znj.Nazife Gashi e cila është dorëhequr nga komisioni në fjalë.

Sa për rikujtimin e juaj anëtarë të Komisionit në fjalë janë: Lirie Hoti-Rama dhe Behram Latifi nga Ekzeklutivi i Komunës, Qëndresë Hajrizi dhe Gresa qosa-Maqastena nga Kuvebndi i Komunës dhe tani duhet plotësuar edhe me anëtarin nga sektori jo qeveritar lokal .

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 21 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 12 vota Për, 9 vota kundër, asnjë votë Të Përmbytur, me vendim bëhet plotësim ndryshimi i vendimit bazë për ndryshim plotësimin e vendimit nr.prot.01-020/04-0019212/26 datë 31.03.2026 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale; Lokali afarist me sipërfaqe 50m², dhe Lokali afarist me sipërfaqe 55m² të ndërtuara në Njësinë kadastrale P-71712062-00459-0 me sipërfaqe 2237m², Zona Kadastrale Podujevë, përkatësisht z.Shqipdon Rushiti emërohet anëtar i komisionit nga radhët e sektorit joqeveritar lokal, në vend të ish anëtares znj.Nazife Gashi e cila është dorëhequr nga ky komision. Pjesët tjera të vendimit bazë mbeten të pa ndryshuara.

6. Propozim Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB për vitin 2026

z.Bahi Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, theksoi, në mbledhjen e KPF-së kemi paraqitur Planin e punës të KKSB si kërkesë për përfshirje si pikë shtesë në rend të ditës. Qëllimi i këtij propozimi ka qenë koha e shkurtër nga miratimi i planit në KKSB deri në afatin gjashtë mujor e që parashihet me Udhëzim Administrativ, mbajtja e tre takimeve në gjashtë mujorin e parë.

Unë në cilësinë e koordinatorit të këtij Komiteti e kam paraqitur këtë propozim, do të thotë e gjithë arsyeja e kësaj ngutie për këtë proces është afati gjashtë mujor që KKSB parashihet të mbajë tre takime, kurse deri më tani i kemi mbajtur dy sepse nuk ka pasë mundësi që të mbahen më shpejt për shkak se mbledhja e parë ka qenë inauguruese, pastaj në mbledhjen e dytë është formuar menjëherë komisionin për hartimin e planit të punës, dhe tani për të vazhduar mbledhjet e radhës të komisionit kërkohet që ky plan të miratohet edhe në Kuvendin komunal pas miratimit që është bërë në KKSB, andaj kërkoj nga ana juaj ta aprovoni këtë Plan dhe të na mundësohet të vazhdojmë me punën e këtij Këshilli ashtu qysh është e paraparë në pra në këtë Plan të cilin sigurisht që e keni para vetës, ku përfshihet edhe kalendari i cili si material ju është përcjellë nga mbledhja e KPF-së.

Një prej vërejtjeve që ishte prej një anëtarit të Kuvendit i cili e kontestonte kuorumin në mbledhjen e KKSB-së, unë e diskutuar edhe në KPF këtë çështje mirëpo sot e mora edhe listën e nënshkrimeve nga pjesëmarrja në atë mbledhje të KKSB-së, pra prej 21 anëtarëve sa ka KKSB, kemi 12 nënshkrime të pjesëmarrjes në këtë procesverbal dhe kjo i bie që është tejkaluar edhe kuorumi. Pra kushdo që dëshiron ta shohë mund t'ia paraqes, përndryshe unë nuk e shpërndava këtë Listë sepse ashtu më sugjeroj zyra ligjore, por kush do që dëshironi mund ta shihni, ose nëse e vlerësoni unë mund edhe t'ju lexoj emrat e atyre që kanë qenë prezent, mirëpo sërish e theksoj që mund ta shihni edhe procesverbalin e pjesëmarrjes.

z.Haki Rudari, theksoi, është mirë që kur të bëhen këto propozime të vijnë sa më me kohë për arsye se në bazë të Udhëzimit Administrativ, KKSB duhet të mbajë së paku tre mbledhje në gjashtëmujorin e parë dhe së paku duhet ta informojë Kuvendin. Unë shpresoj që në muajin qershor do të kemi informatë nga KKSB lidhur me mbarëvajtjen dhe përgjithësisht për sigurinë në Komunën tonë. Edhe ky Plan që është sjellë kështu ndoshta paksa më duket edhe si i mangët, por megjithatë ne Grupi i LVV-së e përkrahim duke u bazuar në atë që është i veçantë dhe duke parë që Komuna jonë është afër brezit kufitar e që konsideroj që në këtë drejtim duhet bëhet më shumë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë e kam paraqitur shqetësimin rreth kuoromit në mbledhjen e KKSB-së dhe i kam thënë edhe drejtorit të DSHPMSH, por nuk është që kam pasë ndonjë informatë, mirëpo në faqe të Komunës fotografinë që e kam parë kanë qenë vetëm 8 persona që kanë marrë pjesë, andaj e kam kërkuar raportin që ta di kush është nënshkruar dhe kush ka qenë prezent në atë mbledhje. Ne nuk jemi për ta bllokuar këtë pasi që kërkohet që në gjashtë mujorin e parë të mbahet edhe një mbledhje. Unë kam qenë asambleistë edhe në mandatin e kaluar dhe jemi mësuar me plane të tilla, shembull, e pashë që në vitin 2022 kur është votuar ky plan atëherë një anëtar i KKSBI-së ka qenë z.Shemsi Jashari i cili e ka bërë planin e punës, tani si duket kemi mbetur në atë plan sepse as nuk kemi shtuar asgjë as asgjë risi dhe po më vije keq sepse drejtori zotëri Selimi e ka ditë mirë që nuk është marrë me këtë farë pune që duhet në gjashtë mujorin e parë duhet të mbahen të paktën 3 mbledhje, andaj është dashtë të shpejtohen procedurat dhe të sjellët material më herët, madje nuk po di çfarë plani është ky me një faqe e gjysmë, plan por, mirëpo më shumë i ngjan një kalendari të takimeve dhe se çka do të diskutohet, por megjithatë pasi është vonuar, edhe kështu siç është ne Grupi i LDK-së e përkrahim, ndërsa sa i përket

nënshkrimeve nuk ka nevojë të na sjellën vetëm dëshiroj t'i shohë nënshkrimet sepse kam qejf me gjat eventualisht ndonjë që nuk ka nënshkruar, merak kam dhe se unë për këto gjëra edhe jetoj.

znj.Luljeta Muqolli-Azemi, theksoi, kam një pyetje për kolegët, a ka mundësi ndonjëherë ju të filloni ndonjë seancë me ndonjë feedback pozitiv, apo vetëm me kritika. Të them të drejtën këto kritika që po jepni, përkundrazi neve vetëm po na bëni më të fortë, për neve po jeni si një lloj stërvitje faktikisht me një intensitet minimal. Për Podujevën nuk kemi çka folim. Fjala zhduket, kurse vepra mbetet.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e falënderoj kolegen parafole, ndoshta ke qenë prezentë kur unë edhe njëherë këtu e kam thënë që me asamblista/e dhe kolegë/e nuk kam qejf të shtyhem, mirëpo nuk mund të vie tani në mbledhje dhe t'jua bëjë rrafsh. Unë kërkoj të gjej gabime, ndërsa kolegja parafole del këtu dhe jep lavde për vete, për unë ja gjuaj gabimet. Nëse keni qejf, ju mirë edhe ne mirë dhe nuk vijmë fare në seanca fare, ose vetëm vijmë këtu në mëngjes dhe themi mirë edhe ecim në shtëpi. Opozita për këtë është, nëse nuk e ke kuptuar në mënyrë demokratike, ne po mundohemi ta bëjmë më të mirën për këtë vend, kurse parafolesja e thotë që krejt është mirë dhe lavdërohet. Unë mendoj që ju vetëm përmirësoheni prej kritikave tona, kështu është kjo punë.

znj.Luljeta Muqolli-Azemi, theksoi, normale është që kush punon gabon, por ne me rëndësi është që gabimet e njëjta dy herë nuk i përsëritim dhe se gabime qëllimisht nuk bëjmë.

z.Besim Latifi, theksoi, më nxiti paksa kolegja parafole të marrë fjalën, në qoftë se ka një grupim politik që e mohon gjithçka në të kaluarën, është grupimi juaj ndoshta, do të thotë për ju gjithçka është zi e terr kur ju nuk keni qenë në pushtet, kurse gjithçka është mirë kur ju jeni në pushtet. Unë e them se nuk është që gjithçka mirë as atëherë, nuk është gjithçka mirë as tani, nuk ka qenë gjithçka zi atëherë dhe nuk është gjithçka zi as tash. Gjithmonë gjatë punës bëhen gabime, bëhen lëshime, për këta janë organet të cilat e mbikëqyrin njëra-tjetrën për t'i kryer punët ashtu qysh duhet, kritikën janë normale sepse gjatë punës bëhen lëshime, andaj është mirë që të merren si normale dhe të trajtohen si dhe të shtyhen përpara sepse janë interes i qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, besoj që ka vend për debate të tilla kur të vie raporti gjashtë mujor, atëherë mund të debatohet për çështjet që u ngritën.

Meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, unë e hedh në votim propozim planin e punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026, sipas materialit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga KPF dhe prezantuar në këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 21 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në mbledhje, miratohet Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026, sipas materialit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

7. Informatë e Drejtorisë së Arsimit rreth ndarjes së Bursave për studentë për vitin akademik 2025/2026

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, informata si e tillë ka qenë e planifikuar të vie normal në informatën e përgjithshme të Drejtorisë, mirëpo meqenëse ishte kërkesë e shefit të Grupit të LVV-së, edhe pse ende pa u kryer procesi përfundimtar i bursave, unë në mënyrë të shpjeguar i mora informatat prej komisionit përkatës.

Kanë qenë 493 aplikues gjithsej, prej tyre 409 të gjinisë femërore dhe 84 të gjinisë mashkullore, në listën preliminare kanë qenë 307 përfutues për arsye se në këtë konkurs kanë aplikuar edhe

student të cilët janë në master e që me Rregulloren që është miratuar në këtë Kuvend nuk parashihen. Po ashtu kanë aplikuar dhe disa që janë në privat si dhe disa të vitit të I-ra e që nuk janë paraparë me Rregulloren në fjalë, si dhe kanë qenë disa të diplomuar ku edhe ata kanë qenë të përfshirë. Lista përfundimtare ka përfunduar me 326 përfitues. Kanë qenë 19 raste sipas komisionit që kanë harruar t'i sjellin dokumentet siç është rasti i familjarëve që nuk e kanë njërin prind ose dy prindërit, që keni mundur me i marrë me mend që mund të ndodhë edhe një gjë e tillë, pastaj disa dhe të kategorive të dala nga lufta nuk e kanë përcjellë dokumentin përkatës, dhe në bazë të dhënave të të gjithë këtyre rezultati ishte 326 përfitues ku 6 janë me raste sociale e që na gëzon fakti që nuk mbizotërojnë si herëve të tjera me numër të madh që ka qenë ku shembull ka pas dy e më shumë nga një familje, pra janë 54. Mandej studentë pa njërin prind janë 29, studentë pa dy prindërit është vetëm 1, studentë me nevoja të veçanta nuk kemi pasur në këtë konkurs.

Nga kategoritë e dala nga lufta janë 94, drejtimet deficitare janë 101 të cilët i kanë 10 pikë më shumë e aty hyn mjekësia, inxhinieria, kimia, fizika, matematika, teknologjia e kështu me radhë, pastaj kanë qenë 31 përsëritës, aplikues në dy vende nga e njëjta familje kanë qenë 4, dhe me master kanë qenë 5, mandej privat dhe të vitit të parë si dhe të diplomuar 12.

Ju e dini që një Rregullore është miratuar në Kuvendin komunal në të cilën janë disa kritere ku nota mesatare prej 9-të deri në 10-të ka tërheq 30 pikë, nota mesatare prej 8-të deri në 9-të ka tërhequr 20 pikë, nota mesatare 7-të deri në 8-të ka tërhequr 15 pikë, nota mesatare 6-të deri 7-të ka tërhequr 10 pikë. Pastaj aty ku kanë qenë dy e më shumë studentë nga një familje janë 10 pikë, student që janë përfitues të asistencës sociale 10 pikë, studentë në programe ku ka mungesë të kuadrove 10 pikë, studentë me nevoja të veçanta 10 pikë, studentë pa të dy prindërit 20 pikë, studentë pa njërin prind 10 pikë.

Konkursi është shpallur, ka dalë lista preliminare e cila është e bashkangjitur në ueb side të Komunës e po ashtu është edhe lista përfundimtare që ende është në proces të realizimit, dhe për çdo pyetje, qasje, sugjerim, vërejtje jemi të hapur edhe ne si Drejtori e Arsimit ose qoftë si komision për të sqaruar çdo pakënaqësi ose ndonjë diçka që të mund ketë ndodhë, nga secili Grup që është brenda asamblesë komunale.

Te rasti i shefit të grupit të LVV-së që e ngriti këtë pa ndonjë paralajmërim e që unë zakonisht kam pasur një komunikim jo vetëm me këtë por kushdo që është adresuar për ndonjë pyetje e që janë krijuar mundësi për t'u përgjigjur, ju kemi dhënë përgjigje, mirëpo sot erdhi si shpejtë kështu dhe pa paralajmërim, por sido që të jetë ne jemi këtu për t'ju dhënë sqarime dhe përgjigje.

Për të qenë transparent, njëra prej ankuesve, meqë hymë në këtë farë çështje, ka qenë edhe vajza juaj (Haki Rudarit) që ka bërë një ankesë, por meqë ka përfutuar djali juaj në këtë rast, dy prej familjes nuk kanë mundur të jenë, andaj nëse është shkaku këtui, prapë jemi që t'ju japim përgjigje. Përndryshe jemi munduar t'i respektojmë kriteret në përpikëri. Ka pasur edhe raste siç i ka cekur vajza juaj që kanë qenë të diplomuar dhe janë identifikuar, dhe në listën përfundimtare janë hequr, raste të cilat janë vlerësuar edhe prej komisionit por edhe nga ankesat e studentëve në fjalë.

z.Haki Rudari, theksoi, unë drejtorin e Drejtorisë së Arsimit e njoh nga opozita kur kam qenë, e di seriozitetin dhe jo seriozitetin e tij të punës, por sido që të jetë secili këshilltar e ka të drejtën e vetë të paraqitjes së kërkesave për informata të ndryshme.

Avni Fetahut po i thotë Haki Rudari në këtë foltore që unë e kam kritikuar Valon Demollin kur ka përmendur diçka familjare e tash po del që ai paska pas të drejtë. Kurrë në jetën time nuk kam ardhur të them diçka për familjarët e tu Avni Fetahu e din ti mirë, kurrë në jetën time nuk kam shkuar t'i them Shpejtim Bulliqit të më punëson familjar, ma duan LDK-ja se me gjet diçka Haki Rudarit se kush e di çka, por asgjë nuk munden, janë munduar edhe në opozitë kur kam qenë, por ju është thënë jo, vie me kohë, punon, ka kriterium dhe disiplinë, këto i kam edhe në Vetëvendosje,

ndërsa tani shumë njerëz të cilët e kanë kritikuar Vetëvendosjen, sepse tash po del në krejt tjetër tabor drejtori i DKA-së, krejt tjetër e kam menduar por ky tani po më detyron të dalë në tjetër debat në këtë diskutim. Si shumë njerëz që janë ardh sot në Vetëvendosje, janë ardh sepse e kanë gjetur sikurse “Sillen e Bajramit” dhe veç “hajn tomëloriz” por ne që kemi punuar qe 20 vite, pra unë 20 vite i kam e që nuk ka thujse shesh as qendër komune që nuk kemi shkuar në protesta e demonstrata, qoftë të mira apo të këqija ato vlerësime të tjera, e të tjerët na kanë kritikuar por që sot kanë marrë pozita. Mirëpo unë e kam faj që kam toleruar dhe duruar disa gjëra, edhe unë e mbaj një pjesë të përgjegjësisë. Nëse një person në politikë në Besianë e gjen të pastër 100% si ujë i destiluar, i dyti është Haki Rudari, nuk është Avni Fetahu, urdhëroni hulumtojeni çdo aktivitet timin. Edhe familjar kur jam bastisë në vitin 1993, pastaj edhe në vitet 1998-1999 kur bashkë me vëllain tim jemi bërë pjesë e luftës, edhe si studentë kur jemi marrë me ilegale, të tjerët paskan qenë në tabor tjetër.

Të nderuar kolegë, as që kam menduar që në këtë vijë ta bëjë këtë diskutim, por meqë Avni Fetahu Hyri në këtë, i'a paftë hajrin, madje ne mund ta vazhdojmë këtë, nuk ka kurrfarë problemi për mua, ky e din që unë jam i gatshëm për debate 24 orë në 365 ditë.

Më 12.03.2026 Drejtorja e Arsimit publikon konkurs për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Podujevës për vitin akademik 2025-2026, pastaj më 27.04.2026 publikohet lista preliminare e përfituesve të bursës komunale për vitin 2025-2026, gjithsejtë janë 307 studentë përfitues. Më 14.05.2026 publikohet lista përfundimtare e përfituesve të bursës komunale, dhe tani janë gjithsejtë 326 përfitues, dallimi është 19, pra diferenca është në 19 dhe këtu është ajo dilema, sepse në listën preliminare ka emra që nuk janë në listën përfundimtare, mund ta verifikojeni dhe nëse nuk është kështu ta mohon drejtori. Po përsëris, në listën preliminare emrat e studentëve nuk janë në listë përfundimtare pastaj e që sigurisht ankesat dhe kërkesat i paskan heq. E ka mirë ai sepse nuk kam kërkuar asnjëherë informatë të tillë, kjo është informata e parë që e kërkoj në këtë formë. Në listën përfundimtare tash ka emra apo studentë që nuk kanë qenë në listën preliminare, në dyja anët gabim është o Avni Fetahu, në njërin anë i keni shti së pari ata që s'ka pas të drejtë dhe pastaj i keni heq pas kërkesave të bëra, kështu ti vetë e pohove, ndërsa në anën tjetër në listën përfundimtare prapë keni shti njerëz studentë prej ju që keni pasur dëshirë.

Unë i kam thënë ish Kryetarit të Komunës që ndaj respekt për gjithë Ekzekutivin sepse nuk kam problem me LDK-në personale e as familjare dhe me asnjë person, problemet personale apo familjare kam ku zgjidhi dhe qysh i zgjidhi, por Komuna është e jonë dhe është mjaft e madhe.

Arsimi është një prej elementeve kryesore të shtetit në përgjithësi unë 10 vite, Ekrem Rrahmani e dinë këtë sepse e kam pasë nxënës, 10 vite kam punuar në okupim në arsim. Prej Shajkocit kam shkuar në Buricë dhe prej Burice jam kthyer në Gllamnik, dhe po besoj që kujtohet Ekremit që në vitin 1993 në dhjetor unë jam bastisë dhe kur është arrestuar vëllau im dhe kemi maltretime të mëdha të anëtarëve të familjes, këtë informatë e dinë por edhe po ja jap tani Avni Fetahut.

Është një Rregullore për dhënien e subvencioneve që është miratuar në këtë Kuvend dhe pikërisht ju jeni mësuar të punoni “partizanski” hajt se shefi na mbroj dhe ju kam mbrojtur edhe kur nuk është dashtë t'ju mbroj, por atë përgjegjësi e marr unë. Neni 7 paragrafi 4 i kësaj Rregullore thuhet, komisionet për shqyrtime dhe vlerësimin e kërkesa për ndarje të subvencioneve veprojnë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmërisë, pra duhet vepruar sipas ligjit, jo sipas tekeve të dikujt, jo hajt se jam në komision, më ka bërë Avni Fetahu dhe unë bëjë çka dua, apo hajt se nuk kanë kërkuar informatë dhe unë bëjë çka dua, jo, mandej në paragrafin 5 thuhet, anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe e vlerësimi kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësi, do të thotë ata mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kushteve dhe kritereve të subvencioneve.

Unë isha në Gjermani dhe kam parë që është bërë një debat lidhur me një komision që është themeluar për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, dhe ky komision që e bën Avni Fetahu, nuk është vetëm një drejtor apo drejtoresh në Komunën tonë, duhet të bëhet gjithë përfshirje në këto komisione, prandaj në këtë kuptim unë e konsideroj që ky komision sepse unë fillimisht komisionin e akuzoj që ka bërë shkelje të ligjshmërisë, dihet përbërja e tij, janë me emra është kryesuesi dhe dy anëtarë të tjerë, unë nuk e di pastaj a ka bërë komision për ankesa sepse nuk i di emrat e tyre, por dua t'ju them përmes kësaj foltore më së pari Avni Fetahut se do të ketë debat me mua deri në vitin 2030 apo deri kur do të jemi këtu prezent ne dy, sigurisht që ky është veç fillimi nuk është bash që ka përfunduar por po i them Avni Fetahut që ky bash ka filluar prej sot.

Që ai komision duhet të marrin masa disiplinore. Po të isha unë Haki Rudarti në Ekzekutiv, për jetë dhe po ju betohem si prind i pesë fëmijëve, nuk kish pas forcë që më shtim të punoj diçka jashtë ligjit, atë e kamë parim dhe betim, prandaj këtë kuptim edhe dua të punohet, dua të punohet sepse kamë punuar për Vetëvendosjen, unë nuk kam ardh vetëm ashtu “në ditë të Bajramit dhe të ngëni deri në tomëloriz”, po e them unë, por jemi edhe shumë të tjerë e që këtu janë prezent Bahri Selimi, Adelina Stublla dhe të tjerët që kemi punuar në këtë drejtim, prandaj nuk është mirë të përzihen gjërat për arsye se kur është përdorur diçka në foltore, unë e kam dhënë kritika dhe po them edhe njëherë vërtetë nuk paskan edhe krejt faj edhe të tjerët.

Çka duhet vepruar tash, në një komunë, në një vend ku ka veç ligj, nuk ka ndarje aty nipa e teze por aty ka respektim të ligjit, ai komision duhet të marrë ndëshkime me masa disiplinore dhe kush është ai, drejtori i Drejtorisë së Arsimit, nuk është Haki Rudari sepse unë jam shef i Grupit të këshilltarëve të LVV-së, dhe pse është kërkuar një informatë nuk e di çka është “segëlltisë” Avni Fetahu, është e drejtë e këshilltarit, përkundrazi përmes informatave nëse drejtori është 100% i pastër e që po del që jo, atëherë është dashtë të thuhet po morë shumë mirë që ke kërkuar këtë informatë se përmes kësaj dua të bëjë sqarime, por nuk dua të më ndalin mua studentët dhe të më thonë po prapë be axhi Haki, pse bre po bëni kështu pse po shtini këtë, atë e këtë, e pastaj e po heqen prej listës sepse e kanë marrë vesh dhe po i heqim, kjo është negative dhe kjo është pastaj që të dëmtohet edhe Vetëvendosja që jam i bindur që sot kanë ardhë disa njerëz në Vetëvendosje veç pse është në pushtet, jo pse e duanë konceptin, unë e dua konceptin dhe nuk e fshehë para mijëra njerëzve e them, jo veç si person por familjarisht, kurse çka fituar që jam në pushtet që 5 vite, pastaj kamë qenë edhe opozitë, shef i Grupit kamë qenë edhe në opozitë, vëllau im punon në Emergjencë që 25-26 vite, njëjtë familjarisht unë jo, por të tjerët po, dhe për ata të tjerët që kanë fituar dhe që kanë keqpërdorur unë Haki Rudari është këtu për ata. Unë jam këshilltar komunal dhe kam marrë votat e qytetarëve, jo me punësime e me subvencione të ndryshme, unë kam marrë vetëm prej parimeve të mia. Do debatojmë të ardhmen deri në përfundim këtij mandati.

znj.Gresa Qosa-Maqastena, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Arsimit e din që para dy seancave më parë, jo informatë ndoshta me definicionin kryesor që ka kërkuar sot profesori zotëri Rudari, por kam kërkuar të na tregosh cilat janë kriteret kryesore që studentët do të marrin bursat, dhe që prej dy seancave as nuk keni kthyer përgjigje e as nuk keni qenë prezent kështu. Kështu që mos t'ju dhemb shumë sot që po ju kërkohen direkt informacione sepse është e vërtetë që aq shumë është politizuar kjo listë sa që nuk e di a është keq për ata edhe që janë studentë të fakulteteve private edhe këta të tjerë që ndoshta nuk e kanë dikë të afërt me Vetëvendosjen. Kështu që kjo informatë është kërkuar para dy seancave të tjera, e dinë të gjithë besoj, kështu që është mirë që nëse keni bërë gabime vetëm të kërkonit falje.

Gjithashtu ju rikujtoj që ju kam thënë kur të vjen puna për me i marrë në punë këta studentë që diplomojnë, ju e shikoni a e keni afërsinë politike edhe nuk e pyetni a është privat apo në të shtetit, por e merrni sepse e din ti drejtor shumë mirë që edhe ke me privatë që janë të punësuar edhe në

arsim edhe në shëndetësi dhe kudo tjetër, kështu që nuk është dashtë t'i përjashtoni studentët që janë në fakultete private. Po ashtu nuk është dashtë të vie puna të ketë aq shumë pakënaqësi në teren për çështjen e bursave që i keni ndarë.

z.Ermal Osmani, theksoi, kam dashur ta ngris edhe te pika Të Ndryshme sa i përket e çështjes së bursave por pasi që u fut në rend të ditës besoj kemi çka të debatojmë.

E kam shikuar listën e përfituesve të bursave, mirëpo unë veç diçka dua të të pyes Avni dhe t'i të ma shpjegosh në mënyrën më të mirë të mundshme. Listën preliminare këtu e kemi, 3007 përfitues, me numër 118 studente e fakultetit të mjekësisë me numër nëntë është vajza e Zaim Thaçit, lista preliminare ka dalë para se Zaim Thaçi të dal kandidat për deputetë nga LDK-ja, pasi ka dal kandidat, me datën 14.05.2026 veç se është vajza Zaimit e keni heq prej listës, kjo Avni për mendimin tim është e turpshme, është skandaloze edhe nuk bën të trajtohet në këtë çështje.

Tani por ndërlidhem paksa edhe çështjen e ngritur tani nga kolegu z.Haki Rudari, unë mendoj se është mirë debati të mos lëshohet në personale, pra unë jam për të mos u lëshuar në personale asgjë, mirëpo edhe me kolegun tjetër z.Valon Demollin ke pas debat të tillë dhe vet ti drejtor ke fut në personale, edhe tani po e bënë personale, prandaj të mos hyjmë në personale sepse e njohim njëri-tjetrin goxha mirë, prej zjarrfikësve deri te shupat “garazhet” unë e di që njihemi mirë njëri me tjetrin, unë dhe ti së bashku kemi qenë në LDK por unë s'kam drejtor, ti Avni ke qenë drejtor.

Mirëpo atë studenten e fakultetit të mjekësisë, e 118-ta në listën preliminare kurse tani listën përfundimtare e ke rritur, e ke bërë 326 përfitues, kurse e ke heq vajzën e Zaim Thaçit veç se është kandidat për deputetë prej LDK-së, pasi ka dalë kandidat, kjo është e turpshme.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk e pata ndërmend të marrë fjalën për këtë çështje, por më preku paksa që drejtori i DKA-së i'u drejtua, çika jote, djali yt. Ndoshta me godit pak më lart diqysh t'ka hije, por te fëmija nuk bën sepse pastaj mund edhe të bullizohet, andaj nuk ka nevojë ashtu të drejtoheni, madje kjo është edhe arsyeja, po të tregoj tani që e kam në vit të fundit vajzën në fakultet të mjekësisë dhe arsyeja përse nuk e kam lënë të aplikoj sepse është shumë keq pastaj t'i drejtohesh ashtu, vajza jote, djali yt. Çka ka faj ajo që është vajza e Hakiut, tani nëse është vajza e Hakiut i cili merret me politikë, ajo po u dashka të jetë e izoluar, nuk duhet të marrë bursë as asgjë, kjo është shumë gabim. I'u drejtove në mënyrën më të vrazhdë të mundshme. Jo që po dua ta mbrojmë sepse po duket që edhe gjysmën e asamblistave i'a heqe në këtë pikë për të mos u mbajt kjo seancë, kjo është shumë keq. Zotëri Rudarin e kam pas arsimtar të dhe e njoh familjarisht, por as nuk po dua ta mbroj sepse ky është i Zoti i vetes boll, është para meje këtu. Çfarë ka përfutur ky, kush mund t'ia zgjat gishtin këtij për përfitim diçka, a ty (i drejtohet Avni Fetahut) po 20 gishta me i pas mund t'i drejtojmë nga ti çfarë ke marrë, a këtij jo, prandaj e them se është keq t'i drejtohesh ashtu sepse nuk faj ajo nxënësja nëse i ka plotësuar kriteret, çka ka lidhje nëse vëllai i saj ka përfutur më herët, është gabim kjo, duhet trajtuar ndryshe.

Në këtë pikë unë i them zotëri Rudarit propozojë një anëtar të komisionit, e bëjmë komisionin ad-hoc dhe shikojmë këtë çështje, përndryshe po ta lësh kështu, kjo punë harrohet pastaj sepse është fushatë zgjedhore dhe harrohen gjërat. Pra e formojmë komisionin ad-hoc prej Kuvendit, dhe shikojmë i marrim dokumentet i kontrollojmë, ju keni përfaqësues të arsimit aty, edhe ne i kemi nja 4-5 që merren me atë punë. Propozojeni e formojmë dhe shikojmë pastaj si komision i'u hyjmë një nga një, s'ka lidhje i kujt është a kush është, ajo ose ai që e meriton ka me marrë, nëse jo nuk mund ta marr. Pra ai komision pasi të bën komplet kontrollin atje, vie këtu raporton dhe na tregon për të gjitha. Pra nëse veç e formojmë një komisionin që i besojmë, vie na raporton për gabimet që i gjen, pra t'i dim gabimet dhe të dimë çka është bërë këtu në këtë çështje, prandaj nëse e propozoni një komision, kuorum kemi dhe e votojmë, le t'i shikojmë të gjithë, s'ka lidhje fëmija i kujt është.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, deshta të ndërlidhem te pjesa e asaj që i'u referuar si fëmija i Hakisë, nuk mendoj që është në rregull sepse janë studentë të këtij shteti, dhe meqë jemi shtet demokratik, e kanë të drejtën e botës të aplikojnë dhe të përfitojnë të dytë, në këtë rast. Mendoj që është gabimi më i madh që të anashkalohet njëri, do të thotë studentja në këtë rast veç pse vëllai i saj ka përfituar, sepse në këtë rast ata të dy studiojnë, nuk studion veç njëra.

Nuk po e kuptoj një gjë, do të thotë, ti prej listës preliminare te lista përfundimtare e ke rritur numrin, qysh i ke përjashtuar gjithë atë person duke i hequr prej liste, ku i more ata persona që u shtuan në listën përfundimtare, kurse sa i përket te pjesa që shembull dy fëmijë familjarë nuk kanë përfituar, unë them se ka përfitues, dy familjarë në listë i ke.

z.Valdet Restelica, theksoi, për këto çështje asambleistët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e kanë ngritur zënin për çdo vit ku kanë pas ankesa dhe kritika për mënyrën se qysh janë ndarë bursat, kurse kësaj radhe kemi vërejtje edhe nga kolegët e partisë në pushtet e që është një reflektim dhe një vërejtje shumë e mirë, fatkeqësisht domethënë që pesë vite përfitojnë njerëzit jo meritore, kjo është shumë e keqe dhe për fëmijët të cilët i dekurajoni, dhe shumë shumë i dëmshëm ky politizim qoftë në arsim qoftë në shëndetësi që po bëhet. Çka ka faj një fëmijë i Zaimit apo a tjetrit apo atij tjetrit, nuk duhet të bëhen pjesë e politikave ditore.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, theksoi, e mori këtë situatë si familjare, unë të dy fëmijët e Hakiut, njëri prej tyre bile e njoh edhe kur kam qenë mësimmshënës. Asgjë të keqe s'kemi prej saj, por ishim duke diskutuar që këtë Rregullore që e keni votuar ju. e njëri prej tyre është zotëri Haki Rudari në atë legjislaturë të vitit 2022 e që nuk e parasheh që të përfitojnë dy anëtarë prej një familje, dhe po ashtu nuk e parashoh as studentë të sektorit privat si dhe as ata të masterit, kështu që edhe unë jam për këtë pikë që është mirë disa që s'kanë pasur mundësi të regjistrohesh në fakultet të shtetit ngase tani edhe shteti po i'u jep mundësi më shumë dhe pse të mos jenë edhe ata përfitues, prandaj kur të iniciohet Rregullorja për ndryshim iniciojeni këtë pjesë dhe jemi për ta përkrahur, kështu që s'kemi asgjë.

Ju e dini që dy seanca qysh kanë qenë sjelljet këtu dhe qysh jemi dalë prej këtu sepse nuk iku përgjigjeve, ju jap përgjigje ty dhe secilit prej juve, madje ndoshta edhe pas vitit 2030, sado që kemi jetë, kështu që nuk i'u iku përgjigjeve. Ta keni parasysh faktin që në këtë listë asnjë emër familjar Fetahu s'është, dhe sinqerisht po më vie keq që unë e kam mik të mirë Zaim Thaçin dhe do ta shikoj këtë çështje menjëherë po sa të kthehem në zyrë, do ta shikoj sakt këtë situatë, mund të ndodhë vetëm një rast që mund të jetë përsëritës i vitit ose diçka ngjashme sepse përndryshe nuk duhet të ndodhë ajo, pra pajtohem me juve dhe me shumë seriozitet do ta shikoj dhe do t'ju njoftoj qoftë me shkrim qoftë verbalisht për rastin në fjalë sepse ne kemi fëmijë edhe vetë andaj nuk dua t'i hyj në hak askujt sidomos në këtë farë fushate zgjedhore qysh e lidhi asambleisti Ermal Osmani, prandaj ju lus edhe njëherë, merreni me shumë qetësi këtë farë situatë.

Sa i përket formimit të komisionit, po ashtu ju lus të shikoni edhe njëherë Rregulloren mirë sepse kemi diskutuar në vitin 2022 që sa më pak kompetencë t'iu lëhet secilit drejtor të DKA e që sot jam unë, nesër mund të jetë dikush tjetër, pra aty shkruhet qartë që komisionin e themelon Kryetari i Komunës, dhe ai komision është goxha profesional, goxha i pavarur, mirëpo gabime mund të ndodhin, qoftë duke i fut të dhënat, pastaj tek llogaritja e pikësve apo marrja parasysh e tyre e të ngjashme, dhe një gabim i vogël e përmirëson gjendjen në fjalë, ndërsa aty ku kanë qenë në ato raste unë e përmenda fëmijën e Hakiut që ka bërë ankesë por nuk e përmenda në kontekst negativ, dhe askush nuk ka nevojë ta marrë këtë sikurse unë e qita poshtë ose diçka të kësaj natyre, djali po, ai e ka marrë me meritë, kurse unë kurrë s'ia kam përmendur familjarin asnjë personi. Unë nuk kam pas asnjë rast ose familjar i nderuar Haki. Përndryshe qoftë ti Haki qoftë Ekremi dhe të gjithë të tjerët mund të filloni me çfarëdo dhe kurdo që doni sepse se këtë pikë i pastër jam unë Avni

Fetahu, gjeni ku të doni ju, por vetëm i keni zmadhuar këto gjëra duke dëgjuar llafe të kafeve sepse përndryshe Avni Fetahu askënd të punësuar nuk e kam as për bursë as asgjë, e them këtë sepse këtu hynën rend ato muhabete që ishin.

Pra rasti i djalit është se ai e ka merituar dhe nuk thash asgjë unë absolutisht sepse ai e ka merituar, kurse ankesën e ka bërë ajo tjetra edhe me të drejtë që ka bërë ankesë, mirëpo të dy prej një familje nuk kemi mund t'i përfshijmë, e kjo duhet të gëzoj edhe LDK, edhe PDK, edhe Vetëvendosje sepse është zbatuar kriteri edhe nuk i është mbajtur krahë askujt. Ndërsa në rast se është bërë gabim për rastin e vajzës së Zaim Thaçit, ne do ta shikojmë me shumë përpikëri.

z.Ermal Osmani, nga vendi thekson, se vajza e Zaim Thaqit ka qenë në listën preliminare kurse pas kandidimit të tij për deputet nga LDK, ju pas dy dite e keni heq nga lista e përfituese dhe nuk është në listën përfundimtare.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA, vazhdoi, nuk është ashtu siç po potencon parafolësi, madje unë tani po dëgjoj për këtë rast, por më lëni të përfundoj diskutimin e pastaj merreni fjalën ju lutem. Si do që të jetë unë u mundova të pasqyroj një situatë reale këtu e cila nuk është që është aq katastrofale qysh po e parashihni ju sepse prej 493 studentëve sa kanë aplikuar, 326 janë përfitues dhe këtu po del që një numër pak mbi 100 janë të pakënaqur. Mandej sa për kureshtje e shikova në listë përfundimtare ku ishin me nota shumë të ulëta edhe shumica e atyre që janë me nota të mëdha janë drejtime deficitare, janë të përfshirë në këtë listë, pra janë të përfshirë pa përjashtim, të gjitha partive politike, prandaj këtë çështje ju e dini mirë por tjetër është a e pranoni apo jo, mirëpo si do që të jetë, ne jemi të hapur për çdo diskutim, për çdo debat, ama Avni Fetahu këtu nuk ka hile as sherr sa i përket asaj që t'i jepet përparësi ndokujt ose të anashkalohet ndokush.

z.Haki Rudari, theksoi, për besë ujit të turbullt nuk mund t'i them që është i kthjellët, ky është nocioni i imi dhe është përkufizimi im zotëri Avni Fetahu. Se në çfarë gjendje është arsimi tash me ty në krye drejtorë, a është më mirë se në kohën e LDK-së apo më keq se në kohën e LDK-së, nëse të pyes jashtë seancës e din çka edhe ti e din çfarë përgjigje jep. Unë e thash që të kam përkrahur për hir të subjektit, jo për hir si Avni Fetahu sepse ti e dinë mirë vërejtjet që ti kam bërë kur ke qenë drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, por për subjektin që kam dhënë shumë dhe kam kontribuar shumë të kam përkrahur edhe atëherë kur nuk është dashtë me të përkrah. Ti e di qysh i ke regjistruar nxënësit në shkollë të mesme në shtator me dysha e tresha, për interesa tua.

Unë edhe t'i sigurisht që do të vazhdojmë, mirëpo thënë të drejtën, nëse dikush nuk e meriton të jetë në Ekzekutiv është pikërisht Avni Fetahu, pikërisht është ai, por e kam mbrojtur subjektin.

Kur kemi pas informatë për arsim, a më tregoni dikush, kurse unë i'u kam kërkuar informata krejt ish drejtorëve të Drejtorisë së Arsimit të LDK-së me vite ka, sepse është e drejtë, përse t'i iket informatës, pikërisht kjo e bën nervoz, si informatë e bën nervoz. Ky nuk duhet të merret me fëmijët të këshilltarëve komunal, por duhet arsyetuar politikisht kërkesa për informatë, krejt është normale, duhet të arsyetohet në bazë të kriterëve, por ato e di që janë shkelë.

Neni 7 paragrafi 3 i udhëzimit që jepen subvencionet, thuhet, përveç shërbyesve civil, anëtarët e komisionit mund të jenë edhe ndonjë ekspert nga jashtë, ndonjë këshilltar që vie prej fushës së arsimit, por nuk e kanë shti dhe nuk e shtinë sepse kanë qejf të bëjnë vetë dallavere ashtu qysh janë mësuar të bëjnë dallavere deri sot.

Sinqerisht e kam kërkuar dhe kam menduar të kemi një informatë shumë të sinqertë, shumë të ndershme, madje edhe në Rregullore që ne Grupi i këshilltarëve e kemi, haptas po e them këtë, që ne këshilltarët duhet njoftuar paraprakisht për propozimin, por pikërisht në mbledhjen e Grupit sot mungoi Avni Fetahu, nuk ishte prezent.

Unë vetëm dy njerëzve në këtë botë i'u përkulem, babës dhe nënës, e të cilët nuk janë në këtë botë, po ta bëj hesap X-in apo Y-lonin, bile pozita hiç nuk vie në shprehje tek unë. Se si e ke udhëheq ti që je që 5 vite Avni Fetahu, për besë edhe ti vet e din çka.

Unë si këshilltar komunal propozoj ta bëjmë një komision qysh e kemi bërë për vërshimet në bujqësi, atëherë është bërë një gabim sepse është gjetur uji i turbullt dhe keni thënë lëreni ashtu, kurse unë jo, unë kur e gjej ujin e turbullt kam qejf ta di edhe kush e ka turbulluar, me emër e mbiemër, ai tip jam, pra kur ta gjuaj gurin kam me mbajt dorën një javë që ta shohin kush e ka gjuajtur gurin, e jo me gjuajt gurin dhe me fsheh dorën.

Prandaj në fund të këtij debati, propozoj që të formohet komision, dhe kështu e kam pas në mendje, prej 3 anëtarësh, nga 3 subjektet politike më të mëdha LVV, LDK dhe PDK, kërkoj falje për grupimet tjera që nuk po i propozoj, nëse kalon propozimi në rregull. Unë jam tip që për besë kurrë nuk “kukatë”, debatoj 24 orë por me “kukatë” kurrë të jetën time nuk “kukati”, se kam bërë as kur ishim 3 asambleistë në kohë të LDK-së kur ka qenë në pushtet, as tani që jemi në pushtet sepse pushteti është kalimtare. Unë e kam një pagë me koeficient 5.8 dhe këtu përfundon tek unë. Nuk e di te tjerët qysh është gjendja, megjithatë e di por më vonë do të jepet përgjigja.

z.Besim Latifi, theksoi, sinqerisht nuk e pata në mendje ta marrë fjalën në këtë pikë, mirëpo më nxiti debati dhe diskutimi që u bë deri tani. Ne jemi dëshmitarë të seancës së kaluar se qysh përfundoi seanca me një sjellje e cila nuk përkon të paktën me drejtorët e Drejtorisë së Arsimit për nga pozicioni të kenë një sjellje jashtëzakonisht vulgare, një sjellje që nuk shihet në institucione përveç në rastin e tij, domethënë po foli për rastin qysh i gjuajti dokumentacionin në fund të mbledhjes së kaluar, e që unë besoj që është dashur edhe Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje të distancohet nga një akt i tillë qysh e ka bërë drejtori i DKA-së.

Kjo puna që po e thotë kolegu z.Haki Rudari është sikur me fol 3 milion herë, sikur Hakiu që po e thotë njëherë dhe po i rithekson ato probleme të cilat i kemi ngritur ne në vazhdimësi. Madje edhe një prej kolegeve parafolëse e cila siç duket nuk qenka prezentë tani e cila potencoj “ka njerëz.....”, sepse fundja e përsëris që secili prej prizmit ton duhet të mbrojë interesin qytetar kudo që të shohim që është cenuar e drejta, pavarësisht subjektit që takojmë duhet atë që për çka kemi marr votën qytetare, interesin qytetar. Ne e kemi diskutuar një problem madhor sepse këtu gjërat po bëhen formalisht, mirë për të bërë procedura formale për çështje përmbajtësore.

Ne atë ditë e kemi pasur debatin për çështje të komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve, po e shohim çfarë niveli është përzgjedhja e drejtorëve të shkolla, po bëhet hajgare me këtë çështje, hiqet prej shkollës “Shaban Shala” si plotëson kriteret, e dërgon në një shkollë diku tjetër atje, pastaj prej shkollës “Enver Maloku” dërgohet në shkollë “Xheladin Rekalu”, prej shkollës “Dr.Ibrahim Rugova” në shkollë “Enver Maloku”. Do të thotë një farë hajgare është çka ka ndodhur këtu, a po e kuptoni tani, në një shkollë merren në tjetrën dërgohen, qysh është shkolla ekonomike në çfarë gjendje të rëndë ka ardhur e që është shqetësuese kjo pavarësisht kush qëndron në krye të institucioneve, është shqetësuese për qytetarët çfarë po ndodh sepse fundja të gjithë ne po i rritim fëmijët tanë në këto shkolla, secili prej nesh, edhe fëmijët e profesorit Haki, edhe unë i kam fëmijët në shkollë dhe secili nesër, pra fëmijët nuk e kupton politikën andaj ne duhet ta kuptojmë që të mos bëhen pjesë e një fushate emrat e tyre ku i'u përmendet emri nëpër seanca të Kuvendit, nëpër televizione etj, do të thotë nuk është në rregull sepse te fëmija krijon shqetësim dhe ndikon kjo farë pune, prandaj e them që duhet të jemi të kujdesshëm dhe të mos hyjmë në personale në kuptim kësaj ne sepse të gjithë kemi çfarë t'i themi njëri-tjetrit, do të thotë po unë kam çka të flas një pjesë për fëmijët e Avnisë por nuk e them atë për jetë sepse është etikë e imja, e di ky në shkollë ku kam punuar unë ka qenë djali i tij në fillim, nuk po shkoj më tutje për shkak të fytyrës time, jo për shkak që ky nuk e meriton t'i thuhet. Prandaj duhet të jemi të kujdesshëm e

sidomos ata në pozicione kyçe duhet të rezonojnë me pozitivitet dhe të jenë të përgjegjshëm, përndryshe ne e kuptojmë që ka ngjyrimë politike, por nuk bëhet ajo listë e bursave ashtu, ta harrojnë, as nuk është bërë më herët, as nuk bëhet ashtu, nuk po e them që nuk ka ndodh të bëhet edhe më herët, mund ta ketë bërë edhe ai më herët e që aty e keni marrë shkollën të dy ju, e që po e kritikoni por që vazhdimisht po e kopjoni. Domethënë është plotësisht me të drejtë ajo që e keni kritikuar derisa keni ardhë në pozicione, por pastaj i'a keni bërë 10 fish më zi.

Nuk kalon askush dhe nuk mund të marrë bursë askush në Komunën e Podujevës, e as nuk mundet kurrë të hyjë në lista pa kapërcyer nëpër duart juve, more edhe 700 komisione po t'i kaloj, nuk kapërcen ajo farë pune, kjo do të thotë se është bërë normale, përndryshe ne mund të fshehim sa do që doni, mund të diskutojmë sa të doni, mirëpo realiteti është ky.

Unë mendoj që duhet të rezonohet dhe të fillohet me dhënien e përgjegjësisë si dhe t'i kthehemi ligjshmërisë, në të kundërtën, mendoj që nuk e meritojnë qytetarët e Podujevës këtë nivel.

z.Haki Rudari, theksoi, për hir të opinionit, po kërkoj nga drejtori i DKA-së që le ta thotë tani nëse unë e kam thirr ndonjëherë për t'iu ndihmuar fëmijëve, le ta thotë që unë kam kërkuar intervenim për fëmijët e mi për t'iu dhënë bursa, e them këtë sepse në këtë terren e vuri drejtori i DKA-së, pra edhe njëherë të kërkoj që nëse të kam thënë, dil në foltore dhe thuaje lirisht, mirëpo ju betohem që kurrë në jetën time nuk i kam thënë Avni Fetahut që shikoje jepja bursën fëmijës, kur nuk i takon me ligj, po ashtu kurrë jetën time nuk i kam thënë as Kryetarit të Komunës e as asnjë personi jep diçka që s'i takon me ligj. Prandaj kjo të mbetet përgjegjësi dhe në moralin e Avni Fetahut që për besë është e tmerrshme kur një drejtor drejtohet kështu shefit të Grupit të këshilltarëve e që është mandati i katërt si këshilltar dhe mandati i tretë si shef i Grupit, dhe e din 100% që familja e Haki Rudarit zero ka përfituar nga Vetëvendosja në pushtet.

Tani po e them edhe një, e dinë kolegët besoj, e kam vajzën me fakultet juridik që afër katër vite të diplomuar dhe rrinë në shtëpi dhe ende merre para prej meje dhe prej vëllezërve të mi, po i kam dy vëllezër në Gjermani dhe djalin që ka një biznes ka një biznes në Gjermani, kam mundur të shkoj sepse të gjithë që nga Kryeministri nuk ka nivel i lartë i LVV-së që nuk ka shkuar përmes shtëpisë së Haki Rudarit, kurrë nuk jam munduar të keqpërdorë, të del dikush në Vetëvendosje le të thotë që unë Haki Rudari i kam thënë ndokujt diçka të tillë, besoni që unë do të jap dorëheqje, madje nuk do të kem asgjë personale me atë person nëse është e vërtetë, por nëse nuk është e vërtetë këtë që e tha Avni Fetahu do të ballafaqohemi me të në forma të ndryshme sepse është diçka që e tha një të pavërtetë dhe opinionin e mori që unë i pasna thënë Avniut t'ia jep vajzës time bursën, dhe nuk i'a paska dhënë, si dhe kjo qenka qëllimi që unë kam kërkuar këtë informatë, por që po betohem që kurrë s'ka ndodhur ajo, unë e kam kërkuar këtë informatë pas disa ankesa të studentëve, dhe krejt në rregull, mirëpo tash nëse ty të kam thënë, urdhëro thuaje, po më ke thënë, dhe atëherë po unë jam fajtor.

z.Abedin Zeka, theksoi, i nderuari Kryesues, kërkojmë një pauzë të shkurtër për një konsultim, meqë kemi edhe pika tjera që do t'i diskutojmë dhe do t'i trajtojmë, kështu që kërkojmë një pauzë në mënyrë që të kemi një konsultim, pastaj vendosim se qysh po vazhdojmë me këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë mund ta hedh në votim kërkesën për një pauzë të shkurtër, por jemi në përfundim të pikës së parafundit për këtë mbledhje dhe nuk po e di përse ka nevojë për një pauzë, megjithatë unë e hedh në votim kërkesën për një pauzë të shkurtër me qëllim të konsultimeve sikurse e kërkoj parafolësi.

Meqë vetëm 4 vota ishin Për, 10 vota Kundër, asnjë E Përmbajtur, Kryesuesi konstaton se nuk kalon kërkesa për pauzë.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, urdhëroni a dëshiron ndokush të marrë fjalën për këtë çështje, meqë nuk ka të lajmëruar, atëherë po e konstatojmë që përfundohet debati për këtë pikë të rendit të ditës, a pajtoheni.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA-së, theksoi, pa keqkuptime, por sa për mua, për çdo çështje formoni komision, por ju e keni votuar një Rregullore këtu ku pjesë e votimit ka qenë edhe zotëri Haki Rudari, aty parashihet edhe komisioni i ankesave, pra janë shfrytëzuar gjitha procedurat, andaj formimi i një komisioni të tillë paraqet edhe shkelje të Rregullores që e keni votuar ju.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e ka shumë gabim drejtori i DKA-së sepse për çdo ndarje të subvencioneve Kuvendi ka të drejtë të bëjë komision ad-hoc, për të shkuar ta kontrolloj komisionin që e zgjedh ky. Nuk ka kurrfarë shkelje këtu, për çdo çështje ka të drejtë, përndryshe pse jemi këshilltarë të Kuvendit. Gjithashtu pse e kemi votuar edhe komisionin për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave kur ata nuk na japin kurrfarë raporti. Pra ne kemi të drejtë të propozojmë komision ad-hoc për çdo subvencion, bursë e të tjera në mënyrë që të kem të drejtë të zgjedhim pastaj si komision që të shkojmë ta kontrollojmë komisionin, të marrim dokumentet komplet, t'i kontrollojmë dhe në fund të vijmë me raport para Kuvendit. Prandaj sërish e them që drejtori i DKA-së e ka shumë gabim, e din edhe vetë ai.

z.Besim Latifi, theksoi, sinqerisht është për keqardhje mënyra qysh e lëshuan sallën për ta pamundësuar formimin e këtij komisioni disa nga këshilltarët e Lëvizjes Vetëvendosje. Sinqerisht kur dikush nuk ka çka të fsheh atëherë voton. Është një komision i cili do ta mbikëqyrë procesin se qysh ka ndodhur te ata përfitues, a i kanë plotësuar kriteret në bazë të asaj Rregullore që është për ndarjen e bursave që po e përmend drejtori, nëse nuk i kanë plotësuar kriteret dhe janë në listën përfundimtare, pastaj vie komisioni me një raport këtu në Kuvend dhe tregon që janë bërë shkelje. Do të thotë, nuk ka rast në botë ku fshehët pas këtyre rasteve dhe thotë nuk ka kurrgjë, jo, nëse nuk ka asgjë, eja e themelojmë komisionin, e votojmë edhe ai pastaj shkon e mbikëqyrë atë proces.

Kuvendi është instancë mbikëqyrëse, këtë duhet kuptuar, Ekzekutivi prej Kryetarit e poshtë vijnë në këtë Kuvend dhe raportojnë për punën e tyre, pra në Kuvend vijnë, nuk i'u raporton Kuvendi juve por ju Kuvendit i raportoni për secilën punë që bëni, kështu është e rregulluar ligjërisht.

Është e pamundur ajo që cekur kolegu z.Haki Rudari që ndokush të jetë në listën përfundimtare pa qenë në listën preliminare, qysh i bie farë pune apo qysh hyri, është e pamundur lista preliminare e përzgjedhësve, pastaj vie lista përfundimtare e përzgjedhësve dhe ti ke ndryshim madje edhe rritje në numër që e ke nga lista preliminare në përfundimtare, në kushte normale është dashtë të jetë e kundërt, apo të zvogëlohet ajo preliminare sepse i ke zgjedhur 307 që i kanë plotësuar të gjitha kriteret ligjore, tani po do me i përzgjedh më pak sepse ke mund të zgjedhësh dikë që është bërë lëshim dhe zvogëlohet numri, mirëpo të rritet numri kjo është alogjike, nuk ka asnjë kuptim.

Mirëpo këtu po shihet qartë ajo që e potencova më herët që ka pasur dollovere në këtë proces dhe janë lënduar fëmijët, pavarësisht a është Hakiut, i jemi, apo i yti drejtor, i kujdo qoftë ai, nuk duhet lënduar fëmijët në këtë formë. Duhet t'i marrin bursat ata që i meritojnë.

Unë e kam qenë kritik edhe në një prej elementeve të asaj Rregullore që domethënë janë favorizuar rastet sociale, kurse ka mbetur jashtë listës ai i shkëlqyeshmi, mirë, atyre duhet t'ju bëhet një zgjidhje me një kategori tjetër, por jo të mbetet jashtë listës studenti i shkëlqyeshëm, pra të mos dekurajohen nxënësit e shkëlqyeshëm, mirëpo është bërë Rregullorja si i tillë dhe duhet zbatuar.

Ikja nga përgjegjësia në këtë formë është e papranueshme, sinqerisht është e papranueshme dhe mendoj se është duke i vulosur ato që i potencoj Hakiu dhe këshilltarët tjerë e që do të thotë se në këtë proces kanë ndodhur shumë manipulime dhe mendoj që duhet të kthehet në pikën zero.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, Kryesues, këtë seancë mund ta ndërpresësh, por ta përfundosh nuk mundesh në bazë të rregullatives ligjore, kështu që kërkoj ta respektosh atë.

z.Haki Rudari, theksoi, shumë komuna krijojnë komisione për ndarjen e bursave prej Kuvendit Komunal, Mitrovicën e kam parë. Edhe me Rregulloren e subvencioneve parashihet që anëtari i tretë i komisionit të jetë jashtë shërbimit civil, do të thotë e vërtetë është kjo sepse është në Rregullore dhe në Udhëzim, pra thuhet që anëtari i tretë mund të jetë në cilësinë e ekspertit të jashtëm të fushës. Prandaj formimi i një komisioni unë konsideroj që është shumë i mirë për arsye se nxjerrët e vërteta, qoftë edhe nëse gjithçka është në rregull, pse jo, gjithçka del në rregull dhe s'ka kurrfarë problemi, nëse nuk është në rregull, ja paftë hajrin ai i cili e ka turbulluar ujin. Nëse s'ka kuorum, mbledhja nuk përfundon i nderuar Kryesues por duhet të ndërpritet dhe pastaj të vazhdoj nesër, pasnesër apo kurdo që thirret për këtë diskutim.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i DKA-së, theksoi, vetëm do t'ju lutesha që te komisioni mos e keq informoni çështjen te opinionin publik, ai ekspert i jashtëm ka të bëjë me zgjedhjen e drejtorëve të shkollave, kështu që të mos i japim kahje tjetër.

Sa i përket shtimit të numrit që e përmendi Besim Latifi, besoj isha i qartë më herët, e thash që disa nga njerëzit që nuk e kanë një anëtar të familjes ose që janë nga kategoritë e dala nga lufta, e kanë sjellë dokumentin e që nuk e ka ditë që duhet ta sjellë, dhe është shtuar ai numër.

Jo me një komision, por edhe me 100 komisione e them se bardhë si loti është ajo punë, pa asnjë problem, qysh të doni, mandej ju i keni edhe format tjera sepse keni qasje në dokumente publike dhe mundeni me ardhë t'i shikoni ato dokumente, nuk është punë sekrete kjo kurrgjë, por po dëshironi të bëni një komision politikë ju, por ne jse në rregull është.

z.Haki Rudari, theksoi, politikë në këtë nuk po bënë askush përveç drejtorit të DKA Avni Fetahu i cili përmes këtij diskutimi don ta dëmtoj edhe subjektin Lëvizja Vetëvendosje e që zero ka kontribut, pra jam i bindur që këtë diskutim e dëgjojnë edhe njerëz që kanë pozita në LVV.

E dyta, dua t'ia mohoj këtu sot atë që e tha sepse në Rregullore, neni 7 paragrafi 3, thuhet; kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për shqyrtim dhe vlerësim kërkesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jenë shërbyes civil të Komunës apo në raste të ndryshme mund të jetë edhe një anëtar i jashtëm në cilësinë e ekspertit të fushës. Pra nuk po thuhet për drejtor të shkollave, përndryshe e them se dhjetë herë më mirë rregullohet i njohë se sa ti Avni Fetahu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konstatoj se nuk ka kuorum për të vazhduar tutje me këtë mbledhje. Mbledhja mund të vazhdon nesër, pasnesër apo kurdo që krijohen kushtet për të vazhduar, dhe do të njoftoheni zyrtarisht me kohë.

z.Besim Latifi, theksoi, i nderuari Kryesues unë vetëm një hamendje e kam, a duhet të propozojmë komisionin dhe nëse nuk ka kuorum të ndërpritet seanca, apo duhet të ndërpritet kështu.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, ju lutem, një sqarim, unë vërejta se ka propozime për vendimmarrje, kështu që nuk ka kuorum, por në takimin e ardhshëm për të cilin do t'ju njoftoj me kohë, atëherë nëse dikush vie me propozim duhet të vie me propozim konkret se në çka bazohet për ta themeluar atë komision, dhe normale vazhdojmë pastaj.

Ju faleminderit shumë, këtu e konstatoj të ndërprerë këtë mbledhje për shkak të kuorumit jo të mjaftueshëm, dhe për vazhdimin do të njoftoheni me kohë.

Konstatim:

Mbledhja ndërpritet në ora 15:50 (më 28.05.2026), për të vazhduar sipas deklaratimit të mësipërm të Kryesuesit të Kuvendit.

Procesverbalin në këtë pjesë të mbledhjes e mbajti dhe hartoi:

Osman Bajrami

Vazhdimi i mbledhjes, më 29 qershor 2026

Vazhdimi i mbledhjes filloi në orën 10:20 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunës, dhe u kryesua nga z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit.

Në vazhdimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/te e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV: Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Luljeta Muçolli-Azemi; Haki Rudari; Abedin Zeka; Avni Islami; Qëndresë Hajrizi, Ardi Hasani (munguan: Flandra Kadriu; Vlora Jashanica)

Nga LDK: Enis Shabani; Alisa Jetullahu; Enis Dervisholli; Besim Latifi; Blerta Azemi-Berisha; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani, Isak Ejupi. (munguan: Valdet Restelica; Valon Demolli; Gresa Qosa-Maqastena.)

Nga PDK: Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi.

Nga GUXO: Demokrat Hodolli, nuk ishte prezent.

Nga Unioni i Blakçorve: Gentrit Arifi.

Nga AAK: Baki Feta.

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Ditjona Statovci-Drejtoria e Administratës DA; Arbnorë Uka-Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Lirie Hoti Rama-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Ahemti Ahemti-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Valbona Ibishi Azemi-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shuajb Blakçori-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Behram Latifi-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), përfaqësues të KFOR, dhe disa zyrtar komunal.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi vazhdimin e seancës duke i përshëndetur dhe falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në këtë vazhdim të mbledhjes të datës 28 maj 2026 e cila është ndërprerë, theksoi, ju njoftoj se pas verifikimit të listës së nënshkrimeve të asambleistëve, 25 asambleistë kanë nënshkruar pjesëmarrjen dhe janë prezent për momentin, andaj me këtë rast konstatoj se Kuvendi ka kuorum të mjaftueshëm për punë dhe vendimmarrje.

Është thirr vazhdimi i mbledhjes së datës 28.05.2026, konkretisht vazhdimi aty ku ka mbetur në pikën 7 të rendit i ditës. Siç jeni në dijeni diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës pothuajse kanë përfunduar dhe ishim në përmbyllje të saj, mirëpo mbledhja u ndërpre pasi që nuk kishte kuorum për të vazhduar. Në këtë situatë që jemi sot, prandaj e hap vazhdimin e seancës së datës 28.05.2026 aty ku kemi mbetur në pikën e 7 të rendit të ditës dhe tani kush dëshiron të marrë fjalën Kryetari i Komunës apo iniciuesi i kësaj pike z.Haki Rudari.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues ti tani në foltore e potencove mirë që mbledhja është ndërprerë për mungesë të kuorumit, por në shkrim që na ke dërguar shkruan pak më ndryshe edhe nuk e di pse e ke shkruar ashtu. Pra keni thënë që pas kërkesës për ndërprerje dhe kalimit të diskutimeve në personale është ndërprerë seanca. Nuk ka qenë kjo në diskutim dhe as nuk ka bërë kërkesë askush për atë punë, por seanca është ndërprerë pikërisht për arsyet që i ceke, pra është ndërprerë që s'ka pasur kuorum, jo që ka pasë diçka personale dhe s'ka pasur kurrfarë kërkesë.

Pra në njoftimin tuaj me shkrim ke shkruar kështu, ndërsa në foltore e potencove origjinal qysh ka qenë origjinal, prandaj është dashtë të kesh kujdes çfarë shkruan sepse ke shkruar që ka pas kërkesë që mbledhja a të ndërpritet sepse çështja ka kaluar në personale, kurse një kërkesë e tillë nuk ka qenë gjatë mbledhjes, por nuk ka pas kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ju rikujtoj që atë ditë është diskutuar edhe për çështje të tjera të cilat faktikisht kanë përfshirë edhe ato personale dhe ka pasë kërkesë që të përfundoj, por sido qoftë po pajtohem në ato kryesoren që sot e kemi këtë pikë për të cilën do të vazhdojmë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, duke pasur parasysh faktin që gjatë seancës së kaluar është diskutuar bukur gjatë rreth listës së ndarjes së bursave për studentët e Komunës tonë dhe duke i marrë seriozisht të gjitha ato që janë thënë në atë seancë, unë të nesërmen kam kërkuar nga auditori i brendshëm i Komunës që të bëjë në përgjithësi komplet auditimin e asaj liste dhe tashmë auditori e ka kryer draft raportin e parë dhe të njëjtin e ka dërguar në Drejtorinë e Arsimit për t'i dhënë vërejtjet edhe komentet. Jam duke e pritur që këto ditë të më dërgohet raporti final nga ana e auditorit të brendshëm e që lidhet me këtë pikë të rendit të ditës.

Prandaj unë ju kërkoj të gjithë asambleistëve që ta presim atë raport të auditimit, pastaj unë do të jem prezent në seancën e radhës me atë raport të auditimit dhe do t'ju jap të gjitha informacionet lidhur me të gjeturat, nëse ka në atë listë, dhe do keni informatën e përgjithshme, prandaj mendoj që nuk ka nevojë fare që të ngritet komision për arsye se do të kemi auditim, e që besoj se edhe ju, edhe ne i besojmë auditorin të brendshëm, dhe ai do ta japë fjalën përfundimtare rreth të gjitha të gjetura eventuale nëse ka në këtë proces.

Prandaj do të thoja që mos të humbim kohë sot shumë për arsye se kemi mbledhjen tjetër të rregullt edhe më të gjatë dhe me shumë pika gjatë ditës së sotme, por ta mbyllim këtë çështje deri në raportin final të auditimit, dhe nëse raporti final i auditimit nuk jua plotëson kërkesat dhe nevojat e parashtruara, atëherë edhe mund të hapet sërish diskutim për këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vlen të theksohet se anëtarët e Kuvendit të cilët kanë kërkuar fjalën në atë seancë, të gjithëve ju është dhënë fjala, madje më shumë se dy herë duke anashkaluar edhe Rregulloren e punës, vetëm që kësaj çështje t'i jepet një zgjidhje përfundimtare. Unë kam nxjerrë edhe diskutimet dhe i kam identifikuar për secilën sa herë ka folur, mirëpo edhe përkundër kësaj unë sot kërkoj deklarimin e Grupeve të këshilltarëve rreth kësaj çështje, aq më shumë pas informatës që e ceku Kryetari se ka filluar procesi i auditimit në këtë çështje.

z.Haki Rudari, theksoi, po është e vërtetë që në seancën e fundit e cila është e ndërprerë, unë kam kërkuar në fund edhe formimin e një komisioni. Megjithatë edhe auditimi i cili bëhet ose është caktuar ose që është duke bërë detyrën, edhe një komision i hetimit, për mendimin tim është gjithçka në rregull për arsye se unë i kam dy listat, listën preliminare dhe atë përfundimtare, dhe jashtë këtyre listave nuk mund del askush, as auditimi, as ne asambleistët, as askush, prandaj unë kërkoj që në fund raporti i auditimit kur të del të na jepet edhe ne këshilltarëve të Kuvendit në mënyrë që të informohemi lidhur me gjetjet e raportit të auditimit.

Po e them edhe njëherë, listat unë i kam personalisht në formë fizike, qoftë preliminare dhe përfundimtare, jashtë listës nuk mund të del askush, prandaj të gjeturat të cilat janë thënë më herët konsideroj që janë të gjetura të cilat duhet të analizohen në detaje, duhet të jenë reale dhe konform kësaj, pastaj ne ta marrim vendimin e ardhshëm. E them këtë për arsye se kriteret të cilat dalin duhet të aplikohen dhe duhet të zbatohen në mënyrë të rregullt nga secili komision dhe për secilin person që bëhet fjalë, pavarësisht i çfarë prindi është, apo ku i punon prindi, kriteret duhet të jenë reale për secilin person i cili natyrisht nesër mundet edhe të konkurroj nëpër sektorë të ndryshëm.

z.Besim Latifi, theksoi, ne jemi dëshmitarë për mënyrën se si u ndërpre atë ditë seanca, është e turpshme të ndërpritet seanca kur ishim në proces të vendimmarrjes dhe themelimit të një komisioni hetimor i cili do ta zbardhte të vërtetën sa i përket ndarjes së bursave. Ç'është e vërteta edhe diskutimi në pikën e rendit të ditës, por edhe formimin e komisionit e propozoj vetë kolegu z.Haki Rudari që është edhe shef i Grupit. Unë nuk po mund ta kuptoj përse i keni nxjerrë asambleistat dhe e keni pamundësuar formimin e komisionit, prej kujt po fshiheni, çka po fshihni, nëse procesi ka qenë në rregull dhe transparent, çka e pengon formimi i një komisioni të cilët e keni propozuar ju vetë për të zbardhë të vërtetën, e formojmë komisionin dhe ai komisioni e kryen punën e vet, pastaj edhe auditori e kryen punën e vet, këto janë çështje të ndara.

Kuvendi e ka të drejtën e vet të plotë për të formuar komisione hetimore për secilën çështje, e në këtë rast ne si Grup e mbështesim propozimin e z.Haki Rudarit për të themeluar komisionin, ndonëse paskeni punuar mirë 1 muaj ditë derisa u thirr vazhdimi i kësaj seance, pra u deshtë 1 muaj ditë kohë derisa i keni bindur që të tërhiqen prej një kërkesë të tillë, do të thotë është absurde, është qesharake, është fshehje e të vërtetës, është ikje prej përgjegjësie, çfarë doni. Kaq e thjeshtë është, e formojmë komisionin, ai komision i shqyrton ato aplikacione, ata përfitues, kush janë, a i kanë plotësuar kriteret dhe vie në këtë Kuvend me një raport, edhe kryhet kjo farë pune, madje më së shumti është në interes të juaj që të zbardhet e vërteta. Ka mundësi që aty ndoshta janë bërë lëshime edhe procedurale edhe çështje të tjera, ndoshta ka pasur edhe influencë të pushtetit sepse ne e dimë që janë shpërndarë në kohë të zgjedhjeve ato bursa, pra të mos i ikim të vërtetës, nuk kemi nevojë të frikësohemi askush prej të vërtetës, nuk e di pse po frikësoheni.

Ne e mbështetëm këtë pikë dhe atë propozim për komision, as nuk e kemi ngritur ne këtë pikë, as këtë komision nuk e kemi kërkuar, por e mbështetëm dhe japim mbështetje për secilën çështje që është në interes qytetarit, që të zbardhet e vërteta ne japim mbështetje. Kështu që ju ftoj të deklaroheni ashtu qysh po deklarohemi ne që jemi për formimit të këtij komisioni, secili Grup i këshilltarëve le të deklarohet a është pro formimit apo është kundër formimit të këtij komisioni i cili do të zbardhë të vërtetën. Nuk është diçka që jemi duke kërkuar jashtë asaj që është kompetencë e këshilltarëve dhe Kuvendit. Andaj ne e mbështesim formimin e këtij komisioni dhe kërkojmë që ta mbështesni edhe ju me votë, për ta zbardh të vërtetën, ndërsa auditori le ta kryejmë punën e vet, le të jetë edhe një instancë më tutje, mirëpo Kuvendi le të kryejnë punën e vet edhe rolin për çka është i thirrur.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të Partisë Demokratike të Kosovës, kërkojmë që të presim rezultatin final të auditimit në mënyrë që pastaj ta kemi të qartë për secilin parregullsi, për secilin përfitues të bursave gjatë këtij vitit shkollor.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, këshilltarët kanë diskutuar në atë mbledhje, sot Grupet e këshilltarëve veç se u deklaruan.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues, ti tani duhet të veprosht sepse ka kërkesë për ngritjen e komisionit, pra duhesh ta hedhësh në votim. Numrat i kanë për vota, duan apo nuk duan ta bëjnë komisionin, ne vazhdojmë tutje pastaj, por jo të kaloj kështu.

Kryetari i Komunës e ceku, s'di a i besoni auditimit, unë personalisht nuk i besoj, as nuk e di kush është aty, as kush e ka çuar atë farë auditimi. Edhe raportin ai e dërgon në Drejtori të Arsimit, por mundet edhe ta ndryshoj. Le të caktohen tre anëtarë të komisionit dhe atyre që ja japim besimin dhe qysh do që thonë ata e që mund të thonë që shumë mirë janë shpërndarë bursat dhe kryet ajo farë punë. Ne e dimë që i kanë marrë edhe parat ata studentë dhe nuk e kemi ndërmend t'jua marrim, mirëpo vetëm ta dim a ka pasur keqpërdorim apo jo. Kaq është kjo dhe hedhe në votim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuar Ekrem në fakt unë ende nuk e përfundova propozimin sepse ashtu e kisha ndërmend të veproj duke e hedh në votim, por ti ndërhyre ndërkohë unë e thash se është diskutuar dhe i dëgjuam këshilltarët çka deklaruan, kështu që pashë se edhe LVV, edhe PDK u deklaruan, nga LDK mbeten pran propozimit të kaluar. Ju patët propozim për ta hedh në votim, andaj meqë nuk ka doçka tjetër çfarë të thuhet unë e hedh në votim, që faktikisht u kërkua të formohet komisioni në fjalë ende pa ardhur raporti i auditorit të brendshëm.

z.Haki Rudari, theksoi, unë nuk e di dhe isha shumë i kuartë, unë thashë që në seancë e ndërprerë vetë kam kërkuar formimin e një komisioni të tillë. Në të njëjtën kohë Kryetari i Komunës e tha që ka filluar auditimi ndaj atij komisioni apo shpërndarjes së bursave për të thënë më thjeshtë, dhe ne nuk po shkojmë askund. Unë e thash se i kam dy listat atë preliminare dhe përfundimtare dhe jashtë këtyre listave dhe konsideroj që askush nuk mund të dalë jashtë tyre, as unë s'mund të dal, prandaj të presim rezultatet e këtij komisioni. Unë nuk e thashë që jam kundër komisionit në të ardhmen, ne do të informohemi për rezultatet e këtij komisioni, ai rezultat do të dalë, emrat do të jenë të njëjtë dhe të shohim ku janë të gjeturat, cilat janë mangësitë apo lëshimet e atij komisioni, ne këtu jemi në të ardhmen, prapë jemi këshilltarë komunal këtu me ndonjë përjashtim eventuale nëse ndokush është në pushim, të tjerët jemi prapë këtu, prapë do debatojmë, prapë do të jemi këtu. Prandaj unë më duket shumë isha i kuartë i nderuar kryesues, dhe e bëra dallimin në mes mbledhjeve që është ndërprerë dhe mbledhjes që po vazhdon sot.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në rregull, atëherë unë po e hedh në votim propozimin e përfaqësuesit të LDK-së që ishte për themelimin e një komisioni rreth ndarjes së bursave për studentë për vitin akademik 2025-2026. Nuk kemi çka të diskutojmë më tutje, z.Haki Rudari u tërhoq nga propozimi që ka pas, kështu që vazhdojmë.

z.Besim Latifi, theksoi, ne nuk e kemi propozuar komisionin, por ne i kemi dhënë mbështetjen deklarative propozimit të cilën e ka bërë z.Haki Rudari, kurse tani ky është shumë i paqartë, prandaj i kërkoj të deklarohet a është të vazhdohet me propozimin apo e tërheq atë propozim të cilin e ka dhënë për ta formuar komisionin. Unë isha shumë i qartë në atë që e thashë.

Pra le të deklarohet z.Haki Rudari në emër të Grupit apo ndokush tjetër në emër të Grupit të LVV-së që po tërhiqen prej kërkesës për komision hetimor, ne jemi për ta themeluar komisionin hetimor, dhe ne pastaj e mbështesim edhe me votë, kurse tani është duke deklaruar diçka tjetër.

Vazhdimi i seancës është thirr për këtë punë, do të thotë për çështjen e ndarjes së bursave në arsim, janë zhvilluar diskutimet dhe ka mbet në proces themelimi i një komisioni, kurse sot po nxjerr diçka tjetër që nuk është e planifikuar.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë në bazë të diskutimit e kuptova që po tërhiqet zotëri Rudari deri sa të kryhet auditimi, mirëpo që ka nevojë të deklarohet kjo, mund edhe të merr fjalën.

z.Haki Rudari, theksoi, është e vërtetë për një pjesë që e tha kolegu z.Besim Latifi që edhe unë e thashë në fillim se propozimin për komision e kam bërë unë. Dhe nën 2 e thashë se është formuar një komision për auditim. Pra e presim raportin e komisionit të auditimit për arsye se atë listë e ka ai komision, e kam unë fizike e që po besoj që edhe kolegët e LDK e kanë të njëjtën sepse është publike dhe s'mundet të ndryshoj. Pra unë ju thashë, pasi është formuar një komision i auditimit, t'i presim rezultatet dhe mandej ne jemi sërish këtu, askund nuk po shkojmë, listat janë publike dhe ta shohim përfundimin.

Edhe njëherë e them, ne jemi këtu, ne prapë jemi këshilltarë këtu, prap mund ta aktualizojmë këtë çështje. Unë jam i sigurt që Kryetari i Komunës dhe komisioni do të na informojnë neve me rezultate përfundimtare. Prandaj nuk e di qysh të jem më i kuartë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, besoj veç u kuptua kjo çështje, do të thotë deri tani nuk ka propozim të ri, nëse ka urdhëroni.

z.Besim Latifi, theksoi, pra meqë nëse këta po tërhiqen prej formimit të një komisioni që e kan propozuar vetë, atëherë unë e propozoj themelimin e komisionit hetimor për hetimin e ndarjes së bursave, le të votojmë të gjithë, le t'i shohin qytetarët çfarë hajgare bëjnë edhe çfarë ndryshimi deklarata bëjnë prej seancës në seancë. Ne nuk jemi ardhur këtu të bëjmë hajgare, jemi ardhur me mbrojtur votën edhe besimin qytetarë që na kanë dhënë.

Kështu që unë kërkoj të hedhet në votim formimi i një komisioni hetimor për ndarjen e bursave.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet përfunduan, andaj ju lutem të deklaroheni me votim se kush është për formimin në komisionit hetimor lidhur me ndarjen e bursave për student për vitin akademik 2025/2026.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë nga 27 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, 9 vota ishin Për, 16 vota Kundër, 2 vota Të Përmbajtura, nuk miratohet propozimi për formimin e Komisionit hetimor për çështjen e ndarjes së bursave për student për vitin akademik 2025/2026.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës:

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, atëherë të nderuar kolegë në atë mbledhje ka qenë edhe pika e rendit të ditës Të Ndryshme që tani në këtë vazhdim të mbledhjes është në rend, andaj unë kam propozim që a jeni për që ta përfundojmë këtë mbledhje dhe pikën Të Ndryshme ta bartim në mbledhjen e radhës të rregullt e cila do të mbahet sot, por me rekomandim që pyetjet dhe çështjet e parapara që t'i ngritni në këtë mbledhje, të njëjtat do t'ju lejohen t'i parashtroni edhe në kuadër të pikës Të Ndryshme në seancën e radhës, pra sot. Pra unë mendoj që për të mos u përsëritur dy herë deklarimet në pikën Të Ndryshme, mund ta bartim në seancën tjetër dhe nuk do t'ju mohohet e drejta e dy pyetjeve për këtë mbledhje dhe dy të tjera në mbledhjen e radhës, mirëpo nëse mendoni që të vazhdohet kjo pikë deri në përfundim të kësaj mbledhje e cila është vazhdim, andaj nëse pajtoheni e bartim, nëse jo vazhdojmë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues, ne mezi kemi pritur që në këtë mëngjes t'i gjejmë drejtorët e Drejtorive këtu dhe t'ju bëjmë pyetje. Ne mund t'i paraqesim ato edhe në pikën të Ndryshme në mbledhjen e radhës që është caktuar të mbahet sot, mirëpo nga praktika e dim se në fund të mbledhjeve po ndodh të mos ketë kuorum dhe se disa prej drejtorëve ose rrinë ose nuk rrinë në sallë e që nuk po kemi pastaj kujt t'i bëjmë pyetje. Pra mund t'i kemi nga katër pyetje por asnjë s'mund t'ia bëjmë në fund të mbledhjes sepse gjysma e tyre do të ikin nga mbledhja, aq më tepër në këto temperatura të nxehta. Prandaj konsideroj se është mirë të vazhdojmë me këtë seancë tani edhe me pikën Të Ndryshme, t'i paraqesim dy pyetjet ose çështjet tona.

z.Fahri Restelica, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, lidhur me atë që e theksoi parafolësi, unë ju garantoj që të gjithë drejtorët/shat e Drejtorive do të qëndrojnë në seancë, fjala është për mbledhjen e radhës me theks në pikën të Ndryshme, pavarësisht temperaturave, por vetëm qëndroni edhe ju në sallë si anëtarë të Kuvendit dhe mundësojeni kuorumin.

z.Besim Latifi, theksoi, unë besoj që është pikë e rendit të ditës e një seance tjetër që është vazhdim i seancës. Pra jemi duke e vazhduar atë seancë dhe mund ta përfundojmë edhe këtë pikë të rendit të ditës Të Ndryshme, mandej fillojmë me seancën tjetër, është kaq e thjeshtë, dhe nuk e di pse po i komplikoni këto tema, e vazhdojmë këtë, janë pyetjet, janë drejtorët dhe përgjigjen, e përfundojmë këtë, pastaj vazhdojmë në seancën e re.

Nuk kemi nevojë t'a komplikojmë këtë çështje sepse nuk është diçka që ne duhet diskutuar këtu dhe të votojmë në kuadër të kësaj. Mendoj që duhet të zbatohet ashtu qysh është.

z.Haki Rudari, theksoi, po pajtohem plotësisht që kjo seancë qysh ka filluar ashtu duhet të përfundojë, dhe në kuadër të rendit të ditës ka qenë edhe pika Të Ndryshme e që duhet ta përfundojmë si pikë të rendit të ditës dhe si mbledhje, e pastaj të vazhdojmë me seancën e re e cila është thirrë me pika të reja. Kështu që ne megjithatë jemi këshilltarë të Kuvendit dhe mund të vonohemi në mbledhje, por fundja e kemi obligim të qëndrojmë edhe në këto kohë ndoshta paksa të nxehta, qoftë Ekzekutivi qoftë edhe ne si anëtar të Kuvendit, nuk është mirë të ikim prej seancave.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë konsideroj se ka pajtueshmëri nga të gjithë për të vazhduar me këtë mbledhje dhe të përfundohet sipas procedurave dhe rregullatës përkatëse edhe pika Të Ndryshme, andaj e hapim këtë pikë të rendit të ditës.

8. Të Ndryshme

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kërkoj sqarime për dy çështje meqë drejtori Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit është këtu prezent dhe mund të jap përgjigje/sqarim. E kam shikuar kontratën për trajtimin e qenve endacak dhe më bëri përshtypje shumë nëse ka mundësi që drejtori i cekur të dalë dhe të më sqarojë sepse në atë kontratë janë 9 pika nga 150 qen, mirëpo mua më bëri përshtypje më shumë trajtimi i qenve me pronar, nxjerrja e pasaportave të tyre dhe vënia e çipave. Më duket as unë nuk kam pasaportë, edhe ne njerëzit po kemi probleme me nxjerrjen e pasaportave e lëre më me qenë. Në fakt ne po kemi probleme me qen që janë të shtëpive, por kemi problem me qenë endacak që nuk po dilet askund prej tyre nëpër fshatra e në qytet çdo kund, pra diqysh është shumë e paqartë këtu ku thuhet 9 pika nga 150 qenë, e që është numër i madh nëse i bie të trajtohen vetëm ata 150 apo çdo herë nga ka 150.

Pastaj nëse i'u nxjerrën pasaportat, kush del t'jua kërkojë atyre pasaportat, pra kjo mu duk çudi, pse këtu titulli shkruan trajtimi i qenve endacak kurse të trajtohen qentë me zotë shtëpie, kjo ngase në rast se ka mundësi NN personi të mbaj qen në shtëpi, ai ndaq mund t'a pajisë me pasaportë ndaq i vë rruza e të tjera, atëherë përse ne t'ia trajtojmë qenin atij personi dhe madje t'ia vëmë edhe çipin dhe ta shikojmë nga po i shko qeni atij, problem ky që nuk është i joni.

Çështja tjetër, për këto rrugët që janë kryer dhe disa që janë dhe ende, pashë edhe te rialokimi i mjeteve që shembull te rr."Xhemajl Mustafa" duhet të bëhen pagesa, dhe pastaj po prishen dhe po mbeten në gjendje të "shkretë", unë nuk e di përse po e hapin atë rrugë, a kanë harruar ndonjë gyp me fut apo çka është bërë aty kurrfarë informate nuk e ka dhënë askush, asnjë deklaratë që ta dimë çka është bërë dhe çka po bëhet, a është harruar diçka, a është vjedhë diçka. Pra pyetja është përse po e hapin atë rrugë sërish, kurse aty para lokaleve kanë mbet "shkret", jua kanë vendos copat e betonit nga gjysmë metër, të dredhëta e që mund t'i thyesh këmbët nëse kalon andej, bash nëpër shtigje të biçikletave dhe në trotuare, madje edhe aq më keq edhe nëpër ato trotuaret që janë për persona të verbër e që mjaft e kanë keq qarkullimin në atë rrugë andej nëpër atë trotuar për persona të verbër, ata persona në çdo 20 metra mund të hasin në pengesa nga shtyllat, trafot e rrymës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, do të kërkojë nga drejtorët t'i evidentojnë pyetjet dhe çështjet që ngritën, e pastaj nëse dëshirojnë t'i japin përgjigjet në fund tani apo në seancën e radhës.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, dua të paraqes një pyetje sa i përket mirëmbajtjes së trotuareve, pra, i nderuar drejtor i DSHPMSH, qysh klasifikohet një trotuar për ty për ta mirëmbajtur atë, shembull, te Lagjja e re që është ndërtuar rrugës për në Dumnice, pas përfundimit të rrugës së re, trotuari është në gjendje të tmerrshme. Nëse ti drejtor nuk e ke parë, është mirë ngaherë ta pyesësh kolegun tuaj z.Vigan Salihu i cili i bie për çdo ditë andej dhe sigurisht që të tregon ndoshta qysh

është gjendja. Nëse ajo rrugë regjionale nuk besoj që tash duhet të zhduket trotuari, se për trotuar të ri as që është fjala, por as të mirëmbahet thuajse nuk është askund.

Gjithashtu edhe tek mirëmbajtja e ndriçimit publik, është e pesta herë në këtë mandat që unë e them se te rr.”Haxhi Sadriu”, nëse janë 50 drita vetëm 10 janë që ndizen.

Kam edhe një kërkesë e cila vie prej qytetarëve e që dua me marrë sqarim, ka të bëjë me kujdestaritë e Barnatoreve, çka po ndodh me ato.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, vetëm sa për sqarim e nderuar Arnisa i bëre tri pyetje, në fakt dy pyetje dhe një kërkesë, do të duhej ta lëni një për mbledhjen e radhës, por si do qoftë, ju lus të respektoni Rregulloren sa i përket kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Luljeta Muqolli-Azemi, theksoi, kësaj radhe dua të flas në emër të qytetarëve për një shqetësim që është në rritje viteve të fundit dhe që ka të bëjë me shëndetin e fëmijëve tanë.

Përdorimi i tepërt i teknologjisë, çantat e rënda dhe mungesa e aktivitetit fizik po ndikon në rritjen e rasteve të fëmijëve me devijime të shtyllës kurrizore siç është skolioza dhe kifoza, dhe për këtë shqetësim deshta t'i adresohem me disa kërkesa Drejtorisë së Arsimit dhe asaj të Shëndetësisë.

Po filloj me Drejtorinë e Arsimit, përderisa kemi të bëjmë me edukim dhe parandalim, a ka mundësi të krijohet një ekip profesionistësh dhe të realizohen ligjërata vetëdijësuese në të gjitha shkollat nga klasa e I-rë deri në Klasën e V-të, me temën Edukimi i Fëmijëve për Parandalimin e Devijimeve të Shtyllës Kurrizore. Gjatë kësaj ligjërate të krijohet edhe mundësi e shpërndarjes së fletushkave. Mandej është shumë me rëndësi edhe krijimi i dollapëve.

Kërkesa tjetër që i adresohem drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë, a ka mundësi të krijohet mundësia e bashkëpunimit me një Ortoped, Fizioterapeut dhe Mësimdhënëse të Edukatës Fizike dhe të realizohen vizita në të gjitha shkollat nga klasa e VI-të deri në klasën e IX-të, dhe gjatë këtyre vizitave të krijohen mundësitë e kontrollimit të gjithë fëmijëve. Arsyeja pse në këtë moshë është se te fëmijët gjatë kësaj kohe vetëm fillon rritja përnjëherë edhe mundësia e shfaqjes së devijimeve të shtyllës kurrizore është më e madhe. Qëllimi i kësaj vizite është që t'i zbulojmë sa më herët rastet sepse sa më herët që zbulohen rastet, mundësia e trajtimit është më e shpejtë si dhe kostoja e trajtimit është më e ulët.

z.Gentrit Arifi, theksoi, sot dua t'i ngrisë dy çështje të rëndësishme për qytetarët tanë, funksionalizimin e ndriçimit publik në rr.“Vëllezërit Frashëri”, si dhe mbështetjen për investime në energji solare dhe kursim të energjisë.

Rruga “Vëllezërit Frashëri” vazhdon të mbetet pa ndriçim publik gjatë natës, gjë që po krijon pasiguri dhe vështirësi të mëdha për qytetarët që kalojnë andej. Pastaj mungesa e ndriçimit po rrezikon sigurinë e këmbësorëve, të nxënësve dhe të moshuarve dhe të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion. Përveç rrezikut nga aksidentet, errësira gjatë natës krijon edhe ndjenjë pasigurie për banorët e asaj zone, andaj kërkoj nga organet përgjegjëse që kjo çështje të trajtohet me prioritet dhe të bëhet sa më shpejt funksionalizimi i ndriçimit publik në rrugën e cekur. Banorët meritojnë kushte normale, siguri dhe infrastrukturë bazike si çdo pjesë tjetër e qytetit.

Po ashtu edhe mbështetja për investime në energjinë solare dhe kursim të energjisë, në kohën kur faturat e energjisë po rriten dhe qytetarët po përballen me vështirësi ekonomike, është detyrë e institucioneve tona që të krijojnë mundësinë konkrete për t'i ndihmuar familjet dhe bizneset lokale.

Podujeva dhe fshatrat kanë potencial të madh për përdorimin e energjisë solare sepse shumica e shtëpive dhe objekteve posedojnë hapësira të përshtatshme për vendosjen e paneleve solare. Prandaj kërkoj që Komuna në bashkëpunim me nivelin qendror dhe donatorët të shqyrtojnë këto mundësi si në vijim: krijimin e subvencioneve për familjet që investojnë në panele solare, mbështetjen financiare për bizneset dhe fermerët, lehtësimin e administratave dhe informimin më të qartë për qytetarët, instalimin e sistemeve solare në objektet publike si shkolla, qendra

shëndetësore dhe në ndriçim publik. Ky investim nuk është vetëm i mirë për qytetarët, por është edhe investim për të ardhmen e Komunës tonë, më pak shpenzime në energjinë dhe më shumë pavarësi energjetike, më pak ndotje dhe më shumë vende pune për të rinjtë tanë.

z.Enis Dervisholli, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë, çështja e serave se qysh është puna e kësaj, a do të kthehen paratë e participimit apo do t'i shpërndani serat sepse tani jemi paksa me vonesë sa i përket serave.

Po ashtu kam edhe një pyetje për çështjen e ujit, shumë fshatra po kanë problem me ujë të pijes, siç janë Obranqa dhe Dumnicë e cila ka problem edhe me mbeturina atje sepse është deponia e mbeturinave në atë fshat, andaj pyes se qysh është puna e kësaj çështje.

E përgëzoj drejtorin për punën e kryer të instalimit të sistemit pikë-pikë te rruga që shkon për te Restorant “Ora” kjo pas kërkesës tonë që e kemi paraqitur, keni kryer punën si një punë të mirë andaj edhe ju përgëzoj për këtë.

z.Ermal Osmani, theksoi, dua ta drejtoj një çështje te drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike z.Bahri Selimi, në fshatin Livadicë keni bërë një ndarje në baza partiake te Lagjja e “Sllatinve”, pikërisht në atë lagje është e vetmja Lagje në Livadicë që nuk ka ndriçim publik. Pse po e them këtë se në baza partiake është sepse Kryetari i nëndegës së LDK-së është nga ajo lagje, andaj do të doja të më jepet një arsyetim përse e vetmja lagje në Livadicë është kjo lagje që nuk ka ndriçim publik, fjala është Lagjen e “Sllatinve” në fshatin Livadicë.

znj.Blerta Azemi-Berisha, theksoi, kam një pyetje për drejtorin z.Bahri Selimi, një qytetar më është drejtuar dhe thotë rr.”Vëllezërit Toverlani” afër qendrës/marketit Agnesa, ka vite që pritët të shtrohet/asfaltohet, andaj përse ende nuk është bërë dhe nuk është kryer kjo rrugë.

z.Arben Xhemajli, theksoi, kam një kërkesë për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që në shkollën “Hamit Sejdiu” të ndërtohet një parking si dhe në Çerdhe aty pran të hapet një pus / bunarë sepse nuk ka ujë të pijes.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, sot kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike z.Bahri Selimi, edhe pse disa herë e kemi biseduar të kaluarën çështjen e rrugës “Nazim Gafurri” në të cilën një segment i tërë i ndriçimit nuk është duke bërë tash e disa kohë. Aty gjatë punimeve dhe meremetimeve të disa gropave është këputur një kabllo, sa kam informacione unë, mirëpo tani ka ndoshta tre-katër ose pesë muaj që ndriçim nuk ka fare ndriçim, andaj a është paraparë të bëhet diçka për atë pjesë të rrugës.

z.Kasib Bashota, theksoi, kam një pyetje prej banorëve të fshatit Llapashticë, konkretisht për segmentin e rrugës Llapashticë-Popovë, pra kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit të na jap një sqarim se deri ku kanë shkuar procedurat, për këtë pra po pyesin qytetarët.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, meqë jemi te rrugët, para disa seancave i kam adresuar një çështje drejtorit z.Bahri Selimi, që lidhet me rrugën te “Lagja e Dëshmorëve”, nuk ka ndriçim publik dhe nuk ka trotuare si dhe ajo rrugë është dëmtuar tepër shumë, andaj a mund ta dim i nderuar drejtor se deri ku kanë shkuar punimet në këtë çështje dhe a është marrë ndonjë masë sepse për besë ajo rrugë për çdo ditë po bëhet më e dëmshme dhe mungesa e trotuareve po është shumë e nevojshme.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka më të lajmëruar për të marrë fjalën nga anëtarët e Kuvendit, tani radha është për Ekzekutivin që të jap përgjigje dhe sqarime.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, theksoi, faleminderit shumë që po kujdeseni gjithherë për ankesat e qytetarëve dhe po i ngritni shqetësimet e që mendoj se kjo është punë e juaja dhe besoj që po e kryeni mirë.

Ishte një pyetje shumë interesante në fillim rreth kontratës për trajtimin e qenve endacak për të cilën e di që nuk keni njohuri të mjaftueshme për këtë kontratë sepse për herë të parë po bëhet më ndryshe, por fillimisht dua të të plotësoj i nderuar Ekrem se nuk është titulli i kontratës, trajtimi i

qenve endacak, por titulli i kontratës është, trajtimi i qenve, pra as endacak e as shtëpiakë por veç trajtimi i qenve është. Arsyeja pse po bëhet kjo unë ju tregoj se ne jemi shumë të fokusuar në trajtimin e qenve endacak, pikërisht për shkak të shumë problemeve që po dalin edhe shumë ankesave të qytetarëve si dhe rasteve të ndryshme që po ndodhin me qen endacak, dhe në këtë vit ne kemi bërë një Marrëveshje me një Organizatë Holandeze e cila na ka ndihmuar shumë sa i përket trajtimit të qenve endacak, pra dëgjojeni me vëmendje kur e përmendi endacak dhe jo endacak, do të thotë se trajtimi i qenve endacak me atë Marrëveshjen me një Organizatë Holandeze e cila na ka ndihmuar shumë në këtë vit dhe thënë të drejtën në fillim të vitit i ka trajtuar rreth 400 qen, pastaj është vazhduar sërish edhe me një kontratë të re dhe është duke i trajtuar edhe 350 qen endacak. Arsyeja pse ne e kemi bërë trajtimin e qenve ku kemi menduar që njëkohësisht të bëjmë trajtimin edhe të qenve shtëpiak është edhe për shkak të analizave të cilat i kanë bërë kjo Organizata nga Holanda e cila na ka thënë decidivisht në takimet që i kemi pas se është e kotë të trajtohen vetëm qentë endacak sepse nuk është e mjaftueshme pa u trajtuar të gjithë qentë, prandaj ka qenë si sugjerim i tyre që ne t'i trajtojmë edhe qenët shtëpiakë, andaj edhe e kemi lidhur këtë kontratë për trajtim të qenve që do të ketë edhe qen endacak edhe shtëpiak. Rreth asaj se si do të trajtohen qentë shtëpiak, ne do ta bëjmë një thirrje-njoftim për secilin pronar të qenve që t'i sjellin qentë e tyre në ordinancën përkatëse për trajtim të tërësishëm dhe atë pa kosto të shpenzimeve, trajtim në kuadër të të cilit përfshihet edhe kjo vendosja e shenjave identifikuese që qeni është i trajtuar, si dhe vendosja edhe e mikroqipit që është një lloj pasaporte ashtu qysh edhe përmendet sepse kur vendoset mikroqipi në secilin qen dhe ka numrin identifikues, ne pastaj mund ta dim se a është qeni i trajtuar apo nuk është në bazë të një databaze/serveri që do ta kemi në Komunë.

Pra kjo është në pika të shkurtra si rezyme sa i përket trajtimit të qenve.

Sa i përket rr."Skënderbeu" që pati pyetje rreth dëmtimit të trotuarit, pyetje kjo e cila me automatizëm ndërlihet edhe me pyetjen rreth mbështetjes e energjive solare apo energjive të ripërtitshme. Në këtë çështje kemi është një leje e cila i është dhënë një kompanie e cila ka ndërtuar panele solare në fshatin Llabashticë, pra në vitin e kaluar i është dhënë leja dhe tani ka filluar punimet. A është mirë që kanë filluar punimet pasi ka përfunduar rruga, mendoj se nuk është mirë, mirëpo nuk kemi pasë ndonjë mundësi t'ia ndalojmë investimet aq të mëdha që janë bërë e që tani do të bëhet lidhja e paneleve solare prej fshatin Llabashticë deri në rrjetin e KEDS që është në lagjen e "Brecalive". Do të thotë se aty ku kanë pasë mundësi ajo kompani që të kalojnë nëpër gypa nëntokësor kurse aty ku nuk kanë pasë duhet të hapen nëpër trotuare. Jemi munduar që ai gyp dhe ato kablllo të kalojnë vetëm nëpër trotuare, por nuk ka pasë mundësi për shkak edhe të rrjetit tjetër që është i KEDS aty. Pra kjo punë është e një operatori që e bën dhe e cila ka një leje që më shumë se 1 vit dhe tani ka filluar me punë sepse tash janë krijuar kushtet dhe mundësitë që ato panele që janë ndërtuar në fshatin Llabashticë të lidhen me prodhimin e rrymës atje te KEDS që është në lagjen e "Brecalive".

Sa i përket mirëmbajtjes së trotuareve se qysh klasifikohen ato, unë nuk po di qysh t'i klasifikoj e nderuara Arnisë, sepse këtu trotuaret janë të gjitha të njëjta, pra nuk ka klasifikim, kurse edhe te rrugët regjionale ne i mirëmbajmë trotuaret, do të thotë nuk kemi të drejtë t'i mirëmbajmë rrugët apo të ndërhyjmë në ato rrugë. Pra kjo përgjigje është për ty e nderuara Arnisa Sylejmani sepse ti e parashtrove si pyetje, prandaj e them se kur ne ndërtojmë trotuare marrim leje në Ministri të Infrastrukturës për t'i ndërtuar sepse i përket një rrugë regjionale, dhe kemi marrë leje, i kemi ndërtuar dhe tani na takon neve si Komunë t'i mirëmbajmë dhe po i mirëmbajmë, pra këtu trotuari me rrugë dallon, ta keni qartë, trotuaret e mirëmbajmë ne, kurse rrugët nuk kemi të drejtë pa leje të Ministrisë sepse nuk kemi pasë të drejtë as trotuare të ndërtojmë pa leje.

Sa i përket mirëmbajtjes së ndriçimit publik në rr.”Haxhi Sadria”, aty 5 herë ka qenë dy kompani për ta rregulluar atë ndriçim, pra janë duke punuar por që janë disa defekte të mëdha në kablllo, duhet ndërruar komplet një rrjet aty që të bëhet funksional komplet ndriçimi publik në atë rrugën “Haxhi Sadria”. Pra e ceka se mirëmbajtja është punë e jona e cila do të rregullohet, mirëpo zonja Arnisa është këmbëngulëse në kërkesat e veta dhe derisa t’i kryhet gjithherë bënë kërkesa.

Sa i përket ndriçimit publik të ri që ishte pyetje për tek rr.”Vëllezërit Frashëri”, në këtë rrugë ka tri vite radhazi që planifikojmë ta rregullojmë ndriçimin publik, përkatësisht ta bëjmë atë lidhjen e shkëputjes ku është një shkëputje shumë e shkurtër që nuk ka mundur të lidhet asnjëherë për shkak të problemeve pronësore që janë në atë pjesë, pra për çdo vit kemi bërë kontratë dhe nuk kemi mundur ta realizojmë në atë pjesë, tani sërish në këtë vit kemi lidhë kontratë, por tani jemi dakord deri diku me ata pronarë që na kanë penguar aty për shkak se është pronë private, që gypat dhe kabllot e rrymës t’i fusim nën tokë dhe ta bëjmë me shtylla metalike, ashtu e kemi të planifikuar dhe kjo shumë shpejt besoj që do të bëhet me gypa të metalit si dhe që kabllot do të futen nën tokë për shkak të problemeve pronësore që kanë qenë.

Te mungesa e ujësjellësit në disa fshatra, këtë çështje për besë e kemi biseduar shumë herë, nuk është problem që nuk po merremi me të, por është problem që në vazhdimësi na ndodh për shkak të terrenit gjeografik të fshatrave, për shkak të problemeve në gypat e ujësjellësit, dhe pikërisht kjo është ndoshta arsyeja kryesore që ne kemi insistuar me Ministrinë të ndajmë buxhet që ai buxhet i kalon komplet KRU “Prishtina”, do të thotë nuk është buxhet që vije në Komunë dhe që ne bëjmë kontrata për zgjerim të rrjetit të ujësjellësit, mirëpo ne kemi insistuar edhe në bashkëpunim me Ministrinë dhe kemi ndarë buxhet e që tani dhe siç e keni parë që është edhe ndërrimi i gypit kryesor prej fabrikës në fshatin Shajkoc deri te rezervuari në Podujevë, por edhe fshatrat që janë Gllamniku, Perani, Katunishta dhe të tjera, pra është një rrjet bukur i gjerë që shtrihet pikërisht në ato fshatrat që po përmenden që nuk kanë ujë të pijes kohët e fundit.

Tek ndriçimi publik në Lagjen “Sllatinët” në fshatin Miroc, për besë ju them se fshati Miroc së bashku me Livadicën dhe Shtedimin kanë përfutur aq shumë ndriçim publik në këtë kontratën e fundit dhe nëse edhe ata kanë ankesa për ndriçim publik, ankesa tamam të sinqerta, nuk e di kush nuk do të ketë më, sepse është bërë një shtrirje aq e gjerë e rrjetit andej sa që ka mund të mbetet një lagje qysh është ajo “Sllatinëve”, por nuk është çështje politike kjo, por ka mundur të mbeten edhe ndonjë rrugicë diku që na janë kërkuar 2 drita apo ndonjë tjetër 3 drita, mirëpo gradualisht do të kryhen krejt, vetëm duhet ta kemi të qartë se nuk mund t’i bëjmë të gjitha komplet përnjëherë, duhet shkuar gradual sepse nuk ka buxhet e as mundësi t’i bëjmë komplet në një fshat ose tre fshatra përnjëherë, mirëpo gradualisht qysh kemi vepruar deri tash do të veprojmë edhe tani.

Nuk besoj që do të mbetet edhe lagja në fjalë sepse u tha se është nënkryetari jonë i partisë aty, andaj qysh ta lëm atë pa ndriçim.

Sa i përket asfaltimit të rr.”Vëllezërit Toverlani”, më tregoj drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit se ka projekt dhe do të kryhet. Ndërsa te ndriçimi publik në rr.”Nazim Gafurri” i nderuar Artrit, edhe në atë rrugë është problemi i njëjtë, kemi biseduar edhe gojarisht, por tash po e them edhe publikisht, është një pjesë që duhet të ndërrohet komplet një rrjet i vjetër duke u zëvendësuar me rrjetin e ri dhe për këtë po i duhet pak më shumë kohë Ndërmarrjes Publike “Eko-Llapi” e cila po e mirëmban ndriçimin publik, mirëpo janë duke u marrë me këtë çështje dhe besoj që shumë shpejt do ta zgjedhin si problem i cili e di se është i kahmotshëm.

Ishte edhe çështja e rrugës tek “Lagja e Dëshmorëve” për të cilën ju tregova edhe në mbledhjen e kaluar se veç kemi filluar kohën e fundit me mirëmbajtjen e rrugëve, me renovim të rrugëve të asfaltuara, por problemi aty e dini se është problem i kahershëm, problem të cili na e ka lënë barrë Kompania e Ujësjellësit kur e ka vendos atë gypin të cilin e ka dërguar deri te rezervuari, pra është

barrë e tyre dhe nuk kemi munduar (guxuar) të intervenojmë aty pa u shkëputur kontrata e kompanisë Ujësjiellësi sepse është e kundërligjshme të intervenojmë me dy kontrata në një punë të caktuar, një punë të njëjtë, prandaj është dashur të presim derisa të përfundojë si proces ajo e Ujësjiellësit, dhe tani kontratën e kemi lidhur dhe është dërguar me e-mail kompanisë që të rregullohet ajo rrugë e që besoj se mundësia e parë që t'i krijohet, ngase i kanë të renditura punët në të gjitha rrugët që do të rinovohen, do ta rinovoj dhe atë rrugë, besoj jo larg, mirëpo kjo varet tani krejt prej punës së kompanisë, por goxha shpresoj që nuk do të shkoj larg sepse thajse i ka ardh rendi edhe asaj rruge sipas renditjes që ka qenë për rinovim, tani veç nëse i del ndonjë problem kompanisë apo që eventualisht mund të ketë ndonjë ngecje gjatë punimeve.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe njëherë e kam paksa të paqartë, shembull, këtu në kontratë janë 10 pika te trajtimi i qenve, por çfarë më bëri përshtypje mua ishte pika 2 trajtimi i qenve me pronarë dhe ishte theksuar, kontroll, ushqim, vaksinim, dehelematizim dhe identifikim. Pastaj edhe te pika 2.3 që ishte vendosja e mikroqipit dhe pajisja me pasaportë për qentë me pronarë, pyetja ime është se çka na duhet neve si komunë ta dimë nga po shkon qeni i pronarit që t'i vendosim mikroqipin dhe pasaportën. Pse për qenë shtëpiak të jepen para për pasaportë.

Pastaj janë 2 pika që nuk sqarohen sa duhet, shembull, te kastrimi dhe sterilizimi i qenve, as shkruan shtëpiak as endacak. 10 pika janë në tërësi, 9 pika janë me nga 150 qen, kurse 1 është me 100. Unë edhe në fillim kërkova ta dim mundësisht sa qen endacak dhe sa shtëpiak kanë për t'u trajtuar, si dhe sërish po e ceku sepse më bëri përshtypje përse ne t'jua vëmë çipat dhe t'jua nxjerrim pasaportat qenve shtëpiak, unë jam kundër kësaj sepse nëse NN personi i ka mundësitë të mbaj qen ai sigurisht i ka edhe për nxjerrjen e pasaportës së tij.

z.Arben Xhemajli, theksoi, kam pyetje për drejtorin parafolës z.Bahri Selimi, në fshatin Kerpimeh, a ka ndonjë projekt, do të thotë te rr."Buzë Llapit" afër urës kemi nevojë për ndriçim, trotuar, zgjerim, urë dhe sanim të gropave si dhe një pjesë anësore mbrojtëse te rr."Gjon Kastrioti".

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në rregull është, vetëm i nderuar kolegë (i drejtohet parafolësit), të kujtoj se pyetjet i ke kryer më herët, ke mund të lësh në pikën Të Ndryshme në mbledhjen e radhës që do të mbahet sot.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSh, theksoi, edhe një sqarim z.Ekrem Rrahmanit sa i përket asaj që e ceku përse Komuna e ka paraparë pajisjen me pasaporta dhe me mikroqip. Krejt këtë trajtim që kjo është një lloj procesi ligjor që nuk është lehtë të dalim prej tij. Kontrata e trajtimit të qenve është kontrata më e monitoruar që është në secilën komunë, jo veç tek ne. Ju e dini ligjin për kafshët i cili i mbron shumë ato, edhe ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm çfarë po bëjmë.

Sa i përket paramasës, për besë unë nuk i bëj paramasat, unë vetëm kam kërkuar të bëhet kjo punë dhe me një vendim kam angazhuar dikë për t'i bërë këto paramasa, dhe i kanë bërë. E di që më ka thënë se me këtë shumë të caktuar që kemi janë 150 qen që do të trajtohen. Tani aty përse janë krejt nga 150 është për shkak se 150 i nënshtrohen secilit proces. Pastaj te numri 100 kemi të bëjmë me këtë ndryshimin mes qenve endacak dhe atyre shtëpiak që e ka bërë një ndryshim më të madh. Ne nuk do t'i ndajmë në trajtim veç endacak as veç shtëpiak, por do t'i trajtojmë aq sa do të kemi mundësi në kuadër të kësaj kontrate. Pra edhe njëherë, fokusi jonë kryesor do të ishte trajtimi i qenve shtëpiak, pra do të jetë fokus, por tani nuk e dim se sa pronar të qenve do të paraqiten në njoftimin që do ta bëjmë, mundësinë do ta kenë pa kosto. Unë e kam një në shtëpi dhe fëmijët për çdo dy javë e dërgojnë tek mjeku për arsye të ndryshme, kurse tani me fillimin e kësaj kontrate kanë mundësi atë ta bëjnë pa para, ndoshta edhe atë qenin tim ta dërgojnë për trajtim sepse për besë goxha shpenzime janë.

Ishte edhe pyetja tjetër për disa çështje në fshatin Kerpimeh për mungesë ndriçimi, trotuari, urë e të tjera, un mund t'ju them se për këtë vit vetëm çka ka për mirëmbajtje mund të bëjmë diçka sepse

kemi kontratë të lidhur, ndërsa ndërtime të reja sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit nuk ka, jo vetëm për Kërpimeh por për asnjë fshat. Pra do të thotë se te mirëmbajtja jemi duke punuar. Çka do që është e mundshme dhe çka do që kërkohet te mirëmbajtjet ne do të kujdesemi dhe do t'i kryejmë të gjitha sepse kemi një kontratë të lidhur dhe po punojmë me të, ndërsa ndërtime të reja brenda këtij viti nuk ka.

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, theksoi, lidhur me funksionimin e Barnatoreve në territorin e Komunës së Podujevës, për shkak të transparencës e kam një informatë përmbledhëse. Në vazhdimësi janë pranuar ankesa nga qytetarët lidhur me marrjen e shërbimeve farmaceutike dhe furnizime me barna dhe medikamente si dhe me vështirësitë në sigurimin e artikujve të nevojshëm me kohë. Përveç kësaj janë evidentuar edhe probleme të vazhdueshme në menaxhimin e kujdestarive përfshirë raste të abuzimeve me çmime dhe rrethana të tjera të natyrës së ngjashme të cilat kanë ndikuar në funksionimin e rregullt dhe të drejtë të sistemit. Me datën 08.05.2026 është pranuar një kërkesë ose ankesë me shkrim nga Barnatoret e zonës II, e mbështetur me gjithsej 9 nënshkrime si dhe 1 nënshkrim shtesë nga zona III lidhur me orarin e kujdestarive. Kjo kërkesë ka pasur për qëllim adresimin e çështjeve të organizimit dhe rishikimin e orarit ekzistues të kujdestarive.

Po ashtu me datën 14.05.2026 është mbajtur një takim me përfaqësuesit e të gjitha Barnatoreve të Komunës së Podujevës me qëllim trajtimin e çështjeve të ngritura lidhur me orarin e kujdestarive dhe funksionimin e rregullt të përgjithshëm të sistemit të furnizimit me barna. Në këtë takim janë diskutuar shqetësimet e paraqitura më herët nga Barnatoret e zonave të ndryshme si dhe mundësitë për përmirësimin e organizimit dhe menaxhimit të kujdestarive. Gjatë takimit është mbajtur edhe procesverbal zyrtar në të cilin janë evidentuar diskutimet, propozimet dhe qëndrimet e pjesëmarrësve. Procesverbali ka shërbyer edhe si dokument përmbledhës i takimit dhe si bazë për hapat e mëtejme që i kemi marrë në adresimin e çështjeve të ngritura nga Barnatoret.

Pas takimit të mbajtur, po atë ditë është pranuar një kërkesë tjetër nga Barnatoret e zonës I me gjithsej 8 nënshkrime si dhe 1 nënshkrim shtesë nga zona II. Kjo kërkesë lidhet gjithashtu me çështjet e organizimit të orarit kujdestarive dhe paraqet vazhdimësi të shqetësimeve të ngritura më herët nga subjektet farmaceutike lidhur me funksionimin e sistemit kujdestarive dhe nevojën për rishikim të mundshëm të tij. Andaj duke u bazuar në gjithë rrjedhën e ngjarjeve, ankesat e pranuar, kërkesat e paraqitura nga Barnatoret si dhe diskutimet e zhvilluara në takimin e mbajtur me datën 14.05.2026 është marrë vendim lidhur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të kujdestarive me qëllim të sigurimit të një sistemi sa më të drejtë dhe funksional. Ky vendim është marrë duke pasur si prioritet interesin e qytetarëve, respektivisht sigurimin e qasjes më të lehtë dhe më efikase në barna dhe shërbime farmaceutike. Njëkohësisht është synuar që të sigurohet trajtim i barabartë për të gjitha Barnatoret pa favorizime apo diskriminime në mënyrë që sistemi i kujdestarive të funksionojë mbi parimet e përgjegjësisë, transparencës dhe barazisë.

Kjo ishte një informatë përmbledhëse që e paraqita për shkak të transparencës edhe të qytetarëve por edhe të juaj, dhe si rezultat i gjithë kësaj rrjedhoje është marrë vendim bazuar në Rregulloren e orarit të punës për bizneset, në nenin 15 pika 2.3 dhe vendimi i përmban këto nene:

Sipas orarit të bashkangjitur në këtë Rregullore, Barnatoret / Farmacitë obligohen të respektojnë orarin e kujdestarisë me ç'rast Barnatorja / Farmacia duhet të jetë e hapur, e gatshme për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe të respektojë orarin e përcaktuar të kujdestarisë, ndërsa për Barnatoret tjera puna jashtë këtij orari mbetet në vullnetin e lirë të ushtrimit të aktivitetit.

Barnatoret / Farmacitë të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e Komunës së Podujevës janë të detyruara të marrin pjesë në sistemin e kujdestarive të përcaktuar me Rregullore. Pjesëmarrja sigurohet përmes të paktën një njësie operative dyqani, subjektit afaristë.

Zgjedhja e njësisë përmes së cilës realizohet ky obligim i takon subjektit afaristë.

Duke pas parasysh që disa Barnatore / Farmaci nuk i përmbahen Rregullores, atyre i'u kemi shqiptuar edhe gjoba përmes Drejtorisë së Inspeksionit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vetëm ju lus të respektohet Rregullorja, me theks pjesa ku sa i përket pyetjeve të këshilltarëve nuk hapet debat, përveç atyre që kanë paraqitur pyetje ose që kanë parashtruar çështje, nëse kanë diçka shtesë, shkurtimisht mund të drejtohen edhe njëherë.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në fakt nuk deshta të marrë fjalën fare rreth kësaj çështje, mirëpo dua të ndërlihem paksa rreth informate që u paraqit dhe të jap disa informata shtesë edhe unë.

Mendoj se është e lehtë me nxjerrë vendime jo të zbatueshme, por sa është një vendim i mirë varet edhe shikohet në terren se sa zbatohet, do të thotë ne kemi pasë një vendim që sado që ka pas probleme, për pesë vite qytetin e Podujevës asnjë natë nuk e ka lënë pa kujdestari, kurse vendimi i fundit i marr në mënyrë arbitrar, që dy muaj e gjysmë qytetin e Podujevës e ka lënë pa kujdestari, pra që 2 muaj e gjysmë në Podujevë nuk ka kujdestari nate, prandaj në këtë varet sa është ky vendim i mirë, kurse ato çështjet tjera çka janë shkruar aty shumica s'po dua t'i diskutoj fare sepse nuk qëndrojnë, mirëpo megjithatë i bëjë thirrje Komunës së Podujevës që fillimisht të tërhiqet nga ky vendim, t'i ftoj Barnatoret në dialog, sepse këtu u tha, jo është i pakënaqur, që ku ka bërë kërkesë, u ceken nënshkrimet, jo zona I, jo zona II e III, mirëpo këtu nuk janë duke e zbatuar atë vendim as zona I, as zona II e as zona III, ndërsa kush është duke pësuar, është duke pësuar vetëm qytetari, kështu që mendimi im është që për ta zgjidh këtë çështje, të ftohen Barnatoret në dialog sepse me këtë vendim edhe me këto gjobat që kanë filluar nuk do të kryejnë punë, asnjë Barnatore nuk do ta hap natën me këtë vendim.

Gjithashtu që ky vendim është shumë jo logjik në qoftë se lexoni, i them drejtorit parafolës t'jua shpërndaj nga një kopje gjithë asambleistëve dhe në qoftë se vetëm e lexoni paragrafin 1, atëherë për çka ekziston kujdestaria nëse thuhet që ti si Barnatore kujdestare obligohesh me mbajt kujdestari, kurse ti Barnatore tjetër mund të punosh sipas dëshire, kjo nuk është kujdestari atëherë, do të thotë sa është jo logjike është edhe jo ligjore. Kështu që unë thërras të reflektoni dhe të merrni një vendim të mirë edhe për Drejtorinë edhe për Komunën dhe mbi të gjitha për qytetarët.

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i DPZHE, theksoi, edhe njëherë sa për ta sqaruar këtë çështje, funksionimi i sistemit të Barnatoreve do të thotë kujdestarive që është të dielave pas orës 10:00 të mbrëmjes dhe festave zyrtare, funksionon e ndarë në tri zona, zona I, zona II zona III. Zona I, janë Barnatoret që janë afër QKMF-së, zona II janë Barnatoret tjera përreth qytetit, dhe zona III në fshatrat Kërpimëh dhe Lluzhan. Ne si institucione na intereson që qytetari të ketë alternativa dhe dyqan sa më të afërt për t'i blerë barnat dhe disa nevoja tjera farmaceutike që kanë. Sigurohemi që në secilën zonë të e jetë hapur nga një Barnatore, ndërsa të tjerat mbeten në vullnetin e lirë të tyre, kjo korrespondon me interesin qytetar dhe jo në interesin e disa farmacive të caktuara.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, sërish rreth kësaj çështje, pyes se prej që është marrë ky vendim a është duke u zbatuar, pra mua më intereson zbatueshmëria e një vendimi, a është duke u zbatuar.

Krejt çka po thuhet nga drejtori parafolës, do të thotë është vetëm në letër dhe krejt në rregull, por a është duke u zbatuar ai vendim. Në qoftë se një vendim tjetër paraprak është zbatuar për 5 vite, kurse kemi këtë vendim që 2 muaj e gjysmë ku qytetarët nuk janë duke marrë shërbim, duhet ta kuptoni se diçka nuk është në rregull.

Pra do të thotë që ti po bazohesh në disa Barnatore, po e zëm se qenkan qenë keq disa Barnatore, ta zëm ato të zonës I, mirëpo përse tash nuk po e mbajnë atë orar Barnatoret e zonës II që kanë bërë kërkesa dhe kanë thënë që Rregullorja e parë ka qenë gabim, kurse që 2 muaj e gjysmë Podujeva është pa kujdestari.

z.Ahmet Ahmeti, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, theksoi, sa i përket çështjes së shtruar nga njëri prej këshilltarëve parafolës që ka të bëjë me projektin rrugor të infrastrukturës rrugore Llpashticë-Popovë, është si rrjedhojë e Memorandumit të Mirëkuptimit që është arritur me Ministrinë e Infrastrukturës. Gjatësia e asaj rruge është 7400 metra. Procedura është në shqyrtim të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe besoj se shumë shpejt do të bëhet zgjidhja e kësaj çështje.

z.Behram Latifi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, lidhur me pyetjen e asambleist z.Enis Dervisholli, edhe pse nuk qenka këtu prezent tani, sa i përket punës së serave se kur do të fillojë, sipas ekipit menaxhues të kësaj kontrate do të thotë ka filluar implementimi dhe ndërtimi i serave dhe brenda afateve ligjore do të realizohet kjo kontratë duke u bërë montimi i serave.

Po ashtu shfrytëzoj rastin që t'i përgjigjem edhe një pyetje prej mbledhjes së kaluar kur zotëri Dervisholli e ka parashtruar në lidhje me zyrën këshillimore të fermerëve në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, do të thotë është e vërtetë se DBPZHR nuk ka zyrë këshillimore, do të thotë në kuptimin formal, por kjo nuk do të thotë që fermerët Llapjan janë pa këshillim sepse zyrtarët e Drejtorisë të cilët 95% prej tyre janë të diplomuar dhe kuadro të fushës së bujqësisë, çdo ditë takohen me fermerët tanë, me fermerët Llapjan dhe çdo ditë ofrojnë këshilla teknike, këshilla për subvencione, për aplikim në subvencione dhe të tjera.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, pati dy pyetje nga znj.Luljeta Muqolli dhe z.Arben Xhemajli. Fillimisht te edukimi i fëmijëve më vie mirë e nderuara asambleiste që jo vetëm pozicionin politik që je tani por edhe më herët e keni dhënë kontributin e juaj profesional dhe jeni sërish e mirëpritura ju dhe të gjithë profesionistët e fushës që aty ku i kemi orët zgjedhore të jepni kontributin e juaj rreth edukimit në këtë fushë.

Sa i përket dollapëve, në vitin e kaluar dhe para një viti kemi filluar me disa shkolla, kontrata aktualisht është në OSHP dhe është me disa çështje që nuk janë zgjedhur në nivel qendrorë, por do të vazhdojmë tutje edhe me dollapët, por edhe me sistemin dixhital përmes tabelave dixhitale në mënyrë që të mos ketë ngarkesë të madhe të librave në shkollë.

I nderuari Arben, bëri një pyetje me rëndësi rreth parkingut te Çerdhja në fshatin Kërpimeh, ne do ta shqyrtojmë mundësinë kur të ketë Drejtoria e Shërbimeve Publike ndonjë projekt të asaj fushe, ta marrim me prioritet dhe të krijojmë një hapësirë. Aty në oborr parashihet vendosja edhe e një sallë të edukatës fizike në mënyrë që ta orientojmë një pjesë për parking dhe pjesa tjetër të mbetet për sallë të edukatës fizike. Pastaj tek çështja e ujit të pijes, kemi tentuar disa herë përmes Shoqatave por edhe ne si Komunë, por kemi probleme për shkak të mungesës së ujit brenda oborrit, mirëpo për fat të mirë një banor që është i asaj ane i cili nuk ka dashur të jetë publik, ka shprehur gatishmërinë që me rënie të lirë ta sjellë ujin aty, por i ka disa kërkesa të vogla e që po besojmë se gjatë kësaj vere t'i rregullojmë dhe të ketë ujë të mjaftueshëm në atë hapësirë.

znj.Lirie Hoti-Rama, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, më lejoni që të përgjigjem në pyetjen e koleges znj.Luljeta Muqolli e cila ngriti një sugjerim lidhur me vizitat që i'u bëhen nxënësve të klasëve VI deri në IX ku në ato vizita përfshihen edhe mjekët ortopedë dhe fizioterapeut, ju njoftoj se në fillim të javës së ardhshme vetëm do të publikohet konkursi për angazhimin e dy fizioterapeutëve të rinj në kuadër të QKMF-së me projekt nga Ministria e Shëndetësisë, kështu që kjo do të na lehtësojë dhe realisht angazhimi i tyre do të jetë pikërisht për zhvillim të vizitave edhe nëpër shtëpi, por edhe nëpër shkolla, të fëmijëve, të gjithë njerëzit që do të kenë nevojë për marrjen e këtyre shërbimeve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, do të thotë u paraqitën të gjitha pyetjet dhe u jepen përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme. Tani e kam edhe unë një kërkesë që besoj është edhe të gjithë juve koleg/e të nderuar. Unë po e shoh që këtu në sallë është mjaft vapë, u njoftova që pajisjet aktuale dhe klima është duke punuar në maximum, por nuk po e arrihen kushtet për punë.

Me këtë rast dhe në këtë situatë unë i drejtohem Drejtorisë kompetente, me gjasë asaj të Administratës, që në të ardhmen të ndërmerr masa duke bërë një përforsues, konkretisht ta vendos një klimë këtu në sallë në mënyrë që të na krijohen kushtet për punë gjatë verës kur po është kështu vapë e madhe sepse kështu siç është, konsideroj se janë kushte jo të mira për punë dhe kjo besoj se është kërkesë e të gjithëve.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues nëse ka mundësi ta përfundosh këtë seancë, të ketë një pauzë, dhe pastaj të fillohet mbledhja e rregullt pas orës 12:00 sepse po ndodh të bëhet kallaballëk kur po mbajmë pauzë në kohë edhe të pauzës zyrtare që është për institucionet.

Sa i përket asaj që u përmend rreth klimës, apo vapës së madhe që është edhe këtu brenda në sallë, i nderuar Kryesues e keni mundësinë që edhe në mbrëmje të mbahen mbledhjet në situata të tilla, në fakt verës i bie dy ose 3 seanca t'i mbajmë në mbrëmje (qershor, korrik dhe në shtator eventualisht), për shkak të nxehtit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, thënë të drejtën t'i zotëri Ekrem po mi merr disi propozimet ende pa i thënë unë e që i kam ndërmend, por si do që të jetë, e konstatoj përfundimin e vazhdimit të seancës së 28.05.2026.

Sa i përket propozimit për një pauzë deri në fillimin e seancës së rregullt, unë do të propozoja që tani është ora 11:30, ta krijojmë një pauzë prej 1 orë, por me kusht që të jeni me kohë të gjithë prezent në mbledhjen e rregullt, pra në ora 12:30. A po pajtoheni të gjithë.

Konstatohet se përfundon kjo mbledhje.

Njëkohësisht Kryesuesi i Kuvendit i njofton të pranishmit se meqë vazhdimi i kësaj mbledhje zgjati më shumë se që është parashikuar, mbledhja e rregullt e cila është caktuar të mbahet sot nga ora 10:30, me pajtimin e të gjithëve, shtyhet për në ora 12:30.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Procesverbalin e vazhdimit të mbledhjes e mbajti dhe hartoi;
Enis Sheholli

Nr.Prot.01-060/04-0031710/26

Podujevë,

28 maj 2026, e vazhduar dhe përfunduar më 29.06.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Isak Shabani